



## **INVESTIMET E JASHTME DIREKTE NË KOSOVË Politika Ekonomike, Rrethina dhe Strategjia e Promovimit**

**Raport hulumtues  
19 Shtator, 2002**

**Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit ‘Promovimi I Zhvillimit Ekonomik nepërmjet Shoqërisë Civile’, të cilin e implementon Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest, në bashkëpunim me Qendrën për Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private (CIPE) nga Uashingtoni, dhe me përkrahje të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).**

## PËRMBLEDHJE

Ky raport u adresohet çështjeve kyçe që lidhen me rolin dhe promovimin e Investimeve të Jashtme Direkte (IJD) në Kosovë. Raporti është përgatitur në kuadër të projektit “Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shoqërisë Civile” të cilin Instituti për Hulumtime Zhvillimore “Riinvest” e realizon në bashkëpunim me Qendrën për Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private (CIPE) nga Ëashingtonin D.C., dhe në mbështetje të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Projekti është i fokusuar në përparimin e reformës ekonomike përmes ngritje së cilësisë dhe nivelit të pjesëmarrjes së subjekteve Kosovare në diskutimin e politikave ekonomike. Ky raport do të prezantohet në sesionin e shtatë të Tryezës së Forumit Ndërkombëtar (TFN) e cila do të mbahet me 19 Shtator 2002, dhe paraqet modulën e fundit të këtij projekti dyvjeçar.

- 1) Qëllimet e Raportit dhe sesionit të Tryezës së Forumit Ndërkombëtar janë që të përmirësojë nivelin e informimit mbi gjendjen e pikërisht lidhur me IJD dhe rendësinë e tyre në Kosovë, të inicojë një debat të gjerë dhe të angazhuar mbi problemet me të cilat ndeshen IJD dhe të rekomandojë një strategji të politikave dhe aktivitetëve promovuese që do ta bënte Kosovën destinacion atraktiv për IJD.
- 2) Gjatë viteve 90-ta IJD në vendet në zhvillim janë rritur me dinamikë më të shpejtë se sa instrumentet tjera të financimit. Kjo ka kontribuar shumë në zhvillimin ekonomik. Është vërejtur një ndërlidhje pozitive ndërmjet IJD dhe rritjes së Bruto Produktit Vendor (GDP). Kështu që vendet e zhvilluara janë ofruesit por edhe shfrytëzuesit më të mëdhenj të IJD, dhe se ekziston një trend në rritje të rrjedhës së IJD për në vendet e zhvilluara. Janë disa faktorë të cilët kontribuojnë që një vend të jetë atraktiv për IJD, duke përfshirë rrethinën stabile financiare, liberalizimin dhe ristrukturimin, konkurrencën e lirë dhe lojale, politikën tatimore të favorshme, mbrojtjen e të drejtave pronësore, potencialin eksportues dhe lirinë në riatdhesimin e fitimit.
- 3) Derisa Rregullorja e vitit 2001 mbi Investimet e Huaja në Kosovë ofron një kornizë solide moderne për IJD, rregulloret, ligjet dhe politikat tjera ende nuk janë implementuar. Kosova e pas luftës ka nevojë për investime substanciale të cilat më së shumti mund të arrihen përmes IJD. Së këndejmi, IJD në formë të kapitalit të rrezikuar janë një alternativë për kreditë e bankave të cilat ngarkohen me kamatë, dhe kështu IJD do ta plotësonin boshllëkun e nevojave për investime në Kosovë. Ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë në nivelin dhe destinimin e IJD në Kosovë, prej të cilëve më i rëndësishmi është statusi ndërkombëtar i pa definuar i Kosovës, mungesa e tregut financiar dhe bursës dhe, nevoja për ta përkrahur procesin e privatizimit.
- 4) Sikur edhe në fushat tjera të ekonomisë, mungesa e të dhënave dhe informatave paraqet kufizimin kryesor në analizën e vëllimit dhe strukturës së IJD, trendeve dhe problemeve që e shoqërojnë dukurinë e IJD në Kosovë. Të dhënat aktuale më të nevojshme janë të pakompletuara, kurse edhe një pjesë e atyre në dispozicion nuk janë aq të besueshme. Për të fituar të dhëna plotësuese mbi karakteristikat elementare për IJD e tanishme në Kosovë, dhe për të matur perceptimin e investitorëve mbi rrethinën afariste, Riinvesti

ka anketuar 38 ndërmarrje të cilat kanë realizuar investime të huaja në ndonjë formë (investime të përbashkëta). Disa prej rezultateve kryesore të këtij anketimi janë:

- (i) Pjesëmarrja e kapitalit të partnerëve të huaj në investimet e përgjithshme prej 23 milion € në 38 ndërmarrjet e anketuara është afër 51%. Mesatarja e investimeve të huaja për një ndërmarrje të anketuar është 307,023 €.
  - (ii) Afër 53% e kapitalit të huaj në ndërmarrjet që janë anketuar është në formë të investimeve të përbashkëta dhe transferit teknologjik, pastaj vjen forma e investimeve direkte me 39% dhe format tjera me 8%.
  - (iii) Sektori i shërbimeve financiare është identifikuar si destinacioni më i përhapur i IJD në Kosovë, pastaj vijnë përpunimi i drurit, materiali ndërtimor, industria kimike, industria plastike dhe, industria e gomës. Sektori i bankave dhe sigurimeve kanë absorbuar 19.3 milion € të investimeve të huaja. Për këta sektorë Kosova është identifikuar si treg atraktiv, ndonëse rendësia e tregut rajonal është gjithashtu faktor i këtyre vendimeve investive.
  - (iv) Turqia, Italia dhe Gjermania janë identifikuar nga ndërmarrjet e anketuara si investitorët më të mëdhënj.
  - (v) Ndërmarrjet në përgjithësi identifikojnë partnerët e tyre nëpërmjet kontakteve personale ose përmes vizitave dhe rekomandimeve nga miqtë për shkak të mungesës dhe qasjes në informatat e nevojshme zyrtare.
  - (vi) Afaristët mbështesin trajtimin e barabartë për investitorë e vendit dhe të huaj, që është definuar në Rregulloren mbi Investimet e Huaja. Mirëpo, rezultatet e anketimit tregojnë për pasigurinë e investitorëve të huaj, dhe mbrojtjen e pamjaftueshme nga legjislacioni ekzistues, pasi që 37% e të anketuarve ndihen të pasigurt, dhe 34% ndihen mesatarisht të mbrojtur.
  - (vii) Anketa e Riinvestit me NVM-të në Kosovë tregon një interesim të madh të NVM-ve për të hyrë në partneritet me investitorët e huaj. Kështu psh. të dhënat mbi gjendjen aktuale tregojnë se vetëm 34% e NVM-ve të anketuara kanë pasur sukses në vënien e kontakteve me partnerët e huaj, kryesisht në marrëshënie tregatë.
  - (viii) Është prezentuar një potencial i madh i kapitalit të Diasporës Kosovare, e cila numëron rreth 25% të popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Dërgesat financiare të Diasporës në Kosovë për një vite sillen diku ndërmjet 400 deri 500 milion €. Ndërmarrësit e anketuar e konsiderojnë kapitalin e Diasporës si burim financiar të rendësishëm dhe potencial. Anketat tjera të Riinvestit, siç është ajo e familjeve, kanë dëshmuar se një pjesë e konsiderueshme e këtyre mjeteve shfrytëzohen për konsum dhe investime në përmirësimin e kushteve të banimit të familjeve ose ndërtimin e shtëpive të reja, dhe vetëm 9% e dërgesave financiare janë investuar në bizneset prodhuese. Ende nuk janë krijuar mekanizma efektiv për mobilizimin e kapitalit të Diasporës për shfrytëzim më të mirë ekonomik.
- 5) Prej 14 pengesave për IJD të cilat ndërmarrjet e anketuara i kanë ranguar, korrupcioni dhe mungesa e garancioneve për investime të jashtme janë konsiderur si pengesat më

të mëdha (shiko grafikun 1). Sidoqoftë, dallimi ndërmjet pengesës me intensitet më të lartë (10.4) dhe asaj më të ultë (4.7) nuk është shumë i madh, dhe kjo do të thotë se krijuesit e politikave duhet t'i adresojnë të gjitha pengesat që janë prezente, duke i dhënë prioritet atyre me intensitet më të lartë.

- 6) Përveq pengesave për IJD në Kosovë, është e njohur se edhe vendet në rajon mbesin prapa në promovimin e një mjedisi miqësorë për IJD. Evropa Juglindore (EJL) është shumë prapa në promovimin e mjedisit miqësorë për t'i tërhequr IJD në krahasim me Evropën Qendrore (EQ), e kjo është e lidhur me reformat ekonomike dhe institucionale, ndërtimin institucioneve demokratike dhe krijimin e një mjedisi makroekonomik atraktiv. Gjithashtu, tregtia ndër rajonale në ELJ përbën jo më shumë se 6-10% të tregtisë së përgjithshme të një vendi me vendet tjera në rajon, duke përjashtuar në këtë rast Kosovën, e cila 60% të tregtisë së përgjithshme e realizon me vendet në rajon. Është interesante se në kuadër të pengesave për bashkëpunim ndër rajonal, infrastruktura e pazhvilluar është ranguar si pengesa kryesore për Kosovën, por në vendin e pestë në vendet tjera. Vendet e EJL e kanë ranguar problemin e doganave si pengesën kryesore për bashkëpunim tregtar, ndërsa në Kosovë kjo pengesë është ranguar si e dyta. Përveq kësaj, Kosova ka probleme specifike në tregti me IRJM, Serbinë dhe malin e Zi, siç është mungesa e reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare dhe tatime/ngarkesat specifike për mallra transit.
- 7) Vendet e Bashkësisë Evropiane (BE) janë investitorët më të mëdhenj në rajon. Kroacia, bullgaria dhe Rumania kanë realizuar më shumë IJD se sa Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, "RFJ" dhe IRJM (shiko Aneksin 3). Në përpjekjet e tyre për ta formuar një kornizë uniforme dhe transparente për investime në sektorin privat, qeveritë e EJL së bashku me partnerët tyre në Paktin e Stabilitetit janë duke implementuar "Pakon për Reforma, Investime, Integritet dhe Rritje". Kjo pako përkufizon agjendën e reformave për trajtim të drejtë dhe jo diskriminues për investitorët e vendit dhe ata të huaj, duke garantuar mbrojtjen e plotë të të drejtave të tyre pronësore nëpërmjet zbatimit administrativ dhe juridik të marrëveshjes. Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u duhet të bëjnë përpjekje dhe punën e nevojshme për t'iu bashkuar vendeve në Pakon për Investime.
- 8) Rrethina aktuale e politikës ekonomike dhe korniza makroekonomike janë duke i adresuar çështjet e IJD në mënyrë jo adekuate. Së pari, ekzistojnë dallime të dukshme ndërmjet: (i) GDP-së dhe konsumit, (ii) kursimeve dhe investimeve vendore, (iii) nevojave për investime publike dhe kapacitetit të buxhetit, (iv) eksportit dhe importit, dhe (iv) papunësisë dhe nivelit të investimeve. Ndhimat financiare ndërkombëtare dhe donacionet i kanë zvogëluar deri diku këto dallime, por financimi nga këto burime pritet të zvogëlohet në vitet vijuese. Përpjekjet duhet të drejtohen kah zvogëlimi i këtyre shpërpjestimeve. Rritja e eksportit dhe reduktimi i evazionit fiskal janë ndër masat prioritare. Njësia për Analiza Makroekonomike pran AQF-së/Ministritë për Ekonomi dhe Financa, është duke e realizuar një nevojë të madhe për informata në dobi të investitorëve të jashtëm mbi treguesit ekonomik aktual në Kosovë. Ende mbetet shumë punë për t'u bërë për krijimin e një sistemi modern të kontabilitetit në nivel kombëtar dhe të përkrahet një bazë efikase e të dhënave statistikore me kontributin e Entit Statistikor të Kosovës (ESK).

Një fushë tjetër e mundshme për tërheqjen e IJD është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) dhe reformimi i ndërmarrjeve publike duke u bazuar në Rregulloren e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM). Modelet dhe programi i privatizimit duhet të promovohen në mënyrë ofanzive të investitorët privat të vendit dhe të huaj. Suksesi i privatizimit do ta rritë rrjedhën e IJD dhe investimeve tjera private.

Liberalizimi i tregtisë së jashtme në Kosovë ka shpër deri te një konkurrencë nga importi ndaj ndërmarrjeve vendore. Çrregullimet e tregut u krijuan për shkak të raporteve fiskale asimetrike me vendet fqinje që u reflektuan negativisht në aftësinë konkurruese të Kosovës si në tregun e jashtëm ashtu edhe në atë të vendit.

Statusi i pa definuar i Kosovës krijon vështirësi në krijimin e një rrethine për mbështetjen e IJD-ve. Për derisa të mbetet pezull kjo çështje, atëherë nuk mund të nënshkruhen marrëveshje bilaterale me disa vende dhe institucionet ndërkombëtare financiare dhe jo financiare. Përshpejtimi i statusit të Kosovës në raport me institucionet ndërkombëtare në kuadër të Rezolutës 1244 dhe Kornizës Kushtetuese do t'i jepte mundësi Kosovës ta shpejtoj bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar.

Sistemi modern fiskal dhe i tatimeve janë duke u ndërtuar. Megjithatë, vërejtjet kryesore të ndërmarrjeve janë drejtuar kundër tarifave dhe TVSH-së për mallrat prodhuese, që janë bërë pengesë për shpejtimin e investimeve. Evazioni fiskal është pengesë për politikën moderne të tatimeve dhe konkurrencën lojale.

Një pjesë e konsiderueshme e ligjeve komerciale të aprovuara dhe Rregullorja mbi Investimet e Huaja, i plotësojnë standardet e ekonomisë së tregut. Mirëpo, pakoja e ligjeve komerciale dhe ligjeve tjera ende nuk është kompletuar dhe për pasojë nuk janë implementuar. Prandaj, mungesa e efekteve sinergjike ende nuk është duke i vërejtur sa duhet përparësitë e sistemit ligjor të Kosovës.

- 9) Në promovimin e IJD-ve janë të angazhuar disa akterë: Qeveria, Oda ekonomike e Kosovës, USAID-KBS, Euro Info Qendra, Seisscontact, dhe zyrat përfaqësuese të shteteve të huaja. Por, aktualisht mungon kordinimi ndërmjet akterëve të ndryshëm, mungon organizimi për kordinim dhe strategjia e promovimit. Është e nevojshme të adresohet kjo situatë në të ardhmen e afërt krahas promovimit të përparësive që i ka Kosova, dhe krijimin e një imazhi të mirë për Kosovën. Duhet të ndërmirret një fushatë institucionale për t'i theksuar përparësitë e Kosovës në krahasim me destinacionet alternative në Ballkan dhe Evropën Qendrore, siç janë:

- a. Pozita qendrore gjeografike
- b. Disponimi me pasuri natyrore me çmime konkurruese
- c. Territori në brendësi të Evropës
- d. Lidhjet me shumë vende të Evropës dhe SHBA-ve nëpërmjet Diasporës
- e. Popullsia e re dhe relativisht e arsimuar
- f. Aftësitë e mira teknike
- g. Motivimi i fuqisë punëtore
- h. Fuqia e lirë punëtore
- i. Niveli i ultë i tatimeve të brendshme
- j. Valuta stabile (Euro) dhe inflacioni i ultë
- k. Eksporti i liruar nga TVSH-ja dhe tarifatat doganore

- l. Tregtia e lirë me Bashkësinë Evropiane pothuajse për të gjitha mallrat në kuadër të Procesit për Stabilizim dhe Asocim)
- m. Fuqia e lartë blerëse nepërmjet dërgesave financiare nga bota e jashtme

## REKOMANDIMET

Akterët e politikave duhet të luajnë rol më aktiv në krijimin e një ambienti miqësor për IJD-të në Kosovë duke krijuar praktika të mira dhe koordinuar përpjekjet për adresimin e këtyre çështjeve:

(1) Praktikave dhe përvojat ndërkombëtare duhet të shërbejnë si bazë për krijimin e një rrethine investive më miqësore. Për ta bërë këtë me sukses, Qeveria dhe UNMIK-u duhet të përqendrohen në aktivitetet si vijojnë:

- Përmirësimin sistematik të stabilitetit politik dhe gjendjen e sigurisë;
- Rritjen e vetëdijësimin të komunitetit të biznesit dhe opinionit publik se sa i rëndësishëm është roli i sektorit privat në promovimin e progresit ekonomik dhe krijimin e ekonomisë së tregut;
- Mbrojtjen e konkurrencës lojale duke reduktuar evazionin fiskal dhe intensifikimin e vazhdimësisë së masave sistematike kundër korrupsionit;
- Lehtësitë për eksport përmes krijimit të identitetit tregtar të Kosovës dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me vendet fqinje dhe vendet tjera për t'i eliminuar pengesat administrative, si psh. njohja e çertifikatës së origjinës Kosovare dhe respektimi i parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare;
- Ndërmarrjen e të gjitha masave për t'i përmbushur standardet dhe kriteret që kërkohen nga Marrëveshja për Investime në kuadër të Paktit të Stabilitetit (boksi në faqen 30) me qëllim që të ndërtohet një kornizë stabile, transparente dhe e unjësuar për investime në sektorin privat;
- Promovimi i programit të privatizimit të investitorët potencial, zhvillimi dhe publikimi i referencave udhëzuese mbi procedurat e politikës operative dhe ndërtimi i praktikave transparente që lidhen me implementimin e Rregullores mbi AKM-në e cila do t'i inkurajonte investitorët e vendit dhe të huaj;
- Kompletimi i kornizës ligjore duke aprovuar ligjet dhe rregulloret që janë në pritje për Privatizimin/Ligji mbi Shfrytëzimin Afat-gjatë të Tokës, Ligji mbi Hipotekën, Ligji mbi Bankrotimin, Ligji mbi Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji mbi Tregtinë e Jashtme, Ligji mbi Tregun Financiar dhe Bursën dhe, Ligji mbi të Drejtat Pronësore. Ligjet në të cilat janë bërë plotësimet e duhura duhet të fillojnë të implementohen dhe fuqizohen juridikisht, dhe me anë të kësaj të forcohet rregullative ligjore;
- Duke u bazuar në shembullin e marrëveshjes OPIC, të arrihen marrëveshje të ngjashme me agjencitë e ndryshme të Evropës dhe rajoneve tjera.

(2) Masat në kuadër të politikave duhet të drejtohen kah krijimi i një sistemi bankar efikas, i cili do të ofronte:

- Nxitje më të mëdha dhe norma më të mira të kamatës për kursimet në formë të depozitave afatgjate, që do të mundësonin dhënie të kredive afatgjate
- Rritjen e mëtejme të konkurrencës dhe futjen në përdorim të instrumenteve garantuese për të stimuluar norma më të ulta të kamatës për kreditë investive

- Implementimi i praktikave të përparuara të sistemit bankar që e lehtësojnë tregtinë, psh. futja në përdorim e Kambialit dhe Garancioneve Bankare.
- (3) Duhet të ekzistoj një përkrahje solide për aktivitetet e planifikimit urban dhe hapsinor nën juridiksionin e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor dhe komunave, për të siguruar një ambient urban të favorshëm për qasje më të lehtë ndaj lokacioneve të përshtatshme për afarizëm. Kjo gjithashtu përfshinë thjeshtëzimin e procedurave administrative dhe zvoglimin e shpenzimeve për marrjen e lejeve për investime të reja;
  - (4) Krijimi i sistemit për kontakte institucionale me Diasporën Kosovare, dhe shmangjen e fragmentimit që mund të vie si rezultat i interesave të bazuara në organizimin politik, por në favor të formave organizative me atributet Kosovare dhe Komunale që kanë për qëllim mobilizimin e kapitalit financiar dhe njerëzor për investime në Kosovë. Të elaborohet koncepti i fondeve investive me kapital të Diasporës dhe promovimi i tyre si gjenerator i investimeve potenciale. Kjo mund të realizohet në bashkëpunim me qeveritë dhe bankat e vendeve korresponduese;
  - (5) Të inkurajohen akterët e ndryshëm në promovimin e IJD me qëllim që të krijohet një trup koordinues në nivel të Qeverisë ose Ministrisë së caktuar në funksion të aktivitetve promovuese më të qëndrueshme të drejtuara kah promovimi i Kosovës si destinacion investues. Është e nevojshme të arrihet një koordinim dhe efekte më të mëdha në aktivitetet e ndryshme që janë prezentuar në kapitullin 7 të këtij raporti. Gjithashtu, duhet të merret parasysh themelimi i Agjencisë për promovimin e IJD;
  - (6) Zhvillimi i sistemit informativ dhe statistikave adekuate mbi rrjedhën dhe analizën e trendeve të IJD, do të ishte njëra prej aktiviteteve të rëndësishme të Qeverisë, e sidomos e Entit Statistikor të Kosovës.



## 1. HYRJE

Ky Raport u adresohet çështjeve lidhur me rendësinë dhe promovimin e investimeve të jashtme direkte në Kosovë dhe është përgatitur si pjesë e projektit “Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shoqërisë Civile” të cilin Instituti për Hulumtime Zhvillimore “Riinvest” e realizon në bashkëpunim me Qendrën për Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private (CIPE) nga Washington D.C., dhe në mbështetje të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Projekti është i fokusuar në përparimin e reformës ekonomike përmes ngritje së cilësisë dhe nivelit të pjesëmarrjes së subjekteve Kosovare në debatimin dhe diskutimin e politikave ekonomike. Gjer më tani projekti ka adresuar këto aspekte: (i) Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, (ii) Politika e tatimeve, (iii) Financimi dhe zhvillimi i NVM, (iv) Reforma e sistemit të pensioneve, (v) Zhvillimi ekonomik lokal dhe (vi) Konferenca ndërkombëtare mbi privatizimit e ndërmarrjeve shoqërore dhe reformën e shërbimeve publike. Ky Raport paraqet modulën e fundit të këtij projekti dy vjeçar në fushën e kërkimeve mbi reformat dhe politikën ekonomike, dhe do të prezantohet në sesionin e shtatë të Tryezës së Forumit Ndërkombëtar.

Qëllimet e Raportit dhe sesionit të Tryezës së Forumit Ndërkombëtar janë që:

- (i) Të përmirësojë nivelin e informimit mbi gjendjen e pikërishtme lidhur me IJD dhe rendësinë e tyre,
- (ii) Të inicojë debat të gjerë dhe të angazhuar për ngritjen e vetëdijimit mbi problemet prezente në fushën e politikave të nevojshme ekonomike për përballimin e tyre,
- (iii) Të rekomandojë një seri masash konzistente të politikave dhe aktiviteteve promovuese për rritjen e kapaciteteve Kosovare për terheqjen e investimeve të huaja.

Në raport hulumtues janë adresuar këto qëllime specifike:

- Analizimi i çështjeve specifike lidhur me investimet e huaja në Kosovë në periudhën e pas luftës,
- Identifikimi i pengesave (gjeografike, institucionale dhe administrative),
- Identifikimi i elementeve themelore të strategjisë për terheqjen e investimeve të huaja (korniza legjislative, institucionet e promovimit),
- Rekomandimi i masave të politikave ekonomike për krijimin e një ambienti më të favorshëm institucional për stimulimin e tërheqjes së investimeve të huaja dhe,
- Prezentimi i përvojave ndërkombëtare në terheqjen e investimeve të huaja.

Përgatitjes së raportit i kanë paraprirë një sërë aktivitete:

- (i) Komunikimi dhe mbledhjet punuese me akterët kyç të involvuar lidhur me IJD në Kosovë,
- (ii) Anketimi i 38 ndërmarrjeve Kosovare të regjistruara me pjesëmarrje të kapitalit të huaj.
- (iii) Realizimi i vizitave studiu në rajon me qëllim të analizimit të përvojave të deritashme në tërheqjen e investimeve të huaja

### (i) Komunikimi dhe mbledhjet punuese me akterët kyç të involvuar lidhur me IJD në Kosovë

Janë realizuar takime, biseda dhe konsultime me një numër të madh të institucioneve qeveritare dhe të UNMIK -ut dhe me segmente të shoqërisë civile të cilat janë të involvuara në rindërtimin e vendit dhe në monitorimin e reformës së politikave ekonomike. Në këto takime janë trajtuar aspekte të veçanta të gjendjes aktuale në fushën e investimeve të huaja, si dhe mundësitë për krijimin e një klime më të favorshme investuese duke shfrytëzuar përvojën e të tjerëve. Sidomos të dobishme ishin takimet me këto institucione dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare:

- Shtylla e IV-të e UNMIK-ut, Autoriteti Qendror Fiskal (AQF) dhe, Agjencia e Kosovës për Mirëbesim (AKM) (aspektet e përgjithsme, reforma e politikës fiskale, programi i privatizimit, kompletimi i kornizës ligjore për Tregti dhe Investime),
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Aspektet makroekonomike)
- Ministria e Industrisë dhe Tregtisë (Politikat ekonomike),
- Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale ( Punësimi, Ligji i punës),
- Ministria e Ambientit dhe Planifimit Hapësinor (Parakushtet urbanistike),
- Autoriteti i Bankave dhe i Pagesave (Investimet e jashtme në sektorin financiar dhe aftësimi i sistemit të bankave)
- Oda Ekonomike e Kosovës (Promovimi),
- USAID KBS (Promovimi i eksportit dhe i investimeve të huaja),
- Euro Info Qendra Koresponduese (Promovimi),
- KREF (Realizimi i projekteve konkrete),
- EURECNA Projekti (Promovimi),
- Biseda me një numër i kompanive të Kosovës të cilat janë duke punuar me pjesëmarrje të kapitalit të huaj dhe Kosovar – afaristë në diasporë (Diskutimi i pengesave).

Konferenca ndërkombëtare mbi privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe reformën e shërbimeve publike e organizuar nga Riinvesti në Qershor, 2002 ka reflektuar edhe interesin e shtuar të Kosovarëve për tërheqjen e investimeve të huaja në ekonominë e vendit, si parakusht i realizimit të privatizimit nëpërmjet modelit “Spin-off”. Rezultatet e kësaj Konference janë shfrytëzuar gjatë hartimit të këtij Raportit hulumtues, e sidomos lidhur me propozimin e rekomandimeve të politikave ekonomike.

### (ii) Anketimi i 38 ndërmarrjeve Kosovare të regjistruara me pjesëmarrje të kapitalit të huaj në sektorët e ndryshëm

Me qëllim të begatimit të përmbajtjes së Raportit, analizimit të gjendjes ekzistuese dhe identifikimit të pengesave për tërheqjen e investimeve të huaja në Kosovë, Riinvesti ka përgatitur dhe implementuar anketën me kompani që kanë afarizem me kapital të huaj. Mostra ka përfshirë 60 ndërmarrje nga 318 ndërmarrje të regjistruara me pjesëmarrje të kapitalit të huaj apo 12% të këtyre ndërmarrjeve. Mirëpo gjatë realizimit të punës në terren me 22 prej tyre nuk ka qenë e mundur të vëhen kontakte.

Në pyetësor janë adresuar këto çështje kryesore:

- Shuma e investimeve të huaja,
- Kanalet komunikuese të investitorëve,
- Profili i investimeve të huaja,
- Motivet e investimit,
- Investimet e huaja sipas sektorëve,
- Pengesat,
- Tregu,
- Legjislacioni,

(iii) Janë realizuar vizita studijuese në IRJM, Mal të Zi, Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë

Nga bisedat me zyrtarët e institucioneve të këtyre vendeve është fituar përshtypja se është bërë shumë pak në tërheqjen e investimeve të huaja si rezultat i imazhit të dëmtuar të këtyre vendeve dhe progresit të kufizuar në realizimin e reformave ekonomike. Mësimet lidhur me politikat që duhet zbatuar për tërheqjen e investimeve të huaja dhe lehtësimi i qasjes së investitorëve të huaj në ekonominë e Kosovës kanë rëndësi të vecantë për përpjekjet e UNMIK-ut dhe Qeverisë së Kosovës për krijimin e një klime dhe imixhi më të mirë në vend. Për të ilustruar më mirë përvojat ndërkombëtare Riinvesti ka vënë kontakte me Institute partnere nga rajoni. Kontributet e tyre prezentohen në anekset e Raportit.

Në kuadër të projektit “DELTA” të cilin Riinvesti është duke e realizuar në mbështetje të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Institutin për Shoqëri të Hapur (OSI) nga Budapesti, i cili ka të bëjë me aftësimin e komunave të Kosovës në hartimin e strategjive për zhvillimin lokal dhe mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), janë realizuar disa vizita dhe biseda të dobishme. Këto vizita janë shfrytëzuar edhe për analizimin e aktiviteteve në komuna lidhur me klimën ekzistuese për investime dhe nivelin e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike në këtë fazë të zhvillimit.

Gjatë realizimit të aktiviteteve dhe në përgjithësi të punës hulumtuese ekipi i projektit ka pasur një bashkëpunim të mirë me mediat. Nëpërmjet komenteve, intervistave, analizave dhe prezentimit të rezultateve preleminare të hulumtimit në media është krijuar një advokim pozitiv i çështjeve që kanë të bëjnë me inkurajimin e investimeve të huaja. Sesi i shtatë i Tryezës së Forumit Ndërkombëtar është një mundësi për mediat për të dërguar porosi promovuese që dalin nga rekomandimet e Raportit dhe diskutimet e pjesëmarrësve në Forum.

Në zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese Riinvesti ka pasur mbështetje teknike dhe financiare të misionit të USAID-it në Prishtinë dhe të CIPE-s nga Uashingtoni. Në punët hulumtuese Riinvesti ka bashkëpunuar me Znj. Carmen Victor, eksperte e kontraktuar nga CIPE, kontributi i të cilës ka qenë i rëndësishëm në realizimin e aktiviteteve. Raporti i përgatitur nga Znj. Victor është shfrytëzuar sidomos në pjesën e Raportit që ka të bëjë me strategjinë e promovimit. Shfrytëzojmë rastin që të falenderojmë të gjithë partnerët dhe bashkëbiseduesit për kontributin e tyre në përgatitjen e këtij Raporti.

## **2. RËNDËSIA E INVESTIMEVE TE JASHTME DIREKTE NË MOMENTIN AKTUAL TË ZHVILLIMIT TË KOSOVËS**

Investimet e jashtme direkte (IJD) kanë një rëndësi të pasaçme dhe specifike për Kosovën duke pasur parasysh kushtet në të cilat duhet të realizohet zhvillimi ekonomik. Situata specifike e Kosovës në këtë aspekt ka të bëjë sidomos me:

- Statusi ende i padefinuar politik ka krijuar vështirësi për marrjen e huave nga institucionet financiare ndërkombëtare,
- Asistenca e jashtme financiare në formë të donacioneve për investimet kapitale parashihet të zvogëlohet në mënyrë të ndieshme pas vitit 2003,
- Sistemi i Bankave në Kosovë ende nuk është i aftësuar për livrimin e kredive aftagjate dhe në vëllim më të madh për të mbështetur investime me serioze,
- Mungesa e tregut financiar dhe tregut të letrave me vlerë,
- Zbatimi i procesit të privatizimit i cili duhet të fillojë në bazë të rregullorës mbi AKM synon të tërheqë investitor të jashtëm,
- Dergesat financiare – remitancat, nga emigrantet Kosovar në Europën Perendimore dhe SHBA pritet të zvogëlohen në kushtet kur shumë Kosovar po tërheqin familjet e tyre në vendet ku janë vendosur,
- Nevojat e mëdha për investime në infrastrukturën publike dhe në sektoret e tjerë për krijimin e vendeve të punës dhe përballimin e problemit të papunësisë,
- Niveli i papunësisë i lartë.

Duke pasur parasysh këto fakte është e qartë se Kosova ballfaqohet me burime të reduktura për financimin e investimeve, në kushtet kur domosdo përballet me presionin dhe nevojën imanente për të zgjidhur problemin e papaunësisë (norma e vlerësuar e papunësisë 45-50%) dhe përmisuar infrastrukturën publike. Gjendja aktuale në sektorin e energjetikës, telekomunikimeve dhe transportit rrugor mund të konsiderohet si faktorë limitues në zhvillim që tani. Aktiviteti investues i biznese private në periudhën e pasluftës ka gjeneruar rritje të konsiderueshme ekonomike dhe të punësimit, por që tani vërehen shenja të recesionit në kuptim të rënies së vëllimit të qarkullimit mesatare për një ndërmarrje dhe rritjes së punësimit (Riinvest: Anketa e NVM 1999, 2000,2002).

Në këto kushte, krijuesit e politikave ekonomike sfidohen me nevojën e nxitjes së investimeve të reja. Prandej krijimi një ambienti miqësor afarist dhe ambientit adekuat institucional për tërheqjen e investimeve të jashtme direkte imponohet si një nga prioritetet më të rëndësishme të politikave ekonomike dhe reformës ekonomike. Është e kuptueshme se vetëm IJD nuk mund t'i shpejtojnë aktivitetet mëse të domosdoshme investuese. Synimi duhet të jetë që ato të bëhen një burim i rëndësishëm dhe komplementar me burimet e tjera të financimit.

Përvoja e zhvillimit ekonomik në dekadat e fundit e sidomos kur është fjala për vendet në zhvillim ka vënë në pah se IJD (private), konsiderohen të rëndësishme për shkak të efekteve të tyre të shumëanshme pozitive e sidomos për shkak se:

- Është konstatuar një lidhje pozitive midis IJD dhe rritjes së GDP-së (Bruto Produktit të Vendit), në saje të rritjes së mundësive eksportuese dhe efekteve stimuluese në bizneset lokale dhe përmirësim të konkurrencës,

- IJD sigurojnë efekte më të mira për zhvillim të qëndrueshem se sa huatë në formë të kredive, për shkak të involvimit direkt të investuesit në menaxhmet dhe reduktimit të ngarkesës me borje,
- Nxitjes së zhvillimit social dhe zhvillimit të kapitalit human në saje të transferit teknologjik, dijeve të reja dhe trajnimit,
- Efekte pozitive në buxhet: rritjes së të ardhurave buxhetore që vjen si rezultat i rritjes së taksave dhe zvogëlimit të nevojës së subvencioneve për shërbimet publike.

Është e qartë së për të gjitha këto arsye, në Kosovë nevojitet një politikë aktive që do të përmirësonte promovimin e mundësive të bashkëpunimit me investitorët e jashtëm, rritjen e aftësive konkurruese në tregun e IJD dhe, rritjen e aftësive absorbuese për partneritet dhe investime të përbashkëta.

### 3. PASQYRË E SHKURTËR E TRENDEVE TË PËRGJITHSHME TË IJD

Gjatë viteve të nëntëdhjeta trendet globale të rrjedhes së investimve të jashtme direkte kanë pasur një rritje të vazhdueshme. Rritja e tyre ka qenë dukshëm më stabile dhe e qëndrueshme në krahasim me të gjitha instrumentet e financimit (rrjedhës së kapitalit) në shtetet në zhvillim (tregu financiar ndërkombëtar, huatë ndërshtetërore, kreditë bankare, fondet qeveritare dhe portfoliot investive). IJD në shtetet në zhvillim janë rritur nga rreth 1 miliardë US\$ në vitin 1990 në rreth 12 miliardë US\$ në vitin 1998 (Private Capital Flows to Developing Countries - ECOSOC 2000).

Në tabelen e mëposhtme paraqiten trendet e IJD në/nga rajonet e caktuara:

Tabela 1: Pasqyra rajonale e IJD, (në miliarda USD)

Rajoni	Investime në rajon	Investimet nga rajoni
Amerika Latine	71	15
Azia & Pacifiku	85	36
Europa Qendrore dhe Lindore	19	2
Afrika	8	0,5
Amerika Veriore	193	110
Europa Perendimore	237	406

Burimi: Foreign Direct Investment: A Lead Driver for Sustainable Development, Toward Earth Summit 2002, Economic Briefing Series No.1)

Nga tabela e sipërme është e kurtë se përfituesit më të mëdhenj nga rrjedha neto e IJD janë: Amerika Latine, Azia e Pacifiku, Amerika Veriore, Europa Qendrore dhe Lindore, Afrika, ndërkaj bilans negativ të rrjedhave të IJD ka vetëm Europa Perendimore, e cila investon më tepër në rajonet e tjera se sa që pranon investime. Përgjithsisht mund të konstatohet se 92% e investimeve e kanë origjinën nga vendet e zhvilluara dhe se 72% e tyre prap kthehen në këto vende (UNKTAD 1999).

Sektorët më tërheqës për IJD në vendet në zhvillim dhe në vendet në tranzicion janë minierat, xehoret, metalet, prodhimi i ushqimit dhe sektorët tradicional të industrisë, industria kimike, shërbimet dhe infrastruktura publike, (sidomos energjetika dhe telekomunikimet).

Pjesëmarrjen e madhe të IJD në investimet që bëhen në vendet në zhvillim disa ekspertë e shpjegojnë si një sinjal se burimet tjera të investimeve dhe instrumentet e tjera të financimit të zhvillimit (tregu financiar, tregu i kredise etj.) nuk janë të zhvilluara sa duhet dhe kanë potencial më të vogël (Finance and Development, June 2001, IMF). Prandaj sugjerimi kryesor është që vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion duhet të përqendrohen në përmirësimin e kushteve të përgjithshme të investimeve dhe rrethinës afariste. Përvojat kanë dëshmuar gjithashtu se efektet e IJD janë më të mëdha në vendet me nivel më të lartë të arsimimit i cili edhe e përcakton kapacitetin absorbues karshi FJD.

### **IRLANDA – NJË SHEMBULL I SUKSESSHËM**

Zhvillimi ekonomik i Irlandës ka qenë shumë i suksesshëm. Rritja vjetore e GDP-së gjatë periudhës 1993-2001 ka qenë tri here me e lartë se në pjesën tjetër të Evropës. Prapa këtij sukcesi qëndron politika afatgjate dhe konzistente e cila përfshinë: tatimi i ultë në korporata, prioriteti në promovimin industrial, ekspansioni i edukimit, qasja në Bashkësinë Evropiane, korrektësia fiskale, kontratat sociale. Edhe përparësitë tjera i kanë kontribuar këtij progresi: popullsia flet Anglisht, klima e favorshme për investime, administrata publike e zhvilluar mirë, qasja e mirë ndaj vërejtjeve publike, ryshfetet pothuajse nuk ekzistojnë, shpenzimet sociale më të vogla në krahasim me vendet kontinentale të Bashkësisë Evropiane. Pjesëmarrja e firmave të huaja në numrin e përgjithshëm të firmave në Irlandë është 49,2% (30,1% nga SH.B.A-të). Eksporti është rritur më shumë se dy herë gjatë viteve 1995-2000, dhe në të njëjtën kohë ishte në gjendje të gjenroj tepriçë tregtare. (Sipas Dr. Garret FitzGerald, ish kryeministër i Irlandës, prezentimi në konferencën e USAID-it: Ndërtimi i Përparësive Konkurruese të Kombeve – Rritja e Transparencës, Luftimi i Korrupsionit dhe Përmirësimi i Qeverisjes Korporative, Budapest, 26-28 Mars, 2002.)

Sugjerimi esencial që del nga përvoja dhe studimet e ekspertve është se duhet promovuar strategjitë zhvillimore të cilat nxisin investimet në një afat të gjatë dhe sigurojnë norma të larta të efikasitetit të tyre (ROI). Aftësitë e vendeve të caktuara për të qenë atraktive për IJD varen nga legjislacioni i cili duhet të siguron barazi në treg dhe siguri, të ketë karakter jodiskriminues dhe të promovoj praktika transparente të investimeve.

Elementet tjera të krijimit të rrethinës së favorshme janë:

- stabiliteti politik
- potencialet e tregut dhe mundësia e qasjes në tregje
- nxjerrja dhe disponimi me profit (repatriation)
- zhvillimi i infrastruktures
- lehtësitë për konversionin e valutës
- privatizimi dhe derregullimi
- konkurenca lojale
- siguria e investimeve

Një shikim tjetër i përmbledhur lidhur me atë se në cilat raste tëheqja e investitorëve të jashtëm është më e suksesshme vie nga Lord Griffiths of Fofrestfach, Nënkryetar i Goldman Sachs Europe, me një përvojë të gjatë në këshilldhënie për strategjitë zhvillimit të bizneseve mendon se tri çështjet kryesore për tërheqjen e investitorëve të jashtëm janë:

- rrethina stabile financiare (inflacioni i ultë, deficiti vogël fiskal, polika monetare e cila nuk është në favor të ekapansionit kreditor)
- liberalizimi dhe ristrukturimi (tregu i lirë, duke përfshirë edhe tregun e punës, transparenca e statistikës makroekonomike)
- liria në riatdhesimin (repatriation) e profitit

Griffits mendon gjithashtu se edhe mjedisi i mirë tregtar është më rendësi të posaçme duke nënkuptuar këtu evitimin e kontrollit të importit, heqjen e subvencioneve për eksport dhe restriksioneve në tregti, formimin e lirë të çmimeve, privatizmi, sigurimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të cilat i bëjnë kompanitë transparente. Por rendësi vitale ka gjithashtu edhe qendrshmëria dhe konsekuenca e qeverive që të zbatojnë politikat e proklamuar (Economic Reform Today, CIPE, nr. 4, 1997).

Oda Ekonomike e SH.B.A-ve ka bërë një përmbledhje të përvojave të saj se “çka i shtyen firmat Amerikane për të investuar jashtë?” Këtu ajo ka potencuar atributet e ngjashme që nxisin IJD në një vend në zhvillim, siç është madhësia dhe qasja e lirë ndaj tregut, konkurrenca, mundësitë për të eksportuar në vendet tjera në atë rajon janë të rendësishme, pastaj, kualiteti i fuqisë punëtore, mbrojtja e të drejtave pronësore, shpenzimet dhe ngargesa rregullative, tatimet, rreziku i vogël politik, Qeverisja e Parashikimeve Makroekonomike, mbështetja e sigurtë nga infrastruktura. (Për më shumë detaje shiko Aneksin 2).

#### **4. INVESTIMET E JASHTME DIRKETE NE PERIUDHËN E PASLUFTËS NË KOSOVË**

Menjëherë pas luftës, në fazën emergjente të rindërtimit të Kosovës frekuentimi i vizitave të afaristëve dhe investitorëve potencial ishte mjaft i madh. Vështrimi i situatës dhe trendeve të përgjithshme dhe të ringjalljes ekonomike dhe mundësive për të zhvilluar biznest e tyre në punët emergjente për evitimin opasojave të luftës, kryesisht furnizimi me materiale ndërtimi dhe artikuj të konsumit të gjërë dhe angazhimi në punët ndërtimore ishte motivi kryesor. Huluntimi i mundësive potenciale për aktivitete më serioze afariste siç janë IJD ishte një motiv shtesë. Kontakte intesive ka pasur sidomos me pjesëtarë të Diasporës Kosovare e cila pas shumë viteve ishte në pozitë të njifet me rrethanat e reja politike dhe ekonomike, dhe vizionet lidhur me krijimin e një partneriteti me firmat e vendit.

Fatkeqësisht këto vizita dhe iniciativa e gjetën Kosovën në një situatë të papregatitur për t’iu përgjegjur këtij interesimi: Mungesa e institucioneve, mungesa e infrastrukturës ligjiore dhe autoriteteve për komunikim në administratën publike, vështirësitë e mëdha në shërbimet publike, mungesa e sistemit financiar e në atë kohë sidomos mosekzistenca e bankave kanë pasur një ndikim të shprehur dekurajues.

Edhe tri vjetë pas luftës është shumë vështirë të analizohet dhe vlerësohet gjendja e pikrishme lidhur me IJD në Kosovë. Ende nuk është siguruar një evidence cilësore e cila do të bënte të mundur të vlerësohen permasat dhe vëllimi i IJD dhe struktura e tyre. Enti Statistikor i Kosovës (ESK) mban një evidencë nga e cila mund të nxirren fare pak informata. Kjo e vështirëson analizën mbi trendet dhe problemet me të cilat shoqërohet fenomeni i IJD në Kosovë.

Sipas të dhënave nga pasqyra e ESK në periudhen e pasluftës janë regjistruar 318 biznese me pjesëmarrje të kapitalit të huaj.

Në kuadër të përgatitjeve të këtij Raporti Riinvesti ka zhvilluar një anketë me 48 biznese në të cilat është angazhuar kapitali i investitorëve private të jashtëm anketa ka qenë e disenjuar që të sigurojë një informacion plotësues lidhur me karakteristikat elementare të këtyre investimeve si dhe perceptimet e investitorëve për mjedisin afarist.

### **Konstatimet kryesore që mund të nxirren nga kjo anketë janë se:**

#### **(1) Numri më i madh i ndërmarrjeve është regjistruar në vitin 2001.**

Më tepër se gjysma janë ndërmarrjeve individuale (53%), ndërmarrje akcionare janë (24%), ndërsa ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar (21%), ndërsa të tjerat (2%), që më tepër kanë të bëjnë me përfaqsimet.

#### **(2) Vëllimi dhe struktura e investimeve në 38 ndërmarrjet e anketuara :**

- Investimet e përgjithshme 23.0 mil. Euro,
- Investime e partnerëve të jashtëm: 11.7 mil. Euro, respektivisht 51.0 %, ndërkaq sipas parashikimeve është dashur të jetë 60%,
- Investimet e jashtme mesatare për një ndërmarrje të anketuar: 307.023 Euro,

Investimet realizuara në këto tri forma kryesore:

- (i) Investime të përbashkëta (joint venture) duke përfshirë edhe transferin teknologjik 53%,
- (ii) Investime direkte vetëm të investitorit të jashtëm 39%
- (iii) Investime në kanale distribuimi e të tjera 8%.

Preferencat sektoriale të bizneseve të anketuara janë të koncentruara në prodhim përkatësisht në industri (52%), ku pjesëmarrje më të lartë kanë përpunimi drurit, matriali ndërtimor, industria kimike plastike dhe e gomës. Tregëtia ka një pjesëmarrje prej rreth 16%, turizmi dhe restorantet 8%, ndërtimtaria 5% , shërbimet financiare 5% , transporti 3%, Bujqësia 3% , konsalting dhe të tjera 8%.

Kur është fjala për origjinën e kapitalit të bizneseve të anketuara raste më të shumta janë nga Turqia (10), Italia (7) Gjermania (6). Pataj vijjnë Zvicra (3), Sllovenia (2), Austria (2) dhe Norvegjia, SHBA, Irlanada, Maqedonia, Shqipëria, Bullgaria nga një rast dhe rastet e tjera të kapitalit të përzier nga më shumë vende.

### **INVESTIMET E JASHTME NË SEKTORIN E BANKAVE DHE SIGURIMEVE**

Sektori i Bankave dhe i Sigurimeve ishin ndër sektorët më atraktive për investimet e jashtme në Kosovë. Këta sektorë kanë absorbuar 30.6 milion €, nga e cila 19.3 (63%) është pjesëmarrja e kapitalit të huaj i cili përbëhet 13 milion € të sektorit bankar dhe 6.3 milion € të sigurimeve.

**(3) Kanalet e komunikimit dhe motivet e investimit** janë të ndryshme dhe edhe njëherë verifikojnë situatën specifike të Kosovës, përkatësisht mungesën e mekanizmave institucional për promovimin e investimeve. Për identifikimin e mundësive për realizimin e investimeve kanë shfrytëzuar kryesisht këto kanale:



- Lidhjet personale (63.2%),
- Rekomandimet e miqëve (21.1%),
- Interneti (2.6%),
- Organizatat e konsaltingut (2.6%), dhe
- Kanalet tjera (10.5%).

Motivet themelor për investim kanë të bëjnë me trgeun (48%) dhe fuqinë më të lirë punëtore (20%). Diçka intensitet më të ultë ka pëntimi në tregje të reja (15%), kthimi në Kosovë (9%) dhe motivet e tjera (8%). Është interesant se shumica e investitorëve kanë deklarura se 89% të tregut të tyre ka të bëjë me Kosovën, 5% me vendet e tjera të Ballkanit, dhe 5% me vendet e tjera. Kjo mund të shpjegohet me faktin se investimet për nga kapaciteti kanë qenë modeste dhe të motivuara për të përmbushur kërkesen në tregun Kosovar. Përmdryshe është për t'u pritur se investimet më serioze domosdo do të reflektojnë në tregun rajonal për shkak të madhësisë së tregut të Kosovës. Edhe nga përgjegjjet përshkruese në pyetjen e hapur se cilat janë shkaqet për investim në Kosovë dhe se si është marrë informata e nevojshme për destinimin e investimit në Kosovë, duket se kryesore kanë qenë nevojat emergjente të tregut dhe sepse “tregu është I favorshëm”, ndërsa investitorët të shumtën kanë mësuar nga miqët që kanë punuar në rajon (Bosne, Shqipëri) ose vetë kanë krijuar kontakte të drejtpërdrejta me Kosovën duke punuar në Kosovë pas luftës ose edhe duke e vizituar atë.

**(4) Perceptimet mbi barazinë ekonomike, legjislacionin, mbrojtjen gjyqësore dhe mbështetjen institucionale:** Legjislacioni i aprovuar lidhur me investimet e huaja është në favor të promovimit të barazisë së investitorëve të vendit dhe të jashtëm në të gjitha aspektet e qasjes në privatizim, treg dhe informata. Edhe bizneset e anketuara janë në favor të kësaj zgjidhje:

- 50% e të anketuarve preferojnë “status plotësisht të njëjtë në mes të investitorëve të vendit dhe të atij të jashtëm”,
- afër 29% status më të favorshëm për investitorët e jashtëm,
- 13% status më të favorshëm të investitorëve vendas,
- afër 8% nuk janë përgjegjur në këtë pyetje

Perceptioni mbi nivelin e mbrojtjes gjyqësore dhe ligjore shprehë një pasiguri të konsiderueshme. Përgjigjet e kompanive të anketuara reflektojnë qëndrimin se ende nuk është siguruar një mbrojtje adekuate e investitorëve dhe kapitalit të tyre. Sipas mendimeve të tyre legjislacioni i Kosovës ende nuk është i qëndrueshem dhe efektiv në aspekt të mbrojtjes së interesave në investime dhe zhvillimin e bizneseve. Pjesa më e madhe e investitorëve kanë ndjenjen e pasigurisë ose sigurisë së pjesërishme (67%). Lidhur me ata se sa investitorët e anketuar konsiderohen të mbrojtur nga legjislacioni ekzistues dëshmojnë përgjegjet e mëposhtme:

- të mbrojtur plotësisht (2.6%),
- mbrojtje e kënaqëshme (21.1%),
- mbrojtje e pjesërishme (34.2%),
- ndihen të pasigurtë (36.8%),
- pa qëndrim (5.3%).

Për investitorin e jashtëm rendësi shumë të madhe ka efikasiteti i gjyqeve dhe besimi ndaj tyre në sistemin gjyqësor. Perceptimi i të anketuarve lidhur me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre është më pozitiv. Në pyetjen se “nëse kontrata e juaj vëhët në kontest” a do të kishit besim në mbrojtje të gjyqësisë, rreth 63% kanë shprehur besim në mbrojtje të sistemit gjyqësor të Kosovës, ndërsa 29% janë shprehur skeptik lidhur me këtë (rreth 8% nuk janë përgjegjur).

Edhe rezultatet e kësaj ankete dëshmojnë se mbështetja institucionale për investitorët e jashtëm është ende shumë e vogël. Vetëm 7 (18%) prej 38 bizneseve të anketuara kanë deklaruar se kanë gëzuar një mbështetje nga institucionet që kryesisht ka pasur të bëjë me ndihmesën në gjetjen e lokacionit, dy raste përmes shërbimeve këshilluese, e një në lehtësitë nga taksat komunale.

**(5) Orientimet e NVM në Kosovë për partneritetin me investitorët e jashtëm:** Nga ana tjetër bizneset private në Kosovë janë shumë të interesuara për ndërtuar partneritet me investitorët e jashtëm. Analiza e realizuar me 619 ndërmarrje private (Riinvest, Dhjetor 2001) dëshmon se NVM planet e veta për investime të ardhshme i bazojnë edhe në mundësinë e sigurimit të resurseve financiare nga bota e jashtme. Rreth 60% nga ndërmarrjet private të anketuara janë deklaruar se janë në kërkim të partnervëve të jashtëm për realizimin e planeve të biznesit. Sipas pergjigjeve të bizneseve partneriteti me kompanit e huaja kryesisht do të orientohet në investime në projekte të reja (35.3%), zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese (42.6%) dhe me qëllim të rritjes së shitjes. Është mjaft i shprehur orientimi i bizneseve private kah investimet e reja dhe projektet e reja. Rreth 80% të ndërmarrjeve janë të preokupuara me nevojën për të investuar përkundër mungesës së mbështetjes adekuate institucionale dhe pengest tjera me të cilat ballafaqohen bizneset e Kosovës.

#### **PESTOVA**

Pestova, një ndërmarrje private afër Vushtrisë është prodhuese e patatës. Ajo ka importuar farë të patates për disa vite nga partneri "Agrico" nga Holanda, dhe ka vepruar si distributor i saj. Pronari i Pestovës, një ndërmarrës ambicioz, e ka zhvilluar projektin për përpunimin e 3500 tonëve patate në vit. Ai është në negociata me partnerin e tij për investim të përbashkët. Pestova do të investoj në token bujqësore dhe paisje, ndërsa partneri do të sigurojë njohuritë teknologjike dhe farërat e patates. Sipas pronarit, partneri i huaj është duke hezitur për shkak të tarifave dhe tatimeve me normë prej 26% që imponohen me rastin e importimit të këtyre inputeve<sup>1</sup>, që janë të me importimin e mallrave të konsumit të gjërë. Partneri i huaj nuk është i gatshëm të investoj në këto kushte, dhe të dy partnerët janë duke pritur për ndryshime eventuale.

Ndërkaq gjendja e pikërishtme është larg këtyre projeksioneve. Vetëm 34% e ndërmarrjeve të anketuara kanë kontakte me partnerët e jashtëm. Këmbimi tregtar i kompanive të vendit ka pjesëmarrje dominante në format e bashkëpunimit ekonomik dhe partneriteti (53.0%), ndërsa pjesëmarrja e formave tjera është ende e pamjaftuar: investimet e përbashkëta, 8.8% dhe përfaqësim 5.9%. (Riinvest, Anketa e NVM 2001).

Edhe në kuadër të Ndërmarrjeve Shoqërore kemi një situatë të pavolitshme sa i përket performancave eksportuese dhe krijimit të partneritetit me kompanit e jashtme. Kështu sipas Raportit të Riinvestit, 2002 në qarkullimin e përgjithshëm eksporti kishte pjesëmarrje prej 8%, ndërsa në strukturën e burimeve për investime pjesëmarrja e investimeve të huaja ishte vetëm 2%. Në një sitatë të tillë ndikim më të madhë ka pasur pozita legale e këtyre ndërmarrjeve dhe vonesat në privatizim. Aktiviteti i ndërmarrjeve shoqërore për krijimin e partneritetit me investitorët ka qenë më tepër i orientuar kah komunikimi me partnerët special dhe provokimi i interesit të tyre.

<sup>1</sup> Në këtë përfshihet dogana në lartësi prej 10% dhe TVSH-ja prej 15%. Implementimi i TVSH-së është duke hasur në një njohje jo adekuate të procedurave për ta relizuar atë.

Krijimi i partneritetit të NVM të vendit me investitorët e jashtëm sipas hulumtimeve të Riinvestit përballet kryesisht me këto pengesa: (i) sigurinë politike, (ii) legjislacionin dhe, (iii) infrastrukturën e pazhvilluar. Nga përgjegjet e tyre për pesë opcionet e dhëna lidhur me pengesat e krijimit të partneritetit, del një vlerësim mjaft i balancuar :

- siguria politike (21.6%),
- legjislacioni (21.5%),
- gjendja e infrastrukturës (19.9%),
- niveli i pamjaftuar i informatave (18.5%) dhe,
- vonesa e procesit të privatizimit (18.4%).

Nga këto përgjigje mund të nxirret përfundim se në të gjitha aspektet e indikuara me pyetjen e përmendur të anketuarit konsiderojnë të nevojshëm një angazhim serioz për të ndryshuar gjendjen.

**(6) Mobilizimi i kapitalit të diasporës kosovare:** Diaspora e gjërë Kosovare e cila sipas disa vlerësimeve mund të përfshijë rreth 25% të popullsisë Kosovare dhe nga shumë kush konsiderohet një investitor më potencial dhe i rendësishëm. Vlerësimet lidhur me dërgesat financiare nga emigrantët (remitancat) në Kosovë sillen prej 400 –500 milion € (Anketa e familjeve , Riinvest 1999, vlerësimet e AQF). Konsiderohet se shumica e këtyre mjeteve shkojnë në konsum ose investohen kryesisht në ndërtimin e shtëpive shpesh joracionale. Ende nuk janë krijuar mekanizmat e politikave ekonomike për mobilizimin e këtyre dërgesave dhe potencialeve e kursimeve që mund të ketë diaspora në aktivitete prodhuese e shërbyese dhe në krijimin e vendeve të punës. Sipas anketës së familjeve në vitin 1999 dërgesat e emigrantëve investohen vetëm në 9% të rasteve.

#### **INTERING**

Intering GmbH është ndërmarrje private e themeluar nga dy vëllëzër Kosovar – Shoshi, dhe veprimtarinë e vet e ushtron në Gjermani që nga viti 1990, në industrinë ndërtimore, e specializuar në instalime dhe termo izolime. Ajo punëson 120 punëtorë, gjysma prej të cilëve janë Kosovarë. Aktualisht ata janë të angazhuar në disa veprimtari riparuese në KEK dhe janë shumë të interesuar të kyçen në procesin e privatizimit. Ata kanë fituar përvojë relevante në Gjermaninë Lindore dhe janë sidomos të interesuar për sektorin e përpunimit të metaleve. Me përvojën e tyre në tregun Gjerman, ata nuk shohin shumë pengesa për të investuar në procesin e privatizimit dhe të jenë efikas. Ata do të dëshironin të shohin më shumë përparime në politikën tatimore dhe eliminimin e pengesave tregtare.

Opinionet e ndërmarrësve Kosovar (Anketa e NVM-ve, 2001) dëshmojnë se angazhimi dhe mobilizimi i kapitalit të diasporës konsiderohet me një rendësi shumë të madhe për Kosovën. Mbi 79.0% të ndërmarrjeve të anketuara kapitalin e diasporës e konsiderojnë shumë të rendësishëm, 17.1% e konsiderojnë mesatarisht të rendësishëm dhe vetëm 3.8% të ndërmarrjeve e konsiderojnë pak të rendësishëm. Mirëpo kontaktet e realizuara dhe efektet e arritura janë larg këtyre konsideratave.

Tabela 2: Kontaktet e ndërmarrësve Kosovarë me diasporën

Kualiteti i kontakteve	%
1. Realizoj/kam realizuar projekt të përbashket	6.1
2. Shfrytëzoj hua nga miqtë ose farefisi që punon jashtë	15.5
3. Jam në fazën e kontakteve paraprake	22.6
4. Nuk kam kontaktuar fare	54.8
5. Pa përgjigje	1.0

Burimi: Anketa e NVM, Riinvest 2001

Vetëm 6.1% të ndërmarrjeve të anketuara janë përgjigjur se kanë realizuar projekte investive me pjesëmarrje të resurseve financiare të diasporës, ndërsa 54.8% janë përgjigjur se nuk kanë kontaktuar fare. Kjo tregon për mungesën e kontakteve dhe të informatave të nevojshme nga ana e dy palëve. Nga kjo rrejdhet se duhet të forcohen projektet promovuese në Kosovë dhe të gjenden forma adekuate për krijimin e ketij partneriteti.

Në periudhën 1990 – 1999 diaspora kishte dhënë një kontribut të madh në mbështetjen e popullit të Kosovës në organizimin e funksionimit të institucioneve arsimore, shëndetësore, sociale, kulturore dhe shkencore, dhe më pak në aktivitete ekonomike dhe investuese.

Pas çlirimit të Kosovës për herë të parë krijohen rrethana më të volitshme që raporetet e solidaritetit të zëvendsohen me raporte ekonomike dhe të interesit reciprok në mes të diasporës dhe Kosovës duke pasur parasysh potencialet humane dhe financiare që disponon Diaspora dhe resurset që ka krijuar. Në fillim, në fazën emergjente, qasja e Kosovarëve nga diaspora për investime ishte e përcjellur me një dozë euforie dhe idealizim të kushteve, por së shpejti filloj të krijohet një kornizë e re e përceptimeve rreth mundësive reale për angazhim të resurseve të tyre. Në kuadër të ndërmarrjeve të formuara me pjesëmarrje të kapitalit të huaj, një numer i konsideruar ka të bëjë me angazhimin e investimeve të diasporës sidomos në programet e bizneseve prodhuese që kanë lidhshmëri direkte me projektet e rindërtimit të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe kemi iniciativë të shumëta nga diaspora, porse ende jemi larg nga realizimi i tyre pasi që edhe nga ana e saj janë duke u bërë vështirësi më reale lidhur me thellësinë e reformave ekonomike dhe përmirësimin e ambientit për investime dhe zhvillim të bizneseve dhe ambientin e përgjithshëm institucional dhe afarist.

Në kohë të fundit, Qeveria e Kosovës është duke bërë përpjekje që të krijojë ura të reja komunikimi dhe bashkëpunimi në mes të diasporës dhe Kosovës mbi bazë të projekteve investive. Lidhur me këtë janë organizuar dy konferenca: nga një në Gjermani dhe Zvicërr, ku është më së shumti e koncentruar diaspora, kurse në Tetovë pritet të jetë një Konferencë tjetër në SHBA.

Në këto tubime të pagëzuara si “Konferenca mbi Investimin në Kosovë” kanë qenë të suksesshme për nga numri i pjesëmarrësve dhe për nga hapja e një dialogu më të organizuar midis institucioneve Kosovare dhe Diasporës. Sipas raporteve, shqetësimet dhe interesimet e pjesëmarrësve janë shumë identike në një shkallë të lartë me ato të investitorëve të tjerë: kreditë dhe huatë për fillimin e bizneseve, tatimet, siguria legale, me kë të kontaktojnë, mungon ndihma dhe orientimi, mungesa e dokumenteve të udhëtimit, ristrukturimi i infrastrukturës, hapja e zyreve të ndërlydhjes e të ngjashme.

## **5. KUFIZIMET DHE PENGESAT PREZENTE PËR INVESTIMET E JASHTME NË KOSOVË**

### **5.1. INTESITETI I PENGESAVE**

Hulumtimet në kuader të përgatitjes së këtij Raporti kanë provuar ekzistimin e shumë pengesave institucionale dhe administrative për një klimë të favorshme investuese. Për të identifikuar intensitetin e pengesave të veçanta nga aspekti i investitorëve të jashtëm në anketën e përmendur me 38 ndërmarrje, të anketuarit është dashur ta përcatojnë intensitetin në listën prej 14 pengesave të cilat janë paraqitur në grafikun nr. 1.

Është e qartë se një mori e pengesave të karakterit të përgjithshëm ka ndikim më specifik në gatishmërinë e investitorëve potencial të huaj që një pjesë të kapitalit të vet ta orientojnë në projekte prodhuese dhe produktive në Kosovë. Është prezent një rangim tjetërfare i pengesave në krahasim me rezultatet e anketimit të NVM-ve tjera private të vendit. Kështu përderisa në anketën e NVM-ve si pengesë numër një është identifikuar mungesa e ligjeve dhe konkurrenca jo lojale, në rastin e ndërmarrjeve të formuara me investime të huaja në vend të parë është identifikuar korrupsioni dhe mungesa e garantimit të investimeve. Sipas rezultateve të anketimit këto pengesa kryesore kanë intensitet më të lartë në realizimin e investimeve të huaja në Kosovë:


- Korrupsioni,
- Mungesa e garantimit të investimeve,
- Tatimet e larta,
- Tregu i kufizuar,
- Stabiliteti politik,
- Telekomunikimet.

Ndërkaq pengesa me një intensitet më të dobët të ndikimit në realizimin e investimeve të huaja mund të merren:

- Mungesa e përvojës në realizimin e IJD,
- Mungesa e ligjeve,
- Lartësia e doganës,
- Statusi final i Kosovës i padefinuar, dhe
- Mungesa e përkrahjes promovuese e investimeve.

Një rangim i tillë i pengesave, sidomos i atyre me intensitet më të dobët të ndikimit, është pak a shumë befasues sidomos kur injorohen pengesat që kanë të bëjnë me statusin final të Kosovës (rangu 6%), promovimi (rangu 5%) dhe mungesa e rrymës elektrike (rangu i fundit). Lidhur me mungesën e rrymës elektrike duhet theksuar se anketimi është realizuar para se të ndodhte havoria në termocentralet e Kosovës, kur furnizimi me energji ishte përmirësuar dukshëm, ndersa për investitorët që tanimë funksionojnë në Kosovë, mospërcaktimi i statusit final nuk duket të jetë pengesë. Megjithatë një analizë më e kujdesshme tregon se ndryshimet në vlerësimet lidhur me intensitetin e pengesave të caktuara nuk janë shumë të mëdha: Intesiteti 4,7 e fundit – 10,4 e para. Kjo shpie në një konkludim se pothuajse e tërë lista e pengesave të paraqitura për vlerësime para të anketuarve, kërkon kujdesin e duhur të krijuesve të politikave.

Grafiku 1: Pengesat për investimet e jashtme



### (i) Korrupcioni

Anketa është zhvilluar në kohën kur në opinion dhe institucionet Kosovare korrupcioni dhe kriminaliteti ekonomik është identifikuar si problem shumë i mprehtë dhe pengesë për krijimin e mjedisit të shëndoshë afarist. Duke marrë parasysh efektet tejet negative të këtij fenomeni nuk është për t'u habitur se korrupcioni është ranguar në vendin e parë (Në anketën e NVM-ve është cilësuar pengesë me intensitet mesatar, në vendin e 7-të). Sipas rezultateve të anketës afro 70% e të anketuarve korrupcionin e konsiderojnë si pengesë serioze ose deri mesatare, kurse 30% konsiderojnë se është pengesë e vogël ose se nuk paraqitet fare. Lidhur me këtë është e nevojshme që lufta e deklaruar kundër korrupcionit të shëndrrohet në një sistem aktivitetesh të instituconeve dhe përkraje nga shoqëria civile dhe opinionit. Hulumtimi i 38 ndërmarrjeve nuk ka siguruar informata në lidhje me burime e ndryshme të korrupcionit. Disa tregues në lidhje me këtë fenomen mund të nxjerren nga anketa me 1,300 qytetarë Kosovarë, të cilën e ka realizuar Riinvesti në Gusht të vitit 2002 (Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, 2002). Sipas rezultateve të kësaj ankete, korrupcioni është ranguar në vendin e tretë pas pasigurisë rreth statusit final të Kosovës dhe, papunësisë, por para varfërisë, krimit, çmimeve të larta, etj. Afër 50% e të anketuarve pajtohen plotësisht se ka korrupcion në dogana, 32% në institucionet shëndetësore, pastaj, 28% në pushtetin lokal, 21% në pushtetin qendror, 20% në gjykata dhe 10% në shërbimin policor.

### (ii) Mungesa e garantimit të investimeve

Mungesa e subjektivitetit të nderkombëtar të Kosovës pengon anëtarësimin e saj në institucionet financiare ndërkombëtare që do të thotë edhe në organizatat për garantimin e investimeve siç është MIGA (Multilateral Investment Guarantee Agreements), institucion në kuadër të Bankës Botërore me rreth 157 shtete anëtare, e cila i siguron investitorët nga rreziqet jokomerciale, e që për vendet e sapo dalura nga lufta, që karakterizohen me një jostabilitet politik

ka rendësi të vaçantë. Istitucionet e tilla janë të nevojshme sidomos pas konflikteve siç është rasti me Kosovën. Për një orientim më të vendosur të investitorëve të huaj që të formojnë ndërmarrjet e veta ose të angazhohen në forma tjera, është e domosdoshme që të sigurohet garantimi i investimeve nga rreziku politik dhe çrregullimet jokomerciale të tregut kombëtar dhe veprimi retroaktiv i politikave ekonomike. MIGA ka filluar të jetë prezente edhe në rajonin tonë (Bosne e Hercegovinë, Shqipëri dhe Maqedoni, Raporti vjetor i MIGA, 2002).

Mungesa e garantimit të investimeve e konsiderojnë si pengesë serioze për rreth 45% e të përgjigjurve, 34% e konsiderojnë si pengesë mesatare, ndërsa pjesa tjetër si pengesë të vogël ose jo ekzistente.

Investitorët potencial do të dëshironin të shihnin një strategji e cila përfshinë garancione shtesë. Një shembull i tillë është marrëveshja OPIC (Overseas Private Investment Corporation – Korporata për Investimet e Huaja Private) e nënshkruar ndërmjet SH.B.A-ve dhe UNMIK-ut. (shikon aneksin 4). OPIC-u ofron garancione/risigurime për rreziqet e veçanta politike. Që investimet strategjike të vijnë në Kosovë, kërkohet një angazhim dhe përparim më i madh në sektorin publik, për të ofruar garancione shtesë. Një mekanizëm për ofrimin e risigurimit kundër rrezikut politik do të kishte efekte të shumëfishta në shfaqjen e interesimit, i cili edhe ashtu është i shfaqur nga investitorët potencial.

### **(iii) Tatimet e larta**

Instrumentet tatimore dhe lartësia e tyre kanë ndikim shpeshherë vendimtar në pruerjen e vendimeve të investitorëve të huaj për mobilizimin e resurseve të tyre në vendet tjera. Kosova gjendet në pozitë specifike sepse është duke i ndërtuar institucionet e ekonomisë së tregut dhe politikat ekonomike. Lartësia e tatimeve më tepër është në funksion të ndërtimit të një buxheti të konsoliduar dhe të qëndrueshem se sa në krijimin e lehtësirave dhe preferencialeve tatimore ndaj investitorëve potencial. Sipas rezultateve të anketës rrjedh se 42.1% të kompanive lartësinë e tatimeve e konsiderojnë pengesë serioze, 24.0% si pengesë mesatare, ndërsa 31.6% nuk e konsiderojnë fare apo shumë pak si pengesë për zhvillimin e investimeve të huaja.

#### **RENOFIX**

Renofix u themelua nga një investitor prej Tetovës (Maqedoni) dhe është shembull i një investimit me 100% kapital të huaj. Investimet e përgjithshme kapin shumën 4 milion €. Kjo ndërmarrje kohëve të fundit ka filluar me prodhimin e ngjyrave dhe punëson 20 punëtorë. Ndërmarrja do t'i ofroj produktet e veta në tregun rajonal. Gjatë intervistës, pronari u përqendrua në disa disa probleme me të cilat është duke u ballafaquar si:

- Vështirësitë në marrjen e licencës për ndërtimin e objektit, kyçja në rrjetin e rrymës, etj. Ky process me procedurat dhe shpenzimet tjera arrijnë shumën 13,000 €, dhe është dashur gati një vit për t'i siguruar të gjitha licencat që kërkohen për objekte (8,500 €), kyçja në rrjetin e rrymës, taksa komunale, ndryshimi i shfrytëzimit të tokës nga toka bujqësore në atë industriale, paisjet për mbrojtje kundër zjarrit, etj.
- Rregullat administrative nuk ishin të qarta, kështu që ai kurrë nuk ka mundur të dij se cili është autoriteti që i përcakton këto rregulla dhe se administrata nuk kishte qenë në gjendje të ofroj përkrahje.
- Tatimet – tarifat dhe TVSH-ja në paisje dhe lëndë të para janë më pak stimulative krahasuar me Maqedoninë. Rregullat e tanishme lejojnë pagesën e TVSH-së për paisje pas gjashtë muajve, ndërsa ai ishte i detyruar ta paguaj tërë TVSH-në me rastin e futjes së paisjeve dhe askush nuk e ka sqaruar pse?
- Pronari konsideron se ai do të duhej të lejohet për ta blerë token private në emër të tij.

Ndonëse skema tatimore e Kosovës dhe instrumentet e saj, krahasuar me vendet në rajon dhe vendet e tjera nuk mund të konsiderohen të larta po të krahasohen veç e veç, por edhe pse përgjithësisht ngarkesa fiskale sipas pjesëmarrjes së të ardhurave nga tatimet në GDP nuk janë të mëdha, prap se prap komuniteti i biznesit ka vërejtje serioze në strukturën e tatimeve në aspektin se ato nuk i nxisin investimet duke i taksuar një lloj paisjen dhe të mirat kapitale si dhe inputet e prodhimit. Në këto kushte disa vende fqinje kanë lehtësira dhe duke eksportuar në Kosovë, mund të krijojnë përparësi konkurruese duke e çrregulluar tregun në Kosovë dhe veshtirësuar pozitën për eksportet Kosovare.

#### **(iv) Tregu**

Në tri vitet e fundit në Kosovë ka qenë prezent një treg emergjent që kishte të bënte me servisimin e kërkesave për sigurimin e ushqimit, strehimit të të shpërngulurëve dhe të rindërtimit të shtëpive, infrastrukturës dhe të shërbimeve publike në përgjithësi. Kalimi nga peudha e rindërtimit në zhvillim të qëndrueshëm është i kushtëzuar edhe me ristrukturimin e tregut të Kosovës. Regjimi tregtar në Kosovë është plotësisht i liberalizuar pa kufizime për import dhe export, por edhe pa nxitje dhe stimulime të eksportit. Të gjitha këto kushte janë relevante me rastin e vendosjes së investitorëve potencial për transferet e tyre në Kosovë dhe në këtë drejtim në aspektin e regjimit tregtar në Kosovë gjërat duket se janë në rregull. Mirëpo, sipas rezultateve të anketës, 37% të ndërmarrjeve tregun e kufizuar e konsiderojnë si pengesë serioze, 24% e konsiderojnë pengesë mesatare, ndërsa të tjerët e konsiderojnë pengesë të vogël ose të pa ndikim relevant.

Nëse marrim parasysh madhësinë e tregut të Kosovës, atëherë është e kuptueshme se ekspansioni i biznesit domosdo do të kërkonte nga investitorët të penetrojnë në tregun rajonal e më gjërë. Mirëpo për këtë krahas vëllimit dhe strukturës modeste të produkteve dhe shërbimeve për eksport janë paraqitur edhe një sërë pengesash serioze. Së pari, IRJM, Serbia dhe Mali i Zi nuk ofrojnë trajtim të barabartë për eksportuesit Kosovar, të cilët paguajnë të gjithat tarifatat dhe tatimet për eksportet e tyre, ndërsa Kosova aplikon norma zero ndaj këtyre vendeve. Përveq kësaj, importuesit Kosovarë janë duke paguar një taksë specifike për tranzit gjatë kalimit nëpër territoret e vendeve fqinje (në IRJM 100 € për kamion, në Mal të Zi 3% nga vlera e importit dhe në Serbi 5%).

#### **(v) Stabiliteti politik**

Situata politike në një vend ka ndikim qenësor për qëndrimin e investitorëve të jashtëm. Kosova ka filluar të ndërtojë institucionet e veta dhe ka mbajtur zgjedhjet e lira në nivel lokal dhe qendror. Institucionet e dala nga këto zgjedhje janë në konsolidim e sipër dhe në periudhën e ardhshme këto institucione do të bëhen të qëndrueshme, dhe me transferin e kompetencave do të ngritet kredibiliteti dhe përgjegjësia e tyre për menaxhimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Siguria e vendit ka shënuar një trend përmirësimi, në aspektin e rënies së krimeve politike dhe të atyre që rrezikojnë jetën dhe pronën. Kosova nuk është më në faqet e para dhe në titujt e lajmeve kryesore në botë. Mirëpo stabiliteti dhe përmirësimi nuk kanë arritur qëndrueshmërinë e duhur. Pikërisht kohëve të fundit vërehet ngritje e tensioneve, në formë të protestave që nganjëherë marrin formë të dhunshme apo rrezikim të jetës. Integrimi i pamjftueshëm i pakicave, veçanërisht i asaj



Serbe dhe enklavave në tërësinë e jetës institucionale dhe sistemin ekonomik të Kosovës krijon hapësirë për jostabilitet.

Përkundër kësaj, kjo anketë me 38 ndërmarrje dëshmon se rreth 2/3-at e të anketuarve nivelin e stabilitetit politik e konsiderojnë si pengesë serioze ose të intesitetit mesatar dhe ky është sinjal se duhet të punohet në ngritjen e efikasitetit të institucioneve për të kontrolluar pikat neuralgjike me ndikim në trendet e qëndrueshmërisë politike. Gjithashtu, duhet ngritur vetëdijen e opinionit për rendësinë që kanë aspektet politike dhe të sigurisë për krijimin e imazhit pozitiv të Kosovës në botë dhe tek investitorët.

Për shkak se Kosova ende konsiderohet se ka një rrethinë afariste të shoqëruar me pasiguri politike, atëherë nevojitet ndërtimi i formave të ndryshme të partneritetit midis sektorit publik dhe atij privat. Fondet e Garantimit të Investimeve duhet të vijnë në shprehje jo vetëm për projektet e mëdha të shërbimeve publike, por gjithashtu edhe për projektet afariste të cilat vijnë, bie fjala nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore.

Rreziku komercial/mospagesa e obligimeve nga klientët Kosovar, është më i ulti në rajon. Kërkohet një kordinim më i mirë ndërmjet bankave në rajon jo vetëm për të mundësuar pagesën përmes instrumenteve të ndryshme për transaksionet tregtare (p.sh. kambiali), por gjithashtu për ta përmirësuar mirëkuptimin e përgjithshëm për investime.

Duke i pasur parasysh institucionet në kuadër të strukturave administrative që kanë të bëjnë me investimet, kjo do t'i kontribuoj synimit për përmirësimin e perceptimeve politike rreth krijimit të lehtësirave për investime dhe të bëjë të qartë se ky synim është me prioritet të lartë.

#### (vi) **Legjislacioni**

Edhe pse anketa e bizneseve me prani të kapitalit të jashtëm identifikon moskompletimin e infrastrukturës ligjore si pengesë me intesitet të moderuar (rangim kah mesi), anketa e NVM-ve Kosovare e vënë atë në vend të parë gjatë dy viteve të fundit. Problemi është i lidhur me vonesën në rumbullaksim të legjislacionit dhe krijimit të institucioneve të ekonomisë së tregut por gjithashtu edhe me kapacitet për implementimin e rregulloreve/ ligjeve në fuqi. Politikat dhe udhëzimet procedurale për zbatimin e ligjeve shpesh herë nuk mbështeten nga mekanizmat implementues (p.sh. Rregullorja për regjistrimin e ndërmarrjeve, Rregullorja nbi AKM).

##### - **Kontrata mbi shitjen (Rreg. 2000/68)**

- Pasqyron bazat e konventës së Kombeve të Bashkuara mbi shitjen ndërkombëtare të mallrave,
- Zbatohet vetëm në pasurinë e lëvizshme
- Shkarkimit të anijeve dhe barkave, aeroplane dhe, rrymë elektrike
- Zbatimi i saj mund të përjashtohet ose pezullohet
- Zëvendëson ligjin lokal mbi kontratat

##### - **Investimet e jashtme (Rreg. 2001/3)**

- U jep tretman nacional investimeve të jashtme
- Vendos mbi kërkest për regjistrim

- Kufizon produktet e natyrës ushtarake
- Ofron mbrojtje nga përvetësimet
- Ofron mbrojtje ndaj pronës intelektuale (të drejtave të autorit)
- Ofron të drejtën e informimit
  
- **Pengu (Rreg. 2001/5)**
  - Pengu dhe garancionet mbi pengun si kolateral
  - Regjistrimi i pengut
  - Rrjedhat e shitjeve afariste
  - Rregullorja 2001/32 mbi krijimin e zyrës për regjistrimin e pengut
  - Ofron sistemin e informimit publik
  - Qasje në rrjetin kompjuterik ndërkombëtar
  
- **Organizatave afariste (Rreg. 2001/6)**
  - Ligji mbi ndërmarrjet
  - Partneriteti i gjërë dhe partneriteti i kufizuar
  
- **Rregullorja mbi sigurimin dhe mbikëqyrjen (Rreg. 2001/25)**
  
- **Transakcionet e pagesave (Rreg. 2001/26)**
  
- **Ligji themelor i punës (Rreg. 2001/27)**
  - Kontrata e punës
  - Për kohë të caktuar dhe të pacaktuar
  - Bazat rreth pjesëmarrjes dhe punës
  - Afati i skadimit të kontratave të punës: a) përforma jo e kënaqshme, mosangazhimi serioz, strukturimi i duhur, ndryshimet ekonomike ose teknologjike.
  - Pagesat sipas rezultateve në punë, paga minimale.
  
- **Standardet mbi raportimin financiar (Rreg. 2001/30)**
  - Themelimi i Bordit të Kosovës për Standardet e raportimit financiar dhe të një regjimi mbi raportimin financiar nga ana e organizatave afariste
  - Kualifikimet për kontabilistë dhe licencimi i mbikëqyrësve (auditorëve)
  - Obligimet e organizatave afariste për raportim financiar
  - Kërkesat për mbikëqyrje (auditorium) në shumën mbi 250 Euro
  
- **Krijimi i regjistrimit mbi pengun (Rreg. 2001/32)**

Rregullorja mbi të drejtën e shfrytëzimit të tokës, e cila tani është duke u përgatitur do ta kompletoj këtë dispozitë. Është hartuar për ta përmirësuar pozitën e titullarit dhe për të garantuar të drejtën e shfrytëzimit për ata të cilët e blejnë pasurinë e ndërmarrjes.

Rregullorja e tillë – faktikisht ligji për mënjanimin e kufizimeve të tanishme mbi shkallën e transferit të të drejtës për shfrytëzimin e pronës shoqërore – definitivisht menjanon njërin prej mebturinave të epokës socialiste, “të drejtën e shfrytëzimit”, të cilën e kishin ndërmarrjet ndaj tokës për ndërtim.

Për tokën që nuk është në pronësi shoqërore, ligji mbi themelimin e procedurave për zgjedhjen e kontesteve dhe definimin e të drejtave pronësore reale është ranguar si prioritet i lartë në agjendë, e cila synon zhvillimin e procedurave për personin i cili ka kërkesa ndaj pronës jorezidente, dhe kërkon nga personi që formalisht t'i regjistroj këto kërkesa brenda një periudhe të caktuar dhe pastaj t'i prezentoj argumentet mbështetëse.

## **(vii) Infrastruktura publike**

Në periudhën e pas luftës janë bërë investime serioze nga ana e donatorëve dhe si rezultat i kësaj kemi një situatë më të mirë në krahasim me të kaluarën sa i përket infrastrukturës publike. Në realizimin e investimeve kapitale në infrastrukturë një kontribut të rëndësishëm kanë dhënë AER, USAID, DFID, GTZ dhe shumë organizata tjera ndërkombëtare. Mirëpo Kosova ka trashëguar një infrastrukturë të pazhvilluar e pastaj të dëmtuar seriozisht gjatë dekadës së fundit, kështu që situata ende nuk është në një shkallë që të nxisë apo lehtësojë investimet dhe zhvillimin e bizneseve.

Investitorët kanë problem për siguruar tokën e urbanizuar për ndërtim, për t'u kyçur në rrjetin e ujësjellsit, energjisë, telekomunikimeve dhe rrugëve. Investitorët privat në Kosovë kryesisht e kanë financuar kyçjen në rrjet të infrastrukturës (rryma, rruga, uji, telekomunikimet dhe higjiena) me mjetet e veta. Vlerësohet se këto shpenzime të larta zakonisht i shtrenjëtojnë projektet investive prej 20 – 30%. Transporti i mallrave është mjaft i shtrenjtë dhe me shumë pengesa. Kërkesat e bizneseve dhe konsumatorëve janë në rritje, kështu që gjendja e infrastrukturës dhe shërbimeve publike mund të merret si një nga limitet më të mëdha për investitorët.

Proceset lidhur me reformimin e ndërmarrjeve publike janë në fazën e konceptimit dhe aprovimit të kornizës ligjore e cila duhet të mundësojë liberalizimin dhe ristrukturimit. Partneriteti me sektorin privat në ofrimin e shërbimeve të bëjë të mundur futjen e konkurrencës, nepërmjet futjes së ofruesve të rinjë të shërbimeve. AKM do të administrojë ndërmarrjet publike dhe menaxhojë reformen e tyre. Ndërkaq, Rregullatori (Komisioni për rregullimin e shërbimeve publike në Kosovë) do të kujdeset për kriteret në formimin e çmimeve dhe zbatimin e standardeve lidhur me cilësinë e shërbimeve. Në përgjithësi ky është një koncept modern, mirëpo kanë mbetur shume gjëra të pasqaruara lidhur me bashkërenditjen e punëve me pushtetin qendror dhe lokal, lidhur me ndarjen e përgjegjësisë dhe kompetencave, e lidhur me këte ende nuk është hapur një debat substancial.

Për shkak të problemeve të mëdha prezente shkurtimisht do të ndalemi më problemet lidhur me energjetikën, telekomunikimet dhe shërbimet publike komunale (më gjerësisht: 'Zhvillimi Ekonomik Lokal në Kosovë', Riinvest, Prill 2002, 'Disa Probleme të Reformimit të Shërbimeve Publike në Kosovë', dhe Hashi: 'Ristrukturimi dhe Privatizimi i Ndërmarrjeve të Mëdha Publike në Kosovë', prezentuar në "Konferenca Ndërkombëtare mbi Privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Reformën e Shërbimeve", Riinvest Qershor 2002).

**(a) Sektori energjetik** ka paraqitur dhe ende parqet një nga problemet kyçe për zhvillimin e vazhdueshëm të biznesit. Ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike janë shumë të shpeshta, ndërsa mbajtja e funksionimit me energji alternative i shtrenjton shumë operacionet. Edhe

përkundër realizimit të investimeve, gjendja në sistemin elektroenergjetik i Kosovës mbetet jostabile dhe karakterizohet me ndërprerje të shpeshta të rrymës dhe çmime të larta dhe jokonkurrenca. Kjo paraqet rrethanë shumë të pavolitshme për zhvillimin e bizneseve prodhuese dhe inkurajimin e investitorëve të huaj. Dëmtimet për shkak të havarisë që ndodhi në Korrik e kanë keqësuar jashtëzakonisht shumë situatën dhe kjo do të ketë pasoja afatgjata dhe serioze në furnizimin me energji elektrike të bizneseve në përgjithësi. KEK-u pas përfundimit të luftes ishte i përfshirë në një program të gjerë të mbështetjes financiare dhe teknike, e që solli në një gjendje të përmirësuar para defektit të madh në termocentralin Kosova B. Mirëpo në kushtet kur KEK-u nuk ka arritur një funksionim stabil dhe menaxhment më efikas, dhe kur kemi të bëjmë me stabilizime të vjetruara, furnizimi stabil nuk mund të mbështetet në termocentrale ekzistuese. Niveli aktual i fakturimit të rrymës elektrike është 53%, që do të thotë se 47% e rrymës së shpenzuar nuk fakturohet fare. Prej asaj përqindje të rrymës e cila fakturohet, paguhet 65%. Niveli i pagesës për energjinë e shpenzuar nga konsumatorët duhet të rritet ndjeshëm në mënyrë që fondet e arkëtuara të bëjnë të mundur furnizimin nga importi. Nevojitet një aktivitet i jashtëzakonshëm për ta vetëdijësuar opinion dhe fituar përkrahjen e tij që furnizimi me energji elektrike të normalizohet, përndryshe me nivelin e tanishëm të furnizimit me energji, aktivitet ekonomike dhe trendet e normalizimit të gjendjes në shoqërinë Kosovare rrezikohen esencialisht.

Kjo duhet të shoqërohet me konceptin, strategjinë dhe politikat afatgjata të zhvillimit të energjetikës e cila inkuadron edhe liberalizimin dhe privatizimin e industrisë elektro energjetike, ku tanimë ekziston një pervojë e pasur. Në disa vende kemi një liberalizim dhe privatizim të plotë me efekte pozitive që reflektohen në kualitetin dhe çmimet e rrymës elektrike që u ofrohen bizneseve si shfrytëzues. Në disa vende kemi një çasje të përzier me një pjesëmarrje të liberalizimit të tregut por ende në mungesë të privatizimit të plotë. Kështu pronësia e sektorit energjetik në Belgjikë, Finland dhe Gjermani është me strukturë pronësore të përzier. Disa nga vendet e tranzicionit kanë mbetur larg nga nevojat reale në ristrukturimin e këtij sektori.

Në përmbledhje të kësaj çështje, rrjedha e IJD do të vështirësohet në mungesë të furnizimit me rrymë elektrike. Është e mundur që të realizohet konsolidimi fillestar i cili do të pasonte me investime të mëturshme dhe pjesëmarrjen e sektorit privat derisa të bëhet ristrukturimi i këtij sektori. Kjo po ashtu do të kërkojë një ligj të fortë dhe një rregullator të pavarur. Përpjekjet e Kosovës për ta përmirësuar sektorin energjetik duhet të përqendrohet në themelimin e një kornize ligjore, e cila do të dërgonte sinjale adekuate për investitorët se Kosova është vend i përshtatshëm për IJD.

**(b) Telekomunikimet** kanë shënuar progres në rritjen e vëllimit të shërbimeve pas luftës, por cilësia e shërbimeve dhe çmimet ilustronë situatën kur PTK është e vetmja ndërmarrje publike që merret me shërbimet e telekomunikimeve në tregun e Kosovës. Si rezultat i kësaj pozitive pothuajse monopoliste, ndërmarrja ka përfituar një rritje dhe ka realizuar investime nga të ardhurat e arkëtuara, për të evituar dëmtimet nga lufta dhe ngecjen në zhvillim në të gjitha hallkat e sistemit. Në kuadër të kompanisë ofrohen shërbime të telefonisë fikse, mobile dhe shërbimet e internetit (DardaNet- i) dhe shërbimet postare. Edhe përkunder këtyre investimeve të realizuara, shërbimet e PTK-së ende ngecin në cilësi dhe plasohen me çmime të larta. Vlerësohet se këto çmime janë më të lartat në rajon dhe ndikojnë në rritjen e shpenzimeve për investime në krijimin e bizneseve të reja dhe afarizmin e atyre ekzistuese. Sipas anketës së Riinvestit me 38 ndërmarrje të regjistruara me kapital të huaj rrjedh se niveli i telekomunikimeve në këtë fazë të rindërtimit dhe

zhvillimit ekonomik është duke vepruar si faktor limitues në vendimarrje të investitorëve potencial. Kështu rreth 70% të ndërmarrjeve funksionimin e shërbimeve të telekomunikimeve e konsiderojnë si pengesë serioze ose mesatare.

Së këndejmi, PTK domosdo duhet të ballafaqohet me ristrukturimin, liberalizimin e tregut për kyçje të ofruesve të rinjë pa përjashtuar edhe privatizimin e saj me qëllim të rritjes së performancave të mbrendëshme të ndërmarrjes, ngritjes së kualitetit të shërbimeve dhe uljen e çmimeve nën trysinë e një konkurrence. Bazuar në përvojën e vendeve të tjera në tranzicion, telekomunikimet mund të jenë një fushë interesante për investitorët e jashtëm. Liberalizimi i tregut e sidomos privatizimi i sektorit të telekomunikimeve është sforcuar nga vitet e 90 – ta. Kështu sipas një hulumtimi (Iraj Hashi, 2002) Britania e Madhe, Finlanda, Gjermania, Spanja dhe Suedia e kanë bërë privatizimin e plotë të telekomunikimeve, dhe kanë realizuar nivel të lartë të liberalizimit të tregut dhe të hapjes së tregut për kyçje të ndërmarrjeve të telefonisë mobile. Një filozofi të tillë të zhvillimit dhe transformimit duhet ta ndjek edhe PTK-ja dhe të kontribuojë në uljen e shpenzimeve në dobi të zhvillimit të bizneseve lokale dhe ndërkombëtare në Kosovë.

**(c)Roli i pushtetit lokal në promovimin e investimeve private** është shumë i rëndësishëm. Niveli i zhvillimit të shërbimeve publike, zhvillimi urban dhe rregullimi i hapësirës e tokës nëpër komuna ka rëndësi të madhe për zhvillimin e bizneseve dhe sidomos në promovimin e një ambienti më miqësor për inkurajimin e investimeve të huaja. Këtu vëmendje të vacantë duhet kushtuar hartimit të Planit Urbanistik të vendit duke krijuar mundësi të reja urbanistike për zhvillimin e bizneseve të vendit dhe të atyre ndërkombëtare, të cilat kanë rëndësi sidomos për investimet që kanë të bëjnë me ndërtimet që nga fillimi (Greenfield projects). Në periudhën e gjertanishme të funksionimit të pushtetit lokal ka munguar ndërtimi i një sistemi të masave nxitëse për zhvillimin e bizneseve lokale dhe të bizneseve me pjesëmarrje të kapitalit të huaj. (Raporti studimor, Zhvillimi Ekonomik Lokal, Riinvest, 2002):

- zvogëlimin e shpenzimeve administrative për themelimin dhe regjistrimin e bizneseve,
- lehtësimin për çasje në kapital, konsalting dhe trajnim,
- promovimin e lokacioneve adekuate nëpër komuna për zhvillimin e bizneseve me pjesëmarrje të kapitalit të huaj (zonat e ndërtimit, zonat e ndërmarrësisë, - marketing urban),
- zhvillimi i transparencës dhe respektimi i rregullave të lojës (konkurrencës) gjatë organizimit të tenderëve për investime publike,
- nxitja e krijimit të partneritetit në mes të ndërmarrjeve publike dhe private,
- krijimi i një rrejtje të qendrueshme të institucioneve bankare dhe jobankare.

Nga përgjegjet e dhëna në Anketën e NVM (Tablea e poshtme: Riinvestit, 2001) ka mbretëruar një vlersëm shumë kritik lidhur me cilësinë e shërbimeve publike në nivel të pushtetit lokal.

Tabela 3: Si e vlerësoni përkrahjen e ofruar nga pushteti lokal

	% (keq)	% (disi)	% (mirë)
Furnizimi me energji elektrike	95.3	2.6	2.1
Furnizimi me ujë	51.1	32.0	16.8
Telekomunikimi	32.3	38.3	29.4
Rrugët	37.4	43.9	18.8
Higjiena	50.6	35.7	13.7
Arsimi dhe shëndetësia	22.1	57.8	20.0

Burimi: Anketa e Riinvestit me bizneset private, 2001

Të gjitha këto çështje kanë rendësi për inkurajimin e investitorëve potencial. Nga këto çështje vërehen dy lloj pengesash me ndikim negativ në promovimin e investimeve nëpër komuna të Kosovës: (i) pengesat administrative dhe (ii) pengesat e infrastrukturës. Pengesat administrative janë të karakterit byrokratik dhe kanë ndikim në krijimin e imixhit të një vendi. Lidhur me këtë në legjislacionin komunal dhe qendror duhet adoptuar përvoja të avancuara dhe modele të thjeshtëzuara për regjistrim dhe ç’regjistrim të bizneseve, kyçje dhe dalje në/nga tregu.

#### 4.2. KUFIZIMET RAJONALE / GEOGRAFIKE PËR INKURAJIMIN E IJD

Ngadalësia në implementimin e reformave institucionale, ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve demokratike, prezenca e korrupsionit, rreziku politik dhe mungesa e një menaxhmentit efikas makroekonomik në Europën Juglindore (EJL) kanë bërë që rajoni mos të konsiderohet destinacion atraktiv për investitorët e jashtëm. Të gjitha vendet e rajonit ngelin shumë prapa në krahasim me vendet e Evropës Qendrore (EQ) sa i përket IJD. Prandaj, tërheqja e IJD në Kosovë, i ka edhe limitet gjeografike, kështu që shumëçka duhet të zgjidhet në nivel rajonal. Nga ana tjetër është e kjo që tërheqja e investitorëve serioz në secilin prej vendeve të rajonit domosdo përmban dimensionin rajonal. Kosova duhet të përfitojë nga pozita e vet qendrore në rajon, duke e materializuar atë më tërheqjen e investimeve që gravitojnë në tregun rajonal dhe më gjerë. Mirëpo, bashkëpunimi ndër rajonal për shkak të problemeve të shumta ngecë. Tregtia ndër rajonale në shumicën e vendeve sillet 9 % dhe 10% , me përjashtim të Kosovës ku kjo është mbi 60%. Ndërkaq investimet e përbashkëta midis partnerëve në rajon janë gjithashtu shumë të vogëla.

#### INVESTIMET NË RAJON (1990-2001)

(i) IRJM (nga Greqia, Turqia, Kroacia, Bullgaria, “RFJ”, B&H, Shqipëria).....	34.6%
(ii) Rumania (nga Turqia, Greqia, “RFJ”, Bullgaria) .....	8.0%
(iii) Bullgaria (nga Turqia, Greqia) .....	14.9%
(iv) Bosnja dhe Hercegovina (nga Kroacia, Turqia) .....	14.4%
(v) Shqipëria (nga Greqia, Italia, Bullgaria, Kosova, IRJM) .....	85.6%

Partnerë kryesor në realizimin e investimeve në rajon paraqiten vendet e BE me një pjesëmarrje të konsideruar në: Bullgari (60.0%), Rumani (57.0 %), Kroaci (61.2 %), IRJM (42.5%) dhe Bosnje dhe Hercegovinë (30.4%). Ndërsa në kuadër të BE duhet veçuar pjesëmarrjen

e lartë të Gjermanisë. Pjesëmarrja e investimeve nga SHBA, sidomos është e lartë në Kroaci (27.5% në investimet e përgjithshme të huaja).

Nëse situata ekonomike vështrohet në trekëndëshin: niveli i zhvillimit – borgjet e jashtme – IJD mund të nxjerren përfundime relevante për tendencat e ardhshme të proceseve tranzitore në vendet e rajonit. Në të gjitha vëndet e rajonit ka munguar një angazhim më serioz i investitorëve të huaj në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese, ristrukturimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, shtetërore dhe publike. Kështu nga perspektiva e pjesëmarrjes së investimeve të huaja në investimet e përgjithshme, Shqipëria, B. e H, “RFY” dhe IRJM kanë realizuar nivelin më të ulët të IJD për banorë, ndërsa trende më të volitshme janë realizuar në Kroaci, Bullgari dhe Rumania.

Tabela 4: Pasqyrë e treguesve të IJD

Vendet	IJD (1990- 1999), mil.\$	IJD për banorë 2000, \$	Niveli i IJD për banorë, mesatarja 100
1. Shqipëria	800	233	50.1
2. B e H	470	125	26.9
3. Bullgaria	3,997	504	108.4
4. Kroacia	6,703	1,530	328.4
5. FYROM	824	403	86.7
6. Rumania	7,698	343	73.7
	20,492 -Gjithsej	466 - Mesatarja	

Burimi: Economic Strategy for South Eastern Europe (V. Gligorov). Vienna Institute for International Economic Studies, 2000 si dhe: Building Peace in SEE: Macroeconomic Policies and Structural Reforms Since the Kosovo Conflict, IMF/WB, 2001

Sipas treguesit të investimeve të huaja për kokë banori, në pozitë më të volitshme ndaj mesatares është Kroacia (328.4%) dhe Bullgaria (108.4%) e që tregon një ndërvarësi midis të nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të investimeve direkte të huaja. Vendet që kanë nivel më të lartë të GDP-së për banorë në të njëjten kohë kanë realizuar edhe investime më të larta për kokë banori.

Në përgjithësi IJD më së shumti ishin të orientuara në sektorët e industrisë, tregëtisë, riparimi i motorëve të kamionëve, dhe në sektorë të ndërmjetësuesve financiar. Industria ka treguar pjesëmarrje të lartë në shumicën e vendeve të rajonit. Në Maqedoni industria ka pjesëmarrje mbi 80%, ndërsa në vendet tjera kjo pjesëmarrje është: në Kroaci (45.5 %), Bullgari (54.2 %), dhe Bosnje dhe Hercegovinë (42.8 %).

Problemet që janë duke e përcjellur zhvillimin, ristrukturimin dhe privatizimin e agroindustrisë kanë dekurajuar investitorët e huaj që t’i orientojnë investimet e veta në këtë sektorë. Kryesisht në të njëjten pozitë kanë mbetur xehëtaria, energjia elektrike, gasi dhe furnizimi me ujë duke pasur parasysh statusinë aktual të këtyre sektorëve dhe nevojat për investime të mëdha.

Tabela 5: IJD në disa vende rajonale sipas sektorëve

Sektoret	Bullgaria	Rumania	Kroacia	B&H	IRJM
Agrokultura	0.3	3.0	0.0	-	-
Xehëtaria	-	-	3.4	-	-
<b>Industria</b>	<b>54.2</b>	<b>43.8</b>	<b>46.5</b>	<b>42.8</b>	<b>84.5</b>
Rryma elektrike, gazi, uji	-	-	0.8	-	-
Ndertimtaria	1.0	2.3	1.3	5.4	1.1
Tregtia, riparimi i motorëve të kamionëve	19.5	24.1	4.1	3.1	6.0
Hotelet dhe restorantet	5.1	0.8	1.0	-	-
Transporti dhe komunikimet	4.5	2.3	30.0	-	1.2
Sektori i ndërmjetësuesve financiar	11.7	23.7	12.5	13.1	2.8
Patundëshmërit, renta dhe aktivitetet e bizneseve	-	-	0.4	31.5	-
Të tjera	3.7	0.0	0.0	4.1	4.4
Gjithsejt	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Foreign Direct Investment in South East Europe: Implementing Best Policy Practices. Vienna, 2000

Bashkëpunimi ekonomik ndër rajonal është duke u ndeshur me shumë pengesa. Një projekt i përbashkët me pesë institucione të tipit “think tank” kanë vlerësuar “Pengesat në Tregti, Rritje, Investime dhe Aftësitë Konkurruese” (Chesapeake Association, 2001), nga perspektiva e ndërmarrjeve në Shqipëri, Bullgari, Kosovë, IRJM dhe Mal të Zi. Mostra ka përfshirë 25 ndërmarrje nga secili vend, gjithsejt 125 ndërmarrje. Pengesat kryesore të ranguara sipas intensitetit janë prezentuar në tabelën e më poshtme:

Tabela 6: Rangimi i pengesave për tregti dhe bashkëpunim nga perspektiva e ndërmarrjes

Lloji i pengesave	Kosova	Vendet tjera
Problemet që lidhen me doganat	2	1
Tatimet	7	2
Kontratat dhe pagesat	4	3
Mungesa e informatave	5	4
Infrastruktura (telekomunikimet, rryma, rrugët)	1	5
Procedurat administrative	6	6
Sistemi bankar	3	7
Rreziku politik	8	8

Burimi: Obstacles to Trade, Growth, Investment and competitiveness (Chesapeake Association, 2001)

Problemet që lidhen me doganat – procedurat, tarifrat dhe vonesat në kufi, duket se janë pengesat më të shpeshta për të gjitha vendet e rajonit (rang 1), duke përfshirë edhe Kosovën (rang 2). Dallimi qëndron në vlerësimin e ndikimit të vogël të infrastrukturës, e cila në rastin e Kosovës konsiderohet si pengesa kryesore (rang 1), ndërsa për vendet tjera në rajon intensiteti i kësaj pengese është më i ultë (rang 5). Dallimi po ashtu ekziston edhe në sistemin bankar: rang 3 në Kosovë, dhe 6 për vendet tjera. Është interesant se situata politike nuk është konsideruar si pengesë me peshë, si në Kosovë ashtu edhe në vendet tjera të rajonit.



Prioritetet për permirësimin e bashkëpunimit rajonal në rastin e Kosovës janë: (i) zhvillimi i infrastrukturës, (ii) përsosja e procedurave doganore, dhe (iii) zhvillimi i sistemit bankar.

Ndërmarrjet e anketuara nga të gjitha vendet e kanë Kosovën si tregun e tyre kryesor, dhe kjo pasqyron gjendjen e pas luftës në Kosovë që karakterizohen me kërkesën e madhe për nevojat e rindërtimit.

Niveli i shpenzimeve administrative për formimin e ndërmarrjeve në përgjithësi në rajon është i lartë. Ky nivel i këtyre shpenzimeve është në raport pozitiv me nivelin e korrupsionit dhe në raport negativ me kualitetin e qeverisjes, shkallën e hapjes së ekonomisë dhe nivelin e pagave në sektorin publik.

Për të tejkaluar problemet e prezentuara këtu një sere aktivitesh janë duke u ndërmarrur në bashkërenditje nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Këtu veçanrisht duhet veçuar masat në kuadër të paktit të stabilitetit që kanë të bëjnë me të ashtuquajturën “Pako Investive për Vendet e EJL”.

#### **PAKOJA PËR INVESTIME PËR RAJONIN E EJL**

Qeveritë e vendeve në rajon duhet të bëjnë më shumë për të krijuar kushtet nën të cilat sektori privat do të investonte. Me synimin për të themeluar një kornizë uniforme të qëndrueshme dhe transparente për investimet e sektorit privat, Qeveritë e vendeve në rajon, në bashkëpunim me partnerët e tyre në Paktin e Stabilitetit, vendosën të implementojnë **Pakon për Reforma, Investime, Integritet dhe Rritje** (e cila referohet si Pako për Investime). Pakoja për Investime përkufizon një program ambicioz të reformave ligjore, rregullative dhe institucionale, që kanë për qëllim krijimin e një trajtimi të drejt dhe jo diskriminues për investitorët e vendit dhe ata të huaj, duke përfshirë mbrojtjen e plotë e të drejtave të tyre pronësore jo vetëm përmes ligjit të shkruar, por gjithashtu edhe përmes implementimit administrativ dhe juridik. Fushat specifike të Pakos për Investime përfshijnë: bankat, tregun e kapitalit, qeverisjen me korporata, strategjia dhe politika e promovimit të IJD, ligji mbi tregtinë duke përfshirë licencimin dhe lejet për fillimin e biznesit, efikasitetin administrativ dhe pengesat burokratike për iniciativat e sektorit privat, ligji mbi konkurrencën dhe politikat ekonomike, luftimi i keqpërdorimeve dhe korrupsionit, sistemi i drejtësisë, mbështetja e NVM-ve, privatizimi, reforma e politikës fiskale dhe tatimeve dhe, regjimi dhe praktikat e kontabilitetit.

Angazhimi i qeverive të Evropës Juglindore ndaj futjes në përdorim dhe implementimit të Pakos për Investime do të përkrahët nga qeveritë jashtë rajonit, institucionet ndërkombëtare dhe donatorët tjerë. Për finalizimin dhe aprovimin e Pakos për Investime nga qeveritë e EJL, është e nevojshme të mobilizohet mbështetja dhe asistenca teknike për ta forcuar kapacitetin institucional përmes të cilit do të bëhet implementimi.

*Source: World Bank: The Road to Stability and Prosperity in SEE – Regional Strategy Paper, 2002.*

## 5. POLITIKAT E NXITJES SË IJD

Situata aktuale e zhvillimit ekonomik në plan të gjerë dhe problemet e përshkruara lidhur me IJD shtrojnë nevojën për kompletimin e masave të politikës ekonomike, kuadrit ligjor dhe rrethës institucionale për krijimin e një mjedisi miqësor për afarizëm dhe investime. Politikat në të vërtetë duhet tu adresohen njësoj të gjithë investitorëve privat, të jashtëm dhe vendor. Në këtë pjesë të raportit do të adresohen shkurtimisht disa nga çështjet më relevante për ndërtimin e një rrethine të tillë.

### 5.1. NDËRTIMI I STABILITETIT MAKROEKONOMIK

Rivitalizimi i shpjgjetë i aktiviteteve ekonomike, rumbullaksimi i fazës emergjente të rindërtimit pas luftës dhe asistencë financiare dhe teknike e bashkësisë ndërkombëtare kanë ndikuar në rritjen e shpejtë të GDP-së dhe treguesve të tjerë makroekonomik. Mirëpo, brenda përbrenda kësaj rritje kanë mbetur shumë shpërpjestime të mëdha të cilat mund ta vështirësojnë ruajtjen e qendrshmërisë së rritës ekonomike dhe stabilitetit makroekonomik.

- raportet midis GDP-së, konsumit, kursimeve dhe investimeve,
- raporteve midis nevojave për investime kapitale dhe buxhetit,
- raportit midis importit dhe eksportit,
- papunësisë dhe investimeve.

Disa nga këto shpërpjestime mund të ilustrohen përmes të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Treguesit makroekonomik (2001):

GDP:	€1.8 mld (vl.)
GNP:	€2.5 mld (vlt.)
Të ardhurat në dispozicion:	€4.3 mld (vl.)
Konsumi:	€2.5 mld (vl.)
Kursimet:	€0.3 mld (vl.)
Investimet:	€1.5 mld (vl.)
Importi (mallrat):	€2.5 mld (vl.)
Eksporti (mallrat):	€0.4 mil (vl.)
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës:	€0.4 mld (vl.)
Investimet kapitale:	€1.7 mld
Depozitat bankare (31.12.2001):	€0.5 mld
Dërgesat nga Diaspora:	€0.6 mld (vl.)
Norma e inflacionit (CPI):	11%

Source: CFA estimations

Aktualisht, shumica e këtyre shpërpjestimeve po përballohen në saje të asistencës financiare ndërkombëtare, dërgesave të emigrantëve dhe diasporas, konsumit të të punësuarve në administratën ndërkombëtare. Mirëpo sfidat mjaft të vështira për tu përballuar janë se si të rriten mundësitë për gjenim të të ardhurave dhe punësimit nga kapacitetet vendore. Menaxhimi i kujdesshëm i kësaj periudhe kalimtare është shumë i rëndësishëm për të shmangur recesionin e thellë të njohur si “ shock” i ekonomive të bazuara në ndihma ose infuzion të lartë financiar nga jashtë. Me qëllim që të shmanget ky lloj recesioni, dy vitet ardhshme janë esenciale për ta

përmirësuar infrastrukturën publike nepërmjet përkrahjes së donatorëve, e cila do t'i stimulonte aktivitetet afariste dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Tabela 8: Vlerësimet e rritjes së GDP-së

		Indeksi
GDP mil. USD 2000	1,352	100
GDP mil. USD 2001	1,679	124
GDP për kokë banori 2000	764	100
GDP për kokë banori 2001	904	118

(Bazuar në vlerësimet e AQF-së, Mars 2002)

Inflacioni i velerësuar prej 12% pritet të zvogëlohet pas një lloj “shoku” të çmimeve pas zëvendësimit të Markës Gjermane me Euro. Nga aspekti i IJD përdorimi i monedhës së re të BE – Euro, është një përparësi për shkak se eviton problemet që krijohen me rastin e këmbimit ndërvalutor ose zhvlerësimin e valutës vendore si pasojë e inflacionit ose politikës ekspansioniste monetare. Valuta stabile dhe e fortë dhe niveli i ultë i inflacionit, objektivisht paraqet një përparësi të rendësishme të Kosovës në krahasim me vendet tjera të rajonit.

Buxheti i konsoliduar i Kosovës, i cili ishte financuar nga të hyrat vendore vetëm 50% në vitin 2000, në vitin 2001 të hyrat nga tatimet ishin dyfishuar dhe vet financimi i buxhetit është ngritur në 82%, ndërsa për vitin 2002 pritet që të hyra nga tatimet të mbulojnë 93% të nevojave buxhetore. Poashtu kemi një rritje të lartë të normave të GDP-së gjatë viteve 2001 (24%, 13% sipas treguesve real) dhe 2002 (14%, 7% sipas treguesve real), duke arritur te një normë më e vogël e rritjes prej 6 deri në 7% në vitin 2005. Pjesëmarrja e buxhetit në GDP pritet të rritet nga 14% sa ishte në vitin 2001, në 20% pas vitit 2005 (vlerësimet e AQF-së).

Një fushë tjetër e shpërpjestimeve është ajo ndërmjet importit dhe eksportit. Eksporti për momentin është në nivel tejet të ultë për shkak pengesave në infrastrukturë dhe prodhim. Politikat aktuale synojnë të zvogëlojnë deficitin, duke zvogëluar importin e ndihmave humanitare dhe asistencën emergjente për rindërtim, dhe rritjen e eksportit të mallrave. Dërgesat financiare të Diasporës ka gjasa të vazhdojnë rolin e tyre shumë të rendësishëm në menaxhimin e këtyre deficiteve, dhe shuma e këtyre dërgesave arrinë shumë ndërmjet 400 – 500 million €. (vlerësimete e Riinvestit, Anketa e familjeve, 1999).

Menaxhimi dhe rregullimi adekuat makroekonomik si parakusht i ruajtjes së stabilitetit ekonomik është kyç për stimulimin e IJD. Nga ana tjetër rritja e investimeve private është gjithashtu e domosdoshme për të përballuar shumë vështirësi dhe shpërpjestime. Efektet e tyre duhet orientuar sidomos kah rritja e eksportit, investimet në infrastrukturën publike si formë e letësimit të presioneve në buxhet, dhe në të njëjtën kohë rritjen e të ardhurave buxhetore nga tatimet dhe rritjen e punësimit. Kjo kërkon rritjen e mëtejme të kapaciteve në administratën publike dhe gjithashtu edhe ndërtimin e transparencës mbi ecuritë e indikatorëve makroekonomik. Duhet të vazhdohet mbështetja e Njesisë për Analiza Makroekonomike në AQF/Minsitrinë e Ekonomisë dhe Financave, e cila përgatit dhe boton Raportin mujor mbi treguesit themelor, dhe e cila në bashkëpunim me Riinvestin do të botojë Buletinin kuartal mbi trendet makroekonomike. Për çdo investitor, pasqyra reale dhe azhure mbi situatën makroekonomike është me rëndësi shumë të madhe. Së këndejmi përparimi i bazës staistikore, metodologjisë dhe përgjithsisht sistemit të përlogaritjes së indikatorëve makroekonomik duhet të vëhet në detyrat prioritare.

## 6.2. PRIVATIZIMI DHE REFORMA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Aprovimi i rregullores mbi AKM është një hap i rëndësishëm për fillimin e procesit të privatizimit. Regjistrimi i korporatave të reja subsidiare të dala nga NSH ekzistuese dhe shitja e pasurisë së tyre në treg investitorëve të vendit dhe të jashtëm, pa patur në trashigimi obligimet dhe problemet e tjera të NSH duket një model i qëlluar dhe i orientuar drejt për të qenë atraktiv për investitorët. Duke pasur parasysh të dhënat e prezentuara më sipër duket se ky është një fakt shumë relevant. Mirëpo kanë mbetur ende punë për të filluar efektivisht me procesin e privatizimit, dhe para së gjithsh aprovimi i politikave procedurale për zbatimin e rregullores dhe krijimi i një programi aktivitësh për të realizuar procesin e privatizimit dhe ndërlidhur atë me politikat ekonomike dhe kuadrin ligjor komplementar. Më tutje, duhet ndërmarrë një aktivitet ofanziv për promovimin e modelit dhe programit të privatizimit tek investitorët privat të vendit dhe të jashtëm. Është e qartë se suksesi në privatizimin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha shoqërore sipas modelit “Spin-off”, do të varet esencialisht nga gatishmëria e investitorëve të jashtëm dhe të brendshëm më mundësi solide financiare.

Duke u nisur nga fakti se infrastruktura publike, veçmas telekomunikimet, energjetika dhe disa nga shërbimet publike mund të jenë atraktive për investitorët e jashtëm, hapja e proceseve reformuese brenda ndërmarrjeve publike ka rëndësi esenciale. Konferenca Ndërkombëtare mbi Privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe reformën e ndërmarrjeve publike (Rinvest, Qershor 2002), ka sqaruar disa nga dilemat dhe është anagazhuar seriozisht lidhur me këtë. Mirëpo derisa në aspektin e krijimit të një kuadri ligjor dhe organizativ, gjërat kanë lëvizur në drejtim pozitiv, brenda ndërmarrjeve publike u dëshmuua se preokupimi themelor është me problemet ditore të funksionimit e më pak me restrukturimin, librealizimin dhe konkurrencën, dhe drejtimet e reformave të domosdoshme me çka pozita e tyre do të ndryshojë rrënjësisht.

Pothuajse të gjithë sektorët e infrastrukturës publike dhe shërbimeve publike kanë nevojë për investime serioze. Mu për këtë, duhet krijuar kuadrin ligjor për çasje inovative që mund të jetë atraktive për investitorët. Këtu më poshtë po përmendim vetëm disa nga mundësitë.

Ekzistojnë opsione të ndryshme të pjesëmarrjes së sektorit privat ndaj alternativave se si ndahet përgjegjësia mbi pronësinë e mjeteve ndërmjet sektorit privat dhe publik. Përveç privatizimit të plotë (shitjeje së pasurisë publike), opioni kryesor ndërmjetësues i pjesëmarrjes private janë: kontratat mbi menaxhmentin, marrja me qëra/lizingu, koncesionet dhe modelet operative si psh. BOT (Build, Operate, Transfer – Ndërtimi, Veprimtaria, Transferi), BOO (Build, Operate, Own – Ndërtimi, Veprimtaria, Pronësia) e të tjera. Këtu po japim një sqarim të shkurtër për secilin prej opsioneve të përmendura:

- Nën **marrëveshjen për marrje me qëra/lizing**, ndërmarrja private merr me qëra mjetet e ndërmarrjes publike nga qeveria, dhe merr përsipër përgjegjësinë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Qëramarrësi presupozon rrezikun komercial të veprimtarisë, dhe ka të drejtë në të ardhurat që relizohen nga kjo veprimtari. Fitim varet nga ajo se sa qëramarrësi është në gjendje t'i zvogloj shpenzimet krahas ofrimit të standardeve kualitative, kështu që është i inkurajuar ta përmirësoj efikasitetin e veprimtarisë.
- **Koncesioni** i jep të drejtën investitorit privat jo vetëm në bartjen e përgjegjësisë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve në pronësi publike, por edhe për investime të reja.

Megjithatë, mjetet mbesin në pronësi të qeverisë e cila ushtron të drejtën e plotë mbi të gjitha mjetet, duke përfshirë edhe ato që janë investuar nga partneri privat, të cilat kalojnë në pronësi të qeverisë kur skadon afati i kontratës. Përparësia kryesore me këtë rast është bartja e përgjegjësisë së plotë e veprimtarisë dhe investimeve në sektorin privat, dhe krijimi i stimulimeve për efikasitet në të gjitha veprimtaritë e shërbimeve publike. Prandaj, ky është një opcion atraktiv për rastet kur nevojiten investime kapitale.

- Në një projekt të tipit **BOT**, investitori bën një investim, shfrytëzon kapacitetet për disa vite dhe në fund pas shfuqizimit të kontratës bën bartjen e të gjitha të drejtave në kapacitetet e shërbimeve publike. Nëse kapacitetet mbesin në pronësi të investitorit, atëherë ajo quhet **BOO model**.

### 6.3. RREGULLIMI I TREGUT DHE KONKURRENCA LOJALE

Ndonëse siç u theksua më parë tregu i Kosovës është i liberalizuar sa i përket regjimit të tregtisë së jashtme dhe bizneset vendase ballafaqohen me konkurrencën nga importi. Tregu është mjaft i çrregulluar dhe konkurrenca lojale si forca kryesore nxitëse e stabilitetit ekonomik dhe racionalitetit të sinjaleve nga tregu ende nuk është vendosur në Kosovë. Anketat e NVM-ve në Kosovë (Riinvest 2000 dhe 2001), kanë treguar se konkurrenca jo lojale rangohet në vendin e dytë të pengesave për zhvillimin e biznesit (menjëherë pas mungesës së ligjeve). Arsyet duhet kërkuar në dobësitë prezente në rregullimin e tregut me politika adekuate ekonomike dhe zbatimin e rregullave ligjore të cilat ende bëjnë të mundur evazionin fiskal. Arsyeja tjetër qëndron në çrregullimet që krijohen si pasojë e raporteve josimetrike tregtare me vendet e fqinje, të cilat bëjnë që për shkak të ndikimit të instrumenteve fiskale josimetrike të goditën veçmas prodhuesit Kosovar dhe mundësitë e tyre konkurruese në tregun e vendit dhe në eksport.

Mungesa e statusit ndërkombëtar të Kosovës si entitet i pavarur tregtar është duke u reflektuar negativisht në pozitën tregtare të Kosovës në rajon dhe më gjerë. Kjo është duke krijuar edhe pasoja serioze në zhvillimin e bizneseve dhe në forcimin e rritjes së qendrueshme ekonomike të saj. Politikat tregtare dhe në tërësi marrëdhëniet ndërkombëtare të Kosovës me vendet tjera janë në kuadër të kompetencave të rezervuara për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara. Prandaj, ndërtimi i këtyre politikave mbetet një nevojë e ngutshme me qëllim të krijimit të parakushteve për një kyçje më serioze të bizneseve të vendit në tregun rajonal dhe më gjerë.

Përmirësimi i këmbimit tregtar nga perspektiva e realizimit të investimeve direkte private kërkon masa efektive për:

- Krijimin e politikave aktive tregtare të Kosovës ndaj vendeve tjera në funksion të konkurrencës lojale
- Zbatimin e instrumenteve të reciprocitetit,
- Tejkalinin e efekteve negative nga zbatimi i Marrëveshjes Tregtare në mes të IRJM dhe RFJ”,
- Rregullimin e këtij bashkëpunimi të këmbimit tregtar në mes të Kosovës dhe Malit të Zi/Serbisë me marrëveshje të vaçantë, dhe në kushte të barabarta,

- Tejkalimin e tatimeve të veçanta josimetrike dhe diskriminuuese në tranzit për importuesit Kosovar në territorin e IRJM, Malit të Zi dhe Serbisë,
- Tejkalimin e pengesave dhe vështirësive për realizimin e eksporteve të Kosovës në vendet e rajonit si rezultat i aplikimit të instrumenteve joreciproke, kufizimeve dhe pengesave administrative, aplikimin arbitrar të ngarkesave doganore dhe mos njohjen zyrtare të çertifikatave mbi origjinën e mallit të prodhuar në Kosovë.

#### **6.4. PERSOSJA E MËTEJME E SISTEMIT TË TAKSAVE**

Ndërtimi i një sistemi fiskal dhe tatimeve moderne, dhe të përshtatshëm për ekonominë e tregut është në vijim e sipër. Pjesëmarrja e të hyrave nga tatimet ka shënuar një ngritje solide prej 8% në vitin 2000 në rreth 17% në vitin 2002, në kushtet e rritjes dinamike të GDP-së. Masat e mëtejme në politikën tatimore nga aspekti i nxitjes së investimeve private, kanë të bëjnë me shqyrtimin e lartësisë së gjithmbarshme të tatimeve për bizneset, sidomos tatimeve (doganës dhe TVSH-së) në investimet kapitale dhe inputet që nuk prodhohen në vend, me çka Kosova do të përfitonte në dy drejtime:

- rritjen e aftësisë konkurruese për IJD, dhe
- norma më të ulta të tatimeve për mallrat investive.

#### **6.5. ZHVILLIMI I MËTEJMË I SISTEMIT FINACIAR DHE KREDITIMIT**

Progresi i arritur në funksionimin e sistemit të bankave, krijimit të tregut kreditor dhe rritjes së konkurrencës në të e pastaj rritjes së depoziteve dhe transakcioneve të bizneseve nepërmjet bankave janë vetëm fillimi i ndërtimit të një sistemi financiar të përshtatshëm dhe stimulativ për investime. Depozitat dhe kursimet tregojnë trende pozitive si rezultat i funksionimit efikas të sistemit bankar, dhe i rikthimit gradual të besimit të klientëve. Rritja e depozitave i ka kaluar të gjitha parashikimet dhe paraqet tregues të stabilitetit financiar dhe kreditor. Në fund të vitit 2001, depozitat kishin arrijtur në 467.0 milion €, ndërsa në vitin 2002 janë stabilizuar në shumë prej 350-380 milion €. Nga këto depozita, 36% janë të afatizuara dhe konsiderohen si resurse të rendësishme në mbështetjen kreditore të bizneseve.

Kreditimi i bizneseve gjithashtu ka shënuar progres. Të gjitha bankat e licencuara në Kosovës, janë duke implementuar programe të kreditimit dhe mbështetjes së bizneseve. Gjer më tani bankat e vendit kanë siguruar rreth 53 milion € kredi për ndërmarrjet e vendit dhe atë kryesisht në tregti (49.6%), biznese prodhuese (16.9%), shërbime (19.5%) dhe sektorë tjerë (13.9%). Në këtë fazë të rindërtimit të vendit kjo mbështetje nuk është adekuate duke pasur parasysh kushtet e kreditimit që ofrojnë bankat (kamatat e larta, mungesa e grejs periudhës, kreditim afatshkurtër). Këto kushte janë tejet të pavolitshme sidomos për kreditimin e bizneseve prodhuese. Krahas bankave komerciale, në Kosovë janë duke funksionuar edhe disa institucione financiare jobankare, që janë duke e luajtur rolin e ndërmjetësuesve financiar. Këto institucione u kanë siguruar ndërmarrsëve Kosovar mbi 13.000 mikrokredi në vlerë prej 29.1 milion €.

Shpërpjestimet në aspektin struktural ende janë shumë të ndieshme, sidomos sa i përket cilësisë së depozitave në aspektin e kohës së depozitimit dhe në aspektin e raportit midis kredive dhe depozitave. Masat e politikave ekonomike duhet të ndikojnë në tejkalimin e këtyre

shperpjestimeve, e sidomos në stimulimin e depozitave të afatizuara dhe kursimit afatgjatë. Kamatat më atraktive për kursim duhet të jenë një nga zgjidhjet e mundshme, kryesisht një raport më i volitshëm ndërmjet kamatës pasive dhe aktive në banka, si një zgjidhje logjike për krijimin e potencialeve për kreditim afatgjatë. Kjo duhet të jetë një nga parakushtet për rritjen e ofertës për kredi dhe konkurrencës e cila do të ndikonte në uljen e normave të kamatës.

E gjithë kjo është esenciale për krijimin e ambientit të përshtatshëm për investime dhe gjithashtu për realizimin e privatizimit. Mirëpo, kjo është vetëm një segment kyç i sistemit të nevojshëm financiar. Funksionimi i tregut të kapitalit duhet sa më shpejtë të futet në agjenden e krijuesve të politikave ekonomike dhe hartuesve të sistemit ekonomik në Kosovë. Kjo çështje duket se ka mbetur e neglizhuar.

Me këtë është e lidhur ngushtë edhe mundësia e formimit të fondeve investive, në fillim nga kapitali i Diasporës në vendet ku ajo është më e koncentruar – Gjermani, Zvicër, SHBA, Skandinavi, Britani të Madhe etj. Në këto fonde do të mobilizohet kapitali i Diasporës, dhe do të nderlidhet me bankat e huaja dhe Ksovarë, duke u mbështetur në marrëveshjet bilaterale për garantimin e investimeve nga rreziku jokomercial sipas shembullit të OPIC-ut. Do të ishte e dobishme që sa më shpejtë të përpunohet koncepti i fondeve të tilla, dhe të diskutohen me Diasporën dhe me qeveritë e vendeve perkatëse. Një verzion i një fondi të tillë me segmente të caktuara është duke e përgatitur qeveria Zvicrrane dhe Swissconatct-i.

Sistemi bankar nuk lëshon instrumente të zakonshme mbi pagesat për transaksione ndërkombëtare (import/eksport). Bankat në Kosovë nuk janë sa duhet të kordinuara me bankat korresponduese në rajon, për të lejuar përdorimin e kambilaleve. Lehtësimi i tregtisë dhe integrimi ekonomik në rajon kërkon që ky nivel i kordinimit të jetë në nivelin e duhur.

Një marrëveshje mbi Agjencitë për Sigurimin e Eksportit nga vendet Ballkanike është ide e cila duhet të merret parasysh. Ato do të mundësonin garantimin e realizimit të kontratave, ndërkaj secila agjenci tani merr përsipër rrezikun e refuzimit për t'i ekzekutuar kontratat e atyre subjekteve të cilat trajtohen si rezident në vendin e tyre. Për ndërmarrjet e tilla, Agjencia lokale ka informata të plota, kështu që kuota e premisë së rrezikut minimizohet. Një karakteristikë e rajonit të Ballkanit është niveli i lartë i rrezikut tregtar, prandaj edhe forma e tillë e garancioneve të propozuara do ta stimulonte tregtinë rajonale.

## **6.6. LEGJISLACIONI**

Një pjese e konsiderueshme e ligjit komercial të aprovuar dhe të përgatitur u përgjigjet standardeve të ekonomisë së tregut e që është kerkese elementare e çdo investitori. Këto kërkesa i përmbush edhe Rregullorja mbi Investimet e Jashtme. Mirëpo nese pakoja e ligjeve komerciale dhe të tjera nuk është e kompletuar dhe nuk zbatohet në mënyrë konsekuente, atëherë mungojnë efektet e domosdoshme sinergjike dhe këto përparësi të kuadrit ligjor në Kosovë zbehen dukshëm. Për inkurajimin e investimeve janë një lloj të dëmshme moskompletimi i ligjeslacionit dhe mungesa e fuqisë dhe emkanizmave për t'i zbatuar ligjet dhe parimet e shtetit ligjor. Prandaj, veprimi i institucioneve kompetente brenda UNMIK-ut, Parlamentit dhe Qeverisë duhet të jetë në dy kanale:

- Zbatimin efektiv të ligjeve të aprovuara e sidomos: Ligjit mbi korporatat (ndërmarrjet, Rregulloren mbi AKM, pengun, standardet e kontabilitetit, etj),
- Kompletimin e kuadrit ligjor dhe nxjerrjen e ligjeve të cilat ende mungojnë, e sidomos: Ligjin mbi Privatizimin/Shfrytëzimin afatgjatë të tokës, Ligjin mbi Hipotekën, Ligjin mbi Bankrotimin, Ligjin mbi Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligjin mbi Tregtinë e Jashtme, Ligjin mbi Tregun Financiar dhe Letrat me Vlerë, Ligjin mbi Pronësinë Intelektuale.

## **6.7. AVANCIMI I SUBJEKTIVITETIT TË KOSVËS NË MARRËDHËNIET EKONOMIKE NDERKOMBËTARE**

Sipas Rezolutës 1244 dhe Kornizës Kushtetuese të Kosovës çështjet që kanë të bëjnë me raportet ndërkombëtare të Kosovës janë të drejta të rezervuara të PSSP. Në kuadër të këtyre çështjeve dhe kompetencave janë edhe ato që kanë të bëjnë me krijimin e partneritetit ekonomik dhe tregtar të Kosovës me boten e jashtme. Edhe pse në Kosovë është krijuar një kornizë ligjore bazike për realizimin e investimeve direkte private, mos pjesëmarrja e Kosovës në institucionet më të rëndësishme ekonomiko financiare redukton dukshëm kapacitetet negociuese për arritjen e marrëveshjeve bilaterale me vendet tjera, dhe do ta vështirësojë inkurajimin e investitorëve të huaj. Me qëllim të tejkalimit të këtyre problemeve, UNMIK-u dhe Institucionet Kosovare duhet të punojnë në këto drejtime:

- Nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me vendet tjera lidhur me sigurimin e investimeve dhe tejkalimin e tatimit të dyfishtë të të ardhurave dhe profiteve,
- Rregullimi dhe institucionalizimi i statusit të Kosovës në raport me institucionet financiare ndërkombëtare me qëllim të krijimit të një partneriteti më të qendrushëm afatgjatë që do të shprehej pozitivisht në participimin e Kosovës në projektet e këtyre institucioneve,
- Avancimi i statusit të Kosovës në kuadër të Paktit të Stabilitetit nga antarësimi vrojtues në antarësim substancial me të drejt vote,
- Zyrtarizimi i teritorit të Kosovës si territor ndërkombëtar tregtar dhe doganor, do të dërgonte sinjale të qarta për sigurinë e investimeve direkte private në vend dhe teritorin e Kosovës, do ta bënte vend të sigurt dhe atraktiv për lëvizjen e kapitalit ndërkombëtar.



## 7. PROMOVIMI NË FUNKSION TE IJD

### 7.1. AKIVITETET E TANISHME

Promocioni është një nga elementet qensore të strategjisë së ndërtimit të imazhit pozitiv dhe atraktiv për inestitorët. Tani në Kosovë aktivitet promovuese janë në fazën inciale dhe pa qasje të integruar. Me qëllim të tejkalimit të kësaj situate është e nevojshme që të kordinohen instrumentet promovuese të akterëve në kuadër të një strukture të re promovuese. Kjo do kontribuonte për realizimin e një fushate institucionale në nivelet qeveritare, joqeveritare dhe profesionale me qëllim të përfshirjes së Kosovës në rrjedhat e kapitalit dhe të investimeve ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe në promovimin e investimeve dhe në veçanti të investimeve direkte private janë involvuar këto institucione, organizata dhe projekte ndërkombëtare:

- Qeveria e Kosovës nëpërmjet mekanizmit ndërministror
- Oda Ekonomike e Kosovës
- USAID –KBS Projekti/Mbështetja e Bizneseve të Kosovës
- Euro Info Qendra
- Swiscontact.

**(i) Qeveria e Kosovës** me përpjekjet e veta është e orientuar në krijimin e kanaleve kooperuese me Diasporën Kosovare, në promovimin e programit të vet, në promovimin e mundësive për mobilizimin e mjeteve të Diasporës në projektet produktive, dhe në ofrimin e informatave relevante lidhur me legjislacionin dhe reformen ekonomike që është duke u realizuar në Kosovë. Mirëpo, Qeveria ende nuk disponon me një Platformë për promovimin e qendrueshem të investimeve të huaja, nga se për këtë nevojitet edhe një involvim i UNMIK–ut dhe i institucioneve ndërkombëtare. Divizioni i Tregtisë dhe Industrisë në kuadër të Departamentit të mëpareshëm për Tregti dhe Industri mbante kontakte me disa agjenci shtetërore për promovimin e investimeve, të cilat kishin për synim veprimet konkrete: Zyra Zvicrrane për Lehtësimin e Investimeve (SOFI), dhe Instituto Español de Comercio Exterior (ICEX) ose Istituto per il Comercio Estero (ICE), janë disa prej tyre.

**(ii) Oda Ekonomike e Kosovës** është duke dhënë një kontribut të çmueshëm në krijimin e lidheve të reja ekonomike në mes të ekonomisë së Kosovës dhe vendeve tjera e në veçanti me tregjet e ish - Jugosllavisë. Oda Ekonomike ka promovuar mundësitë për partneritet me ndërmarrjet rajonale, duke inkuadruar edhe Diasporën Kosovare. Këto përpjekje janë realizuar nëpërmjet organizimit të panairove në vend, organizimit të ndërmarrësve Kosovarë për pjesëmarrje në panairot rajonale, misioneve studiuose dhe organizimit të workshopëve dhe seminareve të ndryshme.

**(iii) USAID Projekti për Mbështetjen e Bizneseve të Kosovës (KBS)** përqendrohet në zhvillimin e kapaciteteve menaxherike të ndërmarrjeve kosovare dhe në mbështetjen institucionale të zhvillimit të tyre. Mbështetja përfshin edhe lehtësimin e qasjes së ndërmarrjeve në punët eksportuese, në gjetjen e burimeve të reja financiare dhe vendosjen e kontakteve me investitorë të huaj. Në kuadër të projektit janë organizuar misione promovuese me grupe të ndryshme të investitorëve dhe të diasporës kosovare me qëllim të promovimit të intereseve të Kosovës për bashkëpunim me investitorët e huaj.

**(iv) Euro Info Qendra** është instrument i rendësishëm promovues me kyçje në një rrjet të 300 qendrave të ngjashme në Evropë. Është duke krijuar resurse të rendësishme informatike për bizneset e Kosovës në ndërlidhje dhe komunikim me bizneset ndërkombëtare. Aktivitetin promovues është duke e realizuar nëpërmjet: (i) ofrimit të informatave të para për klimën investuese në Kosovë dhe ofrimi i njohurive mbi politiken rregullatore të Evropës, tregjet, projektet e përbashkëta, tenderet dhe partnerët Evropian (ii) formimit të IECC website duke ofruar informata të biznesit të Kosovës dhe mundësitë për investime të mundëshme.

**(v) Swiscontact-i** projektet i ka përqendruar në tri fusha: (i) trajnim, (ii) shërbimet e biznesit dhe (iii) mbështetjejen e Diasporës Kosovare për rikthim në Kosovë. Nga aspekti i promovimit të investimeve të huaja me rendësi është anagazhimi i palës Zvicrane për formimin e Fondit Investues Kosovaro-Zvicrran, si model për mobilizimin dhe orientimin e mjeteve të Diasporës Kosovare në NVM-të në Kosovë.

Një element i rendësishëm në promovimin e investimeve ndërkombëtare është integrimi i Kosovës në ekonominë rajonale dhe më gjërë. Integrimi komercial dhe investimet janë të ndërlidhura më atë se normalizimi dhe rritja e tregtisë dhe zgjerimi i tregut të brendshëm, janë parakushtet për tërheqjen e investimeve. Një mundësi për përmirësimin e integritit komercial dhe rritjen e investimeve është promovimi i zhvillimit të Kosovës si qendër e ofertës, distribuimit dhe prodhimit për Ballkan. Kjo bazohet në pozitën qendrore të Kosovës dhe lidhjet e tregtisë ekzistuese me Shqiptarët që jetojnë në vendet fqinje. I njëjti parim mund të zbatohet në tregtinë me disa vende tjera ku janë të vendosur Kosovarët. *(ose përmes minoriteteve që jetojnë në Kosovë?!!)*. Zhvillimi i një rrjeti multi etnik tregtar përmes minoriteteve, do të shkonte në dobi të sigurisë, e jo vetëm në dobi të integritit komercial dhe investimeve kapitale.

## 7.2. ELEMENTET E STRATEGJISË SË PROMOVIMIT

Përveq zhvillimeve në fushën ligjore, fiskale dhe financiare të cilat u prezentuan më herët, strategjia e përshtatshme mbi promovimin e rrjedhave të IJD në Kosovë, së pari duhet ta marr parasysh nevojën për ta emëruar Kosovën si një destinacion investues.

**(1) Një fushatë institucionale** e cila do t'i përkufizonte beneficionet e investimeve që do t'i sillnin Kosovës. UNMIK-u, Shtylla e IV-të e BE-së, dhe Qeveria e Kosovës duhet të inkuadrohen më shumë në këtë fushatë, e cila duhet të jetë e hapur edhe për organizatat donatore. Me inkuadrimin dhe promovimin e sektorit privat përmes shtypit ekonomik ndërkombëtar, Kosova të prezentohet si një treg emergjent me kushte atraktive për investime:

- a. Pozita qendrore gjeografike
- b. Disponimi me pasuri natyrore me çmime konkurruese
- c. Territori në brendësi të Evropës
- d. Lidhjet me shumë vende të Evropës dhe SHBA-ve nëpërmjet Diasporës
- e. Popullsia e re dhe relativisht e arsimuar
- f. Aftësitë e mira teknike
- g. Motivimi i fuqisë punëtore
- h. Fuqia e lirë punëtore

- i. Niveli i ultë i tatimeve të brendshme
- j. Valuta stabile (Euro) dhe inflacioni i ultë
- k. Eksporti i liruar nga TVSH-ja dhe tarifatat doganore
- l. Tregtia e lirë me Bashkësinë Evropiane pothuajse për të gjitha mallrat në kuadër të Procesit për Stabilizim dhe Asocim)
- m. Fuqia e lartë blerëse nepërmjet dërgesave financiare nga bota e jashtme.

**(2) Misionet investive të afaristëve Kosovar.** DTI-a e mëparshme kishte organizuar disa misione investive ndërkombëtare. Në një mision të veçantë të suksesshëm, përfaqësuesit Kosovar të minierave kanë bërë një vizitë në Kanada, ku ata ishin takuar drejtpërdrejt me investitorët ndërkombëtar. Përkundër interesit potencial, statusi politik i padefinuar i Kosovës, i shoqëruar edhe me paqartësitë që dolën lidhur me pronën shoqërore, kishin parandaluar ndonjë ofertë serioze. Meqenëse privatizimi në Kosovë tani do të filloj, potenciali investues duhet të përmirësohet dhe misionet ndërkombëtare investive do të duhet të ishin një vegël efektive e promovimit.

**(3) Shfrytëzimi i zyrave të ndërlidhjes dhe përfaqësuesve të huaj në Kosovë.** Përfaqësuesit ndërkombëtar në Prishtinë mund të kontribuojnë në promovimin e investimeve duke kontaktuar me investitorët potencial ose duke promovuar agjencitë për investime në shtetet të cilat ata i përfaqësojnë. Ata janë një burim i çmueshëm i informimit dhe politikave për promovimin e investimeve për grupet specifike të investitorëve si Diaspora. Identifikimi i mundësive për investime dhe ndërmjetësimi në mes të investitorëve nga vendet e huaja dhe vendet e destinacionit, janë ndër funksionet më të rëndësishme të tyre.

**(4) Misionet investive në Kosovë.** Në lidhje me zyrat e ndërlidhjes të vendeve të huaja, divizioni i Tregtisë dhe Investimeve të DTI-së së mëparshme, dhe Oda Ekonomike e Kosovës kanë organizuar vizita ndërkombëtare në Kosovë, për t'i vlerësuar mundësitë për investime dhe njohjen më të gjërë të rrethit afaristë. Janë mbajtur sesionet e informimit, dhe materiali i titulluar “Dhjetë Arsye Kryesore për Investitorët të Vijnë në Kosovë”, ishte siguruar nga DTI-a për pjesëmarrësit. Disa marrëveshje, duke përfshirë investimet e përbashkëta, kanë rrjedhur nga këto misione. Tani, nën kushte më të favorshme këto programe duhet të intensifikohen.

**(5) Forumet: biznesi për biznesin** janë organizuar nga programet për mbështetjen e biznesit në Kosovë për disa vite. Euro Info Qendra (EICC) dhe KBS realizojnë sesione të rregullta për kontratat mbi shitjen dhe punët investive të cilat kanë dhënë fryte. Forumet e tilla të organizuara nga KBS kanë përfshirë një pjesëmarrje të gjërë nga Ballkani, nga Mali i Zi, IRJM dhe Shqipëria. Këto forume duhet të zgjerohen edhe më tutje.

**(6) Pjesëmarrja në panairët ndërkombëtare.** Shërbimet e biznesit për advokim të cilat veprojnë në Kosovë, siç janë KBS, EICC dhe Oda Ekonomike e Kosovës janë duke e promovuar pjesëmarrjen e bizneseve lokale në panairët rajonale dhe Pan Evropiane. Prodhuesit vendor kanë nevojë për këshilla se cilat janë panairët më të përshtatshme për t'i vizituar, si dhe cila mbështetje teknike lehtëson pjesëmarrjen e tyre.

**(7) Prezentimi i mundësive të biznesit Kosovar në forumet ndërkombëtare për investime.** Një numër i aktiviteteve promovuese të investimeve organizohen kudo nëpër Evropë për çdo vit. Një forum i njohur si CEEI (Central and Eastern European Initiative – Iniciativa për Evropën Qendrore

dhe Lindore) në Trieste të Italisë, e kishin përcjellur një numër i delegatëve Kosovar vitin e kaluar, ndërsa duhet të gjurmohen edhe edhe mundësi tjera.

**(8) Fushata e publicitetit.** Publikimet relevante të Kosovës mbi potencialin e investimeve, profilin dhe sektorin ekonomik, dhe rrethina afariste duhet të nxjerret në mediat elektronike dhe të shkruara.

**(9) Themelimi dhe institucionalizimi i kontakteve dhe komunikimeve me Diasporën Kosovare** është i nevojshëm si në nivelin qendror dhe atë lokal. Organizimi i Diasporës në vendet tjera duhet t'i shmanget fragmentimeve të cilat mund të rrejdhin nga përcaktimi politik, dhe ato duhet të orientohen në format organizative me atributet komunale të Kosovës.

**(10) Elaborimi i alternativave mbi themelimin e Agjencisë për Promovimin e Investimeve (API).** API mund t'i kordinoj përpjekjet e ministrive dhe akterëve të ndryshëm, që janë aktiv në promovimin e investimeve. Qëllimi i API është gjithashtu që t'i kordinoj përpjekjet përpjekjet për promovimin e investimeve në tërë Kosovën, duke siguruar informata të nevojshme për investitorët, dhe duke ofruar asistencën teknike për përpjekjet në promovimin e investimeve në sektorë të ndryshëm.

Duhet të diskutohet dhe të arrihet marrëveshja me sponzorët dhe partnerët institucional mbi organizimin i brendshëm të Agjencisë. Kërkohet një personel ndërkombëtar, i cili ka përvojën e duhur teknike në marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe që do ta ushtronte funksionin e menaxhmentit me përvojë.

Roli i API në kuadër të Qeverisë, apo edhe si trup i pavarur (shoqatë) gjithashtu duhet të diskutohet dhe të vendoset. Institucionet e ngjashme për promovimin e investimeve janë themeluar pothuajse në të gjitha vendet fqinje me Kosovën, dhe në shumicën e rasteve edhe entitete për njësitë rajonale brenda një shteti. Duhet të futet në funksion Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë, si një institucion themelor i ekonomisë së tregut.

## ANEKSI 1. RREGULLORJA MBI INVESTIMET E HUAJA

Qëllimi i kësaj Rregullorje është krijimi i garancioneve ligjore që janë të nevojshme për ta bërë Kosovën më atraktive për investitorët e huaj. Garancionet të cilat i ofron kjo Rregullore për investitorët e huaj, janë standarde dhe, në forma të ndryshme janë prezente në ligjet e ekonomive të tregut dhe të vendeve në tranzicion e të cilat janë duke kaluar në ekonominë e tregut të lire. Rregullorja u jep investitorëve të huaj pozitë të njëjtë me ndërmarrjet vendore, kur është fjala për tatimet, doganimin, si dhe për të drejtat dhe obligimet e tyre. Në të vertetë, ajo tenton t'i barazojë sa më tepër, në të drejtat dhe obligimet, investitorët e jashtëm me ndërmarrjet vendore.

Sipas përkufizimeve të kësaj Rregullorje, “investim i huaj” do të thotë një shoqëri tregtare që është së paku 25% në pronësi të një investitori të huaj. Ndërkaq, termi “investitor i huaj” nënkupton: i) çdo person fizik i cili është qytetar ose banor në një shtet të huaj; ii) çdo person juridik që është themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit të një shteti të huaj apo është themeluar sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë, me adresë të njohur nga ligji, dhe që ka vend kryesor të veprimtarisë ekonomike në një shtet të huaj, apo është investim i huaj; iii) një shtet i huaj apo njësi administrative etij, dhe iv) një person juridik, i krijuar nga një traktat ose marrëveshje ndërqeveritare.

Dispozitat kryesore të kësaj Rregullorje përqendrohen në disa parime të rëndësishme, të cilat sigurojnë që:

- Investimet e huaja do të udhëheqen sipas parimit të trajtimit kobëtar. Kjo do të thotë që këto nuk do të disfavorizohen krahasuar me ndërmarrjet e ngjashme vendore. Udhëheqja sipas parimit të trajtimit kombëtar nënkupton që organizatave të veprimtarisë ekonomike, të përcaktuara me Rregullore si investime të huaja, u garantohej e drejta që:
  - Të organizohen në të njëjtën mënyrë si atë vendore;
  - Të jenë subjekt i miratimit nga autoritetet si dhe ndërmarrjet vendore;
  - Të kenë të drejtë të transferojnë të drejtat nga pasuritë e tyre, duke përfshirë licencat, te personat tjerë, në të njëjtën mënyrë dhe masë si të personat vendor;
  - Të kenë të drejtë të blejnë pasuri të paluajshme bujqësore, rezidenciale ose jo rezidenciale njësoj si ndërmarrjet vendore;
  - Të jenë të mbrojtur si aksionarët vendas nëse nuk kanë shumicën e aksioneve në investimin e huaj;
  - Të mos tatimohen në mënyrë më pak të favorshme se një organizatë e ngjashme vendore, etj.
- Ka vetëm dy kufizime për investimet e huaja. Këto kufizime janë standarde thuaja se në të gjitha vendet. E para ka të bëjë me faktin se investitori i huaj nuk mund të jetë pronar i mbi 49% të pronës ose kontrollit mbi shoqëritë tregtare, që janë prodhuese ose shpërndarëse të produkteve ushtarake. E dyta, investimet e huaja që ndodhen në zonën që përfshinë 5 km brenda kufirit të Kosovës, duhet të paisen me licencë shtesë nga autoritetet.
- Investimet e huaja janë të mbrojtura nga shpronësimet e pajustificuara nga ana e autoriteteve. Shpronësimi i investimit të huaj mund të bëhet vetëm për qëllime të rëndësishme publike dhe nëse kjo është mënyrë më e lehtë për të përmbushur një qëllim të rëndësishëm publik. Në këtë rast shpronësimi duhet të bëhet në bazë jodiskriminuese dhe

në përputhje me një proces të rregullt ligjor, si dhe duhet të shoqërohet nga kompenzimi i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe i efektshëm për investitorin e huaj.

- Investimet e huaja që pësojnë humbje si rezultat i luftës, apo konflikteve të tjera ushtarake, situatave të jashtëzakonshme, konflikteve civile, revoltave civile ose situatave të tjera të ngjashme, kanë të drejta ligjore dhe mbrojtje si shoqëritë tregtare të vendit.
- Investitorët e huaj e kanë të drejtën e pakufizuar për t'i përdorur investimet e tyre dhe çdo të ardhur të lëshshme. Të ardhurat/fitimi nga investimet e huaja mund të transferohen lirisht brenda dhe jashtë Kosovës;
- Investimet janë të mbrojtura nga ndikimet retroaktive të ligjeve Kosovare, kështu që ndryshimet e ligjeve në Kosovë, pas nënshkrimit të kontratës nuk mund ta keqësojnë gjendjen e investimeve të huaja;
- Investimet e huaja në veprimtarinë e tyre ju nënshtrohen ligjeve të njëjta sikurse ndërmarrjet e vendit;
- Investitorët e huaj rregullojnë marrëdhëniet e punës sipas standardeve ndërkombëtare. Të punësuarit përmes investimeve të huaja në Kosovë, pa marrë parasysh kombësinë e tyre, janë subject i legjislacionit në fuqi të Kosovës. Investitorët e huaj kanë të drejtën e punësimit të punëtorëve të huaj.

## ANEKSI 2.

### **Oda e Tregtisë së Shteteve të Bashkuara** **Çka ndikon në Vendimarrjen e Ndërmarrjeve Amerikane për të Investuar Jashtë Vendlit;** **ose** **Dymbëdhjet Parimet për Investitorët Ndërkombëtar**

Faktorët e më poshtëm janë të pranuar si kriteriume kryesore të cilët nxisin vendimet e ndërmarrjeve për të investuar jashtë vendlit.

1. **Tregu i mbrendshëm** – madhësia dhe potenciali për rritje i tregut të vendlit, sidomos fuqia blerëse e konsumatorëve të tij janë të rendësishme. Nuk do të investoni në një treg në të cilin keni pak mundësi për të fituar.
2. **Liria e qasjes në treg** – fuqia e konkurrencës po ashtu edhe shkalla e ndërhyrjes së qeverisë (së tyre dhe tonës) për të hyrë në tregun e vendlit. Sa më i hapur të jetë tregu aq më atraktiv bëhet për investime.
3. **Fuqia punëtore dhe lënda e parë** – derisa investitori sjellë kapitalin, teknologjinë dhe menaxhmentin, kualiteti i fuqisë punëtore vendase dhe qasja në lëndën e parë, janë gjithashtu një element përbërës në rrugën për sukses.
4. **Mbrojtja nga devaluimi i valutës** – thenë thjesht nëse investoni me dollarë, dhe pastaj mjetet lokale ( të vlersuara në paranë vendase ) janë të devaluara, ju keni humbur një pjesë ( ose të gjithë ) të investimit tuaj në dollarë.
5. **Dividentat në para, kamatat, privilegjet dhe ndihma teknike në pagesa** – nëse mund nuk mund t'i tërhiqni parat, atëher pse të investoni?
6. **Mbrojtja e Drejtave të Pronës** – ka gjasë që prona e ndërmarrjes, e patundshme dhe e padukshme (patentat, licencat) do të vidhen.
7. **Potenciali për eksport** – aftësia për të zgjedhur prej njësisë operuese në një treg të shërbejë afër tregjeve ose të maksimizoj efektivitetin global duke tregtuar nëpër entitetet e llojllojshme në vende të ndryshme në mënyrë që të finalizoj linjat e prodhimit.
8. **Ngarkesat regulative** – kostoja e ndërhyrjes së qeverisë në afarizëm (dhe profit) në një vend
9. **Tatimet e favorshme dhe stimuluese** – edhe pse stimujt tatimor aplikohen si mjet për të nxitur investimet, vendimi final mbi investimet zakonisht bazohet në atë se si politika tatimore do të ndikoj në hapësirën vepruese.
10. **Rreziku i vogël politik** – mundësia e investitorit që të mbështetet në integritetin e qeverisë mikpritëse dhe aftësit e saj që të mbaj regullin dhe ligjin është esenciale në çdo investim afatgjatë.

11. **Udhëheqja e parashikueshme makroekonomike** – besimi që ekonomia në të cilën është bërë investimi do të udhëhiqet në mënyrë kompetente dhe të parashikueshme. Thënë më thjeshtë, besimi që rregullat e lojës nuk do të ndërtohen gjatë kontestit.
12. **Përkrahja e sigurtë nga infrastruktura** – mundësia që të përmbush transaksionet dhe të plasojë produktet dhe shërbimet në treg është kritike. A janë të besueshme shërbimet transportuese, prodhimi i energjisë, sigurimi dhe shërbimet e kontabilitetit, një system kompetent financiar ose gjërat tjera fundamentale, investimet nuk mund të gjenerojë të ardhura të qëndrueshme pa u plotësuar këto kushte.



## **ANEKSI 3. PËRVOJAT E DISA VENDEVE NË TËRHEQJEN E IJD**

### **1. BULLGARIA**

#### **IJD në Bullgari (1991-2002): Pasqyrë**

**Nga Krassen Stanchev dhe Martin Dimitrov**

#### **Hapja ndaj investimeve të huaja**

Bullgaria ka njërin prej ligjeve më liberale për investimet e huaja në gjithë rajonin e Ballkanit. Investuesit e huaj mund të themelojnë çdo lloj organizate të çfarëdo forme juridike që është paraparë me Ligjin Ekonomik. Forma më e shpeshtë e organizatës e praktikuar nga investuesit e huaj është kompania me përgjegjësi të kufizuar. Format tjera janë: partnershipi i përgjithshëm (partnershipi i pakufizuar), partnershipi i kufizuar dhe tregtia. Entitetet legale të huaja të regjistruara jashtë mund të regjistrojnë degët si pjesë e kompanisë kryesore apo zyrës përfaqësuese (përfaqësimi i marketingut) në territorin lokal.

Problemet që më së shpeshti përmenden nga investuesit e huaj janë: burokracia qeveritare, infrastruktura e varfër, rregullativa e varfër e vlerësimit të hershëm të ndikimit si dhe ndryshimet e shpeshta në kornizën ligjore, procesi i prolonguar i privatizimit dhe barra relativisht e lartë tatimore.

Kompanitë e huaja janë të lejuara të futen në forma të ndryshme të aktiviteteve ekonomike, përfshi këtu edhe blerjen e aksioneve në kompani, me disa kufizime. Individët e huaj nuk mund të jenë pronarë të tokës (kjo është një ndalesë kushtetuese). Ndalesa e mësipërme nuk i prek kompanitë bullgare që kanë një pjesëmarrje të huaj, pa marrë parasysh përqindjen e pjesëmarrjes së huaj në kompani.

#### **Garancionet Ligjore për Investuesit e Huaj**

#### **Trajtimi kombëtar**

Kushtetuta bullgare dhe ligji mbi investimet e huaja i japin investuesve të huaj një trajtim kombëtar, që do të thotë se investuesit e huaj kanë të drejtë të ushtrojnë të njejtin aktivitet ekonomik çfarë kanë të drejtë ta ushtrojnë edhe investuesit bullgarë (kombëtarë), përveç në ato raste kur ligji thotë ndryshe. Trajtimi kombëtar për investuesit e huaj do të thotë që ata mund të marrin pjesë në procesin e privatizimit dhe të blejnë aksionet, pjesë të thesarit dhe lloje tjera të kolateralit.

#### ***Garancionet Ligjore karshi ndryshimeve të pafavorshme të ligjit***

Ligji mbi Investimet e huaja thotë se investimet e huaja të bëra para aprovimit të amandamenteve në ligj që vendosin restriksione statutove vetëm në investimet e huaja, nuk do të preken nga këto restriksione. Qëllimi i ligjit është të garantojë investimet e huaja nga ndryshimet e mëvonshme ligjore.

## Konfiskimi dhe Kompenzimi

Sipas Nenit 26 të ligjit mbi investimet e huaja, prona mund të konfiskohet në bazë të ligjit “për çështje përjashtimisht të rëndësishme shtetërore”. Pronarët duhet të kompenzohen me pronë të përafërt me vlerë të barabartë me cmimet ekzistuese. Veprimet konfiskuese mund të apelojnë (të shtrohet ankesë) në Gjyqin Suprem duke u ankuar në bazën me të cilën është ndërmarrë konfiskimi, në vlerësimin e pronës dhe në metodën e konfiskimit. Nuk ka pasur asnjë rast të konfiskimit që nga fillimi i reformave në Bullgari në vitin 1989.

## Politika e Transferit

Qytetarët Bullgarë si dhe ata të huaj mund të nxjerrin jashtë shtetit një shumë deri në 20 mijë levë bullgarë (BGN) apo kundërvlerën e kësaj shume në valutë të huaj, pa pasur nevojë të kenë ndonjë dokument me vete. Sidoqoftë, eksporti i Levave apo valutave të huaja mes shifrave 5001 dhe 20000 BGN apo ekuivalentit në valutë të huaj duhet të deklarohet në doganë.

Transferet më të larta se 20000 BGN duhet të kenë lejen paraprake nga Banka Kombëtare e Bullgarisë (BNB). Të huajt kanë të drejtë të eksportojnë poaq para mbi 20 mijë BGN sa ata kanë importuar paraprakisht në Bullgari dhe këtë pa nevojën e lejes paraprake.

Pagesat që bëhen jashtë shtetit nga bizneset (apo njerëzit e vetëpunësuar) mund të bëhen vetëm përmes transferteve bankare. Transferet mbi 20000 BGN për pagesat ndërkombëtare (sic mund të jenë importimi i mallrave dhe shërbimeve, transporti, pagesat e kamatës, sigurimit, trajnimit, trajtimit mjekësor dhe qëllime tjera të përcaktuara me rregullativat bullgare) duhet të përcillen me dokumentacion përkatës që tregon nevojën dhe qëllimin e pagesave të tilla.

Kjo rregullore nuk pajtohet me një të kuptuar liberal të kapitalit dhe konsiderohet të jetë pengesë për investimet e huaja dhe transfertet e parave. Sidoqoftë, në kontekst të hyrjes së Bullgarisë në BE ky liberalizim pritet që të ndodhë.

Një amandament që ende nuk ka hy në fuqi parasheh një regjim të deklarimit por jo të lejimit, kur bëhet fjalë për transfertë më të larta se 25 mijë BGN. Sidoqoftë, transferi duhet të përcillet me dokumente që dëshmojnë se paratë kanë origjinë legale dhe se personi fizik apo juridik ka paguar të gjitha tatimet e duhura.

## Tregu i kapitalit

Që nga tetori i vitit 1997, Berza Bullgare ka vepruar sipas një licence të Komisionit për shkëmbime dhe kolateral (garancione). Megjithë tentimet e shumta qeveritare për të zhvilluar një Treg Bullgar të Aksioneve për momentin rezultatet janë të pakta dhe të pamjaftueshme. Konkluzioni themelor është se qeveria nuk mund të krijojë interes aty ku ai nuk ekziston apo të krijojë biznes aty ku entitetet thjesht janë të painteresuara.

## Fluksi i IJD-së

Investimet e huaja direkte në ullgari tregojnë se ka pasur një trend në rritje për 9-10 vitet e fundit. Fluksi i IJD-së në vend ka qenë mezi 34 milionë dollarë në vitin 1992 dhe është ngritur në mbi 1

miliardë dollarë në vitin 2000. Shtimin më të madh në fluskin e investimeve Bullgaria e ka shënuar në vitin 1997 kur ai u rrit për 2.5 herë në krahasim me vitin 1996. Arsyeja kryesore për këtë rritje ishte momenti në procesin e privatizimit ku IJD përmes privatizimit ishin 421 milionë USD apo më shumë se 2/3 e totalit të IJD-së në vitin 1997.

Themelimi i Bordit të Valutës në vitin 1998 ka pasur një efekt stabilizues në ambientin ekonomik dhe krijoi kushte më të favorshme për IDH (Greenfield Investments) (shiko tabelën)

Fluksi i IJD-së në vite (milion USD)

Viti	Privatizimi	Të tjera*	Totali
1992	-	34.4	34.4
1993	22.0	80.4	102.4
1994	134.2	76.7	210.9
1995	26.0	136.6	162.6
1996	76.4	180.0	256.4
1997	421.4	214.8	636.2
1998	155.8	464.2	620.0
1999	226.7	592.1	818.8
2000	366.0	635.5	1001.5
2001	19.2	669.3	688.5
2002**	300.0	400.0	700.0
<b>Total pa para shikimin për vitin 2002</b>	<b>1447.7</b>	<b>3084.0</b>	<b>4531.7</b>
<b>Totali me parashikimin për vitin 2002</b>			<b>5231.7</b>

\*Greenfield Investments + investimet shtesë në kompanitë me pjesëmarrje të huaj+riinvestimet +joint venturat.

\*\* Parashikimi për IME

Burimi: Agjencioni Bullgar për Investime të Huaja.

## **2. BOSNJA DHE HERCEGOVINA**

**(i) Progresi:** Në Bosnje dhe Hercegovinë për shkak të vështirësive në krijimin e sistemit unik të entiteteve, rezultatet në IJD janë modeste. Pas përfundimit të luftës fillojnë paraqitjet e para të investitorëve të huaj në një ambient tejet të pavolitshëm për investime. Investimet më të mëdha kanë ardhur nga këto vende: Kuvajti (19.0%), Kroacia (13.0%), Gjermania (9.8%), Holanda (8.6%) dhe Austria (7.2%). Vështruar sipas seltorëve investimet kryesisht janë të orientuara në biznese prodhuese (65.6 %), tregti dhe shërbime (18.7 %) dhe sektori bankar (15.7 %).

Gjatë periudhes 1995-2001 në Bosnje dhe Hercegovinë investimet e jashtme arrijnë shumën prej 1.1 mld KM (Marka konvertibile) apo 64.7% e investimeve në projektet përkatëse. Investitorët në vend kanë ardhur nga 80 vende të botës nga të cilat 35 janë nga Europa. Vendet Europiane marrin pjesë me 760.0 mil KM respektivisht 68.5%, ndërsa vendet jashtë europiane 31.5%. Sipas formës së investimeve është realizuar kjo pjesëmarrje: keshi (58.9 %), paisjet dhe objektet ndërtimore (35. %), dhe të drejtat (5.6%)

**(ii) Politikat qeveritare:** Politikat ekonomike janë të sfiduara nga proceset dezintegruese në raportet e entiteteve (Federata dhe RS). Qeveria Qendore nuk ka ndikim në implemetimin e të gjitha politikave ekonomike. *Institucionet qeveritare janë të obliguara në krijimin e parakushteve legislative për tërheqjen e investimeve të huaja, vlerësojnë qeveritarët e vendit.* Investitorët e huaj në kapitalin investues janë të liruar nga pagesa e doganës dhe detyrimeve tjera fiskale, ndërsa tatimi në profit nuk paguhet në 5 vitet e para për projektet e realizuara me pjesëmarrje të kapitalit të huaj.

**(iii) Promocioni:** Në entitetin federal të Bosnjës është formuar Agjencioni Federal i Promovimit të Investimeve të huaja si instrument i Qeverisë për inkurajimin e tërheqjes së investimeve të huaja. Agjencioni është i fokusuar në promovimin e Bosnjës si vend atraktiv, ndërtimin e një ambienti të volitshëm juridik, në sigurimin e asistencës për tërheqjen e investimeve të huaja në disa veprimtari, ndihma në sigurimin e lejeve (urbanistika, ndërtimtaria, lokacioni), identifikimi i pengesave dhe ndërmjetësimi në mes të investitorëve lokal dhe të jashtëm.

**(iv) Pengesat:** Qeveritarët e Bosnjës janë tejet kritik sa i përket ndikimit të pengesave në tërheqjen e investimeve të huaja. Sipas tyre të identifikuar janë këto pengesa kryesore:

- Imazhi i dobët i vendit,
- Implemetimi i dobët i ligjeve,
- Byrokratizimi i aparatit shtetëror, korrupcioni dhe gjyqjet joefikase,
- Sistemi juridik i komplikuar si rezultat i modelit të Dejtonit,
- Nivele të shumëta dhe afati i gjatë për regjistrimin e kompanisë me kapital të huaj,
- Jostabiliteti politik i vendit.

### **3. KROACIA**

**(i) Progresi:** Kroacia konsiderohet vend me shkallë më të lartë të zhvillimit ekonomik në krahasim me vendet e Europës Jug-lindore. Edhe Kroacia si vendet tjera të ish- Jugosllavisë në rrugën e saj drejt pavarësisë ka kaluar fazën e shkatërrimeve të luftes. Si rezultat i problemeve në demokratizimin e vendit deri në vitin 2000 Kroacia kishte vështirësi në realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, vlerësojnë zyrtaret e vendit. Kjo situatë është shprehur tejet negativisht në tërheqjen e investimeve të huaja. Pas këtij viti investitorët e huaj fillojnë t'u kthehen investimeve më serioze në këtë vend. Investimet e jashtme

#### **IJD në Kroaci**

Vitet	Shuma në mil.\$
1993	120.3
1994	117.4
1995	120.8
1996	515.8
1997	550.7
1998	1.013.5
1999	1.635.0
2000	1.125.8
2001	1.445.3
Gjithsej	6.644.8

Vështruar sipas sektorëve investimet e huaja kryesisht janë orientuar në: telekomunikime (29.7%), sektorin financiar (17.3%), prodhimin e produkteve farmaceutike (15.4%), prodhimin e cementit (5.0%), dhe veprimtarit tjera së bashku 32.6%. Ndërsa vështruar sipas origjinës së kapitalit të investitorëve është realizuar kjo pjesëmarrje: Austria (27.2%), Gjermania (25.8%), SHBA (18.2%), dhe Luksemburgu (5.6%) dhe vendet tjera së bashku 23.2%. Nga këto investime 13% ishin të orientuara në ngritjen e kapaciteteve të reja (Green Field Investment). Investitorët e huaj që në fillim kishin targetuar futjen e kapitalit të tyre në fabrikat për prodhimin e birrës, të çimentos dhe të materialit ndërtimor në përgjithësi dhe në ndërmarrjet që e kishin të siguruar tregun e mbrendshëm.

**(ii) Politikat qeveritare:** Investimet e huaj në Kroaci i garanton Qeveria. Me qëllim të stimulimit të investitorëve të huaj Qeveria Kroate ka nënshkruar marrëveshje me 40 vende mbi stimulimin dhe mbrojtjen e investimeve të huaja dhe me 25 vende marrëveshje mbi tejkalimin e tatimit të dyfishtë. Edhe në kuadër të politikës fiskale, Qeveria është duke aplikuar preferenciale doganore për pajisjet që importohen për realizimin e projekteve investuese me pjesëmarrje të kapitalit të huaj. Në institucionet qeveritare mendojnë se duhet të ulen shpenzimet administrative dhe të shkurtrohet koha dhe procedurat për regjistrimin e kompanive të huaja. Ka ide që kjo të realizohet nëpërmjet koncentrimit fizik të aktiviteteve rreth regjistrimit të firmave në të ashtuquajturën “Stop Shop Agency”, ku investitori do t'i kryente të gjitha veprimet administrative.

Për shembull afirmativ që duhet ta ndjekin edhe komunat tjera zyrtarët kroat e veçojnë komunën e Çakovecit e cila ofron kushte më të volitshme për sigurimin e tokës, infrastrukturës dhe efikasitet në

dhënien e lejeve për realizimin e investimeve në kapacitetet e reja nga ana e investitorëve lokal dhe të huaj. *Ky model i mbështetjes së investimeve është shprehur pozitivisht në inkrahimin e investitorëve të huaj, vlerësojnë zyrtarët kroat.*

**(iii) Promocioni:** Kroacia ka ndërtuar një politikë të qëndrueshme promotive për inkrahimin e investimeve të huaja. Këtu duhet veçuar përvojat e fituara në promovimin e mundësive turistike dhe të bregdetit Kroat. Në promovim më së shumti janë të involvuar Oda Ekonomike e Kroacisë, Ministrinë dhe disa agjencione private. Aktivitetet dhe politikat promovuese janë duke u realizuar nëpërmjet organizimit të panairëve ndërkombëtare në vend, organizimit të misionëve promovuese, publikimeve mbi mundësitë e investimeve, të zhvillimit të bizneseve dhe të projekteve nga teknologjia promovuese të tipit CD.

**(iv) Pengesat:** Zyrtarët gjatë vlerësimit të ndikimit të pengesave më tepër koncentrohet në pengesat që veprojnë nga rajoni se sa në ato që mund të ndikojnë nga politikat dhe funksionimi i institucioneve të mbrendëshme. Vlerësohet se ndikim më të madhë në inkrahimin e investimeve të huaja kanë këto pengesa:

- Procedurat e gjata administrative,
- Librat e tokës dhe pronësia e pa qartë,
- Mungesa e kapitalit të lirë në rajon,
- Ambienti i pavolitshëm për investime,
- Mungesa e decentralizimit të pushtetit nga se pushteti qendror nuk mund të ushtrojë ndikim të duhur,
- Imazhi i dëmtuar i vendit si pasojë e izolimit politik dhe i demokratizimit të ngadalshëm të vendit deri në vitin 2000.

#### **4. HUNGARIA**

Në fazën fillestare kapitali i huaj ishte tërhequr në Hungari përmes procesit të privatizimit dhe nga disa projekte Greenfield ku forca kryesore për dekadën e re do të jetë rritja dhe thellimi i bazës produktive të firmave të mëdha tashmë të vendosura në Hungari. Ky proces kërkon një strategji të re dhe vecanërisht një bashkëpunim më të afërt mes kompanive të mëdha dhe atyre të vogla dhe të mesme. Me fjalë të tjera, ndërsa fluksi i kapitalit në fillim ishte bazuar në shpërndarjen e brendshme të punës mes kompanisë bazë të huaj dhe degës së saj hungareze, në dekadën e re, shpërndarja dominante e punës do të bëhet mes kompanive të mëdha dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Plani i Szechenyi personifikon kushtet ekonomike ku është dhënë një projekt për zhvillim ekonomik në një shkallë të lartë në një afat të mesëm.

- Në fillim të Mileniumit të ri Hungaria ka inicuar një trend të qëndrueshëm të shtimit
- Procesi i harmonizimit ekonomik me BE tashmë ka filluar.
- Ekonomia hungareze është shëndërruar në një cak udhëheqës për investimet aktive të huaja në shkallë të Europës Qendrore-Lindore.
- Treguesit makroekonomikë flasin për një stabilitet të vazhdueshëm.

Në vitin 1999 Investimet e Huaja Direkte në Hungari numëronin afër 20.4 miliardë dollarë që paraqet 2/5 e të gjitha investimeve direkte në rajon.

Investimet per capita në Hungari janë 1900 USD, ndërsa në Ceki janë rreth 1600 USD. Hungaria, e cila radhitet e para në rajon për nga investimet, mund të arrijë 2500 USD investime per capita, që paraqet mesataren e BE-së.

Në pjesën e parë të viteve 90 IJD ishin të lidhura me privatizimin ndërsa në pjesën e dytë të 90-ave shumica e investimeve prej burimeve private shkoi në projektet Greenfield.

Gjermania radhitet e para në mesin e shteteve investuese me 27.9 për qind nga totali- e pasuar nga Holanda me 16.8 dhe SHBA-të me 12.2, pastaj vijnë Austria, UK, Franca, Italia. Investuesit nga SHBA-të kryesisht janë kompani multinacionale ndërsa investuesit nga Evropa Qendrore janë kryesisht NVM.

Tranzicioni në ekonominë e tregut në Hungari është shënuar më një humbje të punësimit: afër një milionë e gjysmë njerëz kishin humbur vendet e tyre të punës. Punësimi filloi të ringjallet ngadalë në vitin 1997, prej shkallës më të ulët që kishte në vitin 1993. Pjesa e dytë e viteve 90 filloi me një ulje të papunësisë së shoqëruar me një shtim të punësimit. Si rezultat, papunësia kishte rënë në 6% në fund të vitit 2000.

Në këtë fazë të rëndësishme, ekonomia hungareze ka nevojë të përgatitet për një formë të re të investimeve, ato që do të koncentrohen në rritjen dhe thellimin e bashkëpunimit mes firmave tashmë të themeluara. Ekonomia Hungareze ka një karakter të dyfishtë: firmat eksportuese të

medha që janë në pronësi të huaj dhe firmat e vogla dhe të mesme që prodhojnë për tregun lokal dhe që janë në pronësi të vendorëve.

Në fazën e parë modeli i zhvillimit ekonomik ishte i bazuar në fuqinë e lirë punëtore lokale dhe në fluksin e fuqishëm të kapitalit të huaj që gjeneronte një prodhim masiv modern. Në fazën e dytë, zhvillimi ekonomik mbështetet në tri elemente: një fuqi punëtore të kualifikuar dhe kreative, tërheqjen e kapitalit të jashtëm dhe inovacion.

Në Evropën Qendrore ka një konkurrencë të fortë për të tërhequr kapitalin e jashtëm. Promovimi i tranzicionit i ekonomisë drejt një modeli të ri të zhvillimit të udhëhequr nga inovacioni është një qëllim shtetëror dhe prandaj edhe qëllimi kryesor i Planit Szechenyi është të ofrojë një masë kritike e cila është domethënëse për sukses gjatë ndryshimit të modelit.

Është esenciale të kuptohen ndryshimet e shpejta të ekonomisë së re globale. Është një ndryshim prej ekonomisë manifakturale drejt një ekonomie të bazuar në dije. Në këtë kornizë, vendi më i preferueshëm mbahet prej ekonomisë elektronike. Difuzioni i një rrjeti global ekonomik mund të ketë përparësi për Hungarinë, por poashtu ai mund të paraqesë edhe rrezik nëse vonohet.

Qëllimet e Szechenyi Plan si një plan afatmesëm për zhvillim ekonomik janë si më poshtë:

- Të garantojë një zhvillim ekonomik dinamik dhe të qëndrueshëm
- Të zgjerohen bazat e shtimit
- Të theksohen përparësitë ekonomike
- Të kopjohen shtetet e përparuara europiane
- Të mobilizohen burimet ekonomike lokale dhe nderkombëtare
- Të krijojë mundësi ekonomike
- Revitalizimin ekonomik
- Të përgjigjet në sfidat e erës së re ekonomike.




## 5. MAQEDONIA

### Investimet a Jashtme Direkte në Republikën e Maqedonisë<sup>2</sup>

Periudha e tranzicionit për Republikën e Maqedonisë ka qenë e lidhur me disa tronditje nga jashtë, që kanë ndikuar në aktivitetet ekonomike të vendit. Ndikimi negativ në ekonominë dhe tregtinë e jashtme të vendit, ka qenë rezultat i sanksioneve të Kombeve të Bashkuara kundër Jugosllavisë, embargoja tregatë prej Greqisë (1994-95), kriza Kosovare (1999) dhe konfliktet ndër etnike në Maqedoni në vitin 2001, kanë pasur implikime shumë negative për investimet e jashtme direkte, e poashtu edhe, si pasojë e rritjes së rizikut në vend (që është një ndër determinantët kyç për tërheqjen e IJD).

Investimet a Jashtme Direkte konsiderohen si një komponentë tejet e rëndësishme për përkrahjen e procesit së tranzicionit në Republikën Maqedonisë dhe për një zhvillim substancial në afat të gjatë. Kjo është edhe më e rëndësishme për Maqedoninë (dhe vendeve tjera në tranzicion) kur kemi parasysh mungesën e kapitalit vendor dhe shkallën e ultë të kursimeve vendore.

#### Të dhënat mbi IJD në Maqedoni



IJD në Maqedoni kanë qenë tejet të ulta gjatë dekadës së fundit, kryesisht për shkak të jo stabilitetit politik ekonomik dhe social në Maqedoni, por edhe për shkak të mungesës së një kornize të duhur për IJD. Megjithatë, IJD janë ngritur në mënyrë të shpejt gjatë vitit 2000 dhe 2001, si rezultat i shitjes së kompanive të mëdha, investitorëve strategjikë. Investitorët kryesor në Republikën e Maqedonisë janë Greqia Hungaria, Lihtenshtajni, Zvicra, Gjermania, Austria dhe Slovenia me një strukturë gjatë dy viteve të fundit e cila mund të shihet më tabelën e më poshtme.

Tabela 1: IJD në Republikën e Maqedonis sipas origjinës së vendit (në 000 USD)

Vendi i origjinës	2000	2001
Greqia	102,516.73	67,394.08
Hungaria	9.1	322,681.76
Gjermania	11,212.13	4,757.42
Austria	2,043.59	1,462.54
Slovenia	11,585.59	3,865.95
Zvicra	1,300.84	8,784.28

Burimi: NBRM, Balance of Payments Department

<sup>2</sup> Nga Fatmir Besimi, Shoqata për Ekonomi Moderne, Shkup.

Analizuar sipas sektorëve, investimet më të mëdha janë regjistruar në sektorin e prodhimit (kryesisht në prodhimin e ushqimit) dhe në ndërtimtari, me një ngritje të investimeve të jashtme në sektorin e shërbimeve në dy vitet e fundit. Kështu, në vitin 2000, banka më e madhe e Maqedonisë - Stopanska Banka a.d. Skopje – është shitur Bankës Kombëtare Greke (60%), IFC (15%) dhe IBRD (15%). Në po të njejtin vit, janë shitur kompanit më të mëdhas të sigurimeve, ADOR a.d. Skopje, investitorit nga Britania e Madhe-QBE International (55%). Në vitin 2001, me anë të privatizimi të Telekomit Maqedonas firma Hungareze MATAV bëri investime në këtë sektor I cili njëherit është edhe sektori më profitabil me monopol në vendë.

Tabela 2: Investimet e Jashtme në Republikën e Maqedonisë sipas aktiviteteteve (në 000 USD).

<b>Sektori</b>	<b>2000</b>	<b>2001</b>
Bujqësia, Gjuetia dhe Peshkimi	3.19	1,324.14
Xehetaria	9,615.69	2,092.78
Industria	34,498.40	37,617.03
Ndërtimtaria	19,138.31	12,367.61
Shërbimet	112,226.66	390,117.68
<b>Total</b>	<b>175,482.25</b>	<b>443,519.23</b>

Burimi: NBRM, Balance of Payments Department

Investimi më i lartë direkt është shënuar në vitin 1999, me privatizimin e rafineris së naftës (OKTA Skopje) nga ana e Hellenic Petroleum prej Greqisë (54%). Ndërmarrjet e mëdha shoqërore që kanë mbetur për tu privatizur nga investitorët strategjik janë Elektroekonomia dhe Posta e Maqedonisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonis ka adoptuar Planin e Aksionit i cili siguron një kornizë të përgjithshme për restrukturimin e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe publike (në veqanti , për kompanit që kanë treguar humbje ose borgje të mëdha gjatë disa viteve të fundit). Qeveria ka indentifikuar 40 ndërmarrje të cilat i ka klasifikuar në dy grupe, varësisht nga ndikimi që mund të ken në ekonomin e vendit. Restrukturimi i këtyre ndërmarrjeve do të bëhet varësisht prej rastit në rast, sipas orarit të përpunuar nga Komoiteti për Reforma Strukturale.

### **Programet dhe strategjia e IJD**

Liberalizimi i politikës së investimeve të huaja në Maqedoni ka filluar në vitin 1993 me miratimin e ligjit të ri për investime të huajadhe ka vashduar në vitin 1996 m eadaptimin e Ligjit mbi Kompanit Komerciale. Ky ligj u garanton investitorëve të jashtëm të drejtën e themelimit të ndërmarrjes, përfundimit të investimeve, terheqjen e fitimit pasi që të ket paguar të gjitha detyrimet ligjore, si dhe mbrojtjen nga ndryshimet e ardhmshme legjislative.

Për të kaluar disa pengesa ende të mbetura në aplikimin e Ligjit mbi Kompanit komerciale, Ministria e Zhvillimit ka përgaditur Programin e Tërheqjes së Investimeve të Huaja me masa konkrete të reformës dhe rekomandimeve që kanë përmisuar rrjedhën e rregulloreve nacioanle dhe kanë shmangur tatimet në profitin e tërhequr jashtë vendit.

Për të implementuar këtë program të promovimit të investimeve, qeveria ka themeluar Njësin për Promovimin e Investimeve (në Nëntor 1996) në kuadër të Ministris së Zhvillimit. Kjo

njësi ka për detyrë që të lehtësoj promovimin e investimeve të huaja, dhe promovimin e bashkëpunimit industrial në mes të ndërmarrjeve Maqedonase dhe partnerëve të jashtëm. Për më tepër, kjo njësi në të ardhmen e afërt do të transferohet në Agjenci për Promovimin e Investimeve me mandat më të gjërë që do të përfshijë ndërtimin e imazhit, shërbimet investuese, si dhe hulumtimet dhe trajnimet.

Po ashtu, nuk ka kufizime për investues të huaj në procesin e privatizimit, p.sh. Ligji për privatizim, konsideron investitorët e huaj dhe vendorët në mënyrë të barabartë. Por, kanë ekzistuar pozita të privileguara për punëdhënësit dhe ekipet menaxheriale. Megjithatë, shumica e IJD gjatë privatizimit dhe pasprivatizimit është realizuar nëpërmes shitjes së letrave me vlerë të Agjencionit i Privatizimit në Bursën e IRJM.

Me 1998, qeveria themeloi agjencionin për Rindërtim dhe Zhvillim, i cili ishte aktiv në koordinimin dhe promovimin e IJD (ka startuar me një projekt të madhë në vlerë prej 1 miliardë \$, nga Taivani, ku një pjesë e këtyre investimeve është propozuar të jetë në formë të zonave Industriale).

Përfundimisht, politikat dhe programet e IJD në IRJM, si vazhdimësi, në kuadër të Marrëveshjes së Paktit të Stabilitetit, do të ketë këto qëllime:

- Qartësimi i kornizës për një qasje në patundëshmërit nga ana e investitorëve të huaj (Ligji për marrëdhënie pronësore është miratuar në Shkurt të vitit 2001, me qëllim të qartësimit të statusit pronësor, të krijoj mundësi të investimit në prona të patundëshme dhe eliminimit të kufizimeve në shitje, hipotekë apo edhe dhënies me qera të tokës për investitorët në rast të shpronësimit);
- Lehtësira në qasje në tokë dhe lirimi i pronës shtetërore për projekte investuese (transferi i regjistrimit të kadastrin me synim të përmisimit të infomatave për investitorët në lidhje me shfrytëzimin e tokës dhe themelimit të Zonave të Lira);
- Forcimi i institucioneve nfa fusha e promovimit të investimeve të huaja (Ligji për Kompanitë Komeciale është rishikuar me qëllim të thjeshtimit të procedurave dhe themelimit të institucioneve siq janë zyrtar për shërbime të shpejta, me synim që të sigurojn të gjitha shërbimet e domosdoshme për një regjistrim të shpejtë dhe efektiv të kompanive të huaja); dhe
- Përmisimi i rrethinës për investitorët e huaj (intensifikimi i bisedimeve me MIGA për mbajtjen e rezikut shtesë si garant për investitorët e huaj).

- 
- Referencat European Bank for Reconstruction and Development, *Transition Reports* (several editions)
  - Ministry of Finance of the Republic of Macedonia, *Monthly Bulletins* (several editions)
  - National Bank of the Republic of Macedonia, *Annual Reports* (several editions)
  - Organization for Economic Cooperation and Development, *Country Fact Sheets* (2000)
  - Organization for Economic Cooperation and Development, *FDI in SEE* (November 2000)
  - Privatization Agency of the Republic of Macedonia, *Reports of the activities* (several issues)
  - Stability Pact, *Progress in Policy Reform in South East Europe* (June 2001)

## **6. POLONIA**

### **Përvoja me IJD në Poloni**

#### **Korniza rregullative dhe politikat qeveritare**

Kompanitë dhe bizneset me pronësi të huaj në Poloninë e pasluftës veprojnë që nga viti 1976. Në fillim ato ishin themeluar nga Polakët me banim në botën e jashtme (të quajtur ‘Polonia’), pastaj prej banorëve të jashtëm të cilët ishin quajtur “bizneset e vogla të huaja” për shkak të madhësisë së aktivitetit të tyre. Ekonomia polake ishte më hapur ndaj investimeve të huaja në vitet 1986-1988. Në atë kohë kompanitë joint-venture ishin në zhvillim, kishte partnershipe të përziera me ndërmarrjet shoqërore ndërsa pronësia e huaj ishte limituar në 49%. *Akti mbi aktivitetin e kompanive me aksionarë të huaj* që daton nga 23.12.1988 iu siguronte të drejta në pronësi prej 100 % pronarëve të huaj, beneficione tatimore automatike dhe përjashtime të pjesshme doganore. Sidoqoftë licencimi i kompanive të huaja kishte pengesa lidhur me transferin e profitit deri në fund të vitit 1991.

Kushte speciale për IJD ishin krijuar në vitin 1994 kur ishte nxjerrë Ligji mbi Zonat e Veçanta Ekonomike. Akti ofronte lehtësime tatimore (PIT or CIT) deri në 10 vjet dhe një zbritje prej 50% në PIT ose CIT gjatë 10 vjetëve të ardhshme. Në bazë të këtij akti qeveria krijoi 17 zona të veçanta ekonomike por në vitin 2002 vetëm 14 prej tyre funksionojnë. Me 1996 u përpilua programi për zvogëlimin e normave të CIT për të gjitha kompanitë që vepronin në Poloni. Norma fillestare prej 40 % e CIT-së u reduktua në 38% në vitin 1997. Programi kishte nxituar në vitin 1999 me ç’rast norma e CIT-së ishte zbritur në 30%. Norma e CIT-së për vitin 2002 është 26% dhe për vitin 2004 planifikohet të zbatohet norma finale prej 22%.


Më 1 Janar të vitit 2001 Kodi për Kompanitë Komerciale ishte aprovuar bashkë me ligjin e ri Për Aktivitetet Ekonomike dhe Ligjin për Regjistrimin Kombëtar në Gjykata duke krijuar kështu një bazë ligjore për veprimtari ekonomike në Poloni për të gjitha korporatat përfshi këtu investuesit e huaj. Këto ndryshime ndodhën për shkak të hyrjes në fuqi të standardeve të reja të Marrëveshjes Evropiane të vitit 1991, që obligojnë Poloninë për të siguruar lirinë e themelimit të ndërmarrjeve dhe të ofrojë shërbime për enitetet e Bashkimit Evropian. Ndryshimet janë bërë gjithashtu si pasojë e pajtimit të ligjeve të Polonisë me direktivat e Bashkimit Evropian.

#### **Progresi i IJD-së**

Reformat politike dhe ekonomike që u bënë në fillim të viteve 90, çuan në një stabilizim makroekonomik dhe një zhvillim rapid ekonomik. Polonia asnjëherë nuk ka përjetuar kriza valutore ose fiskale sikur partnerët tjerët në rajon. Vendi është shëndërruar në njërin prej lokacioneve më të preferuara të investuesve. Më shumë se 56.83 miliardë dollarë amerikanë janë investuar si kapital i jashtëm në Poloni që nga viti 1989 (pothuajse 1500 USD per capita) Investimet mbi 1 milion dollarë amerikanë përbënin shifrën prej 53.15 miliardë dollarësh, ndërsa ato nën 1 milion përbënin 3.5 miliardë dollarë amerikanë, sipas Agjencisë Polake për Investime të Huaja (PAIZ)

## Grafikoni 1

### Investimet e huaja direkte (në miliardë USD)



Burimi: PAIZ

Sipas llogaritjeve të PAIZ, kompanitë e huaja kanë investuar në Poloni 7, 146.6 milionë dollarë Amerikanë në vitin 2001, ndërsa mbi 3.88 miliardë dollarë janë investuar vetëm në pjesën e dytë të vitit 2001. Suksesi i transformimit ekonomiko-politik i Polonisë u njoh ndërkombëtarisht me pranimin në OECD (1996) në NATO (1999) dhe anëtarësimin e pritur në Bashkimin Europian me 2004. Një garancion më shumë për investuesit e huaj është se rregullat e përdorura në Poloni janë të standardeve të vendeve të zhvilluara.

Procesi i implementimit të *acquis communautaire* kontrobuoi në krijimin e kushteve më të përshtatshme për aktivitetet ekonomik në Poloni, përmirësoi klimën investuese dhe rriti fluksin e kapitalit në ekonominë vendore. Kapitali i tërhequr nga jashtë e bëri kështu Poloninë lider (sa i përket investimeve) në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Arsyet kryesore të fluksit të madh të IJD-së janë:

- Tregu më i madh në Evropën Qendrore
- Çmimet e ulëta të fuqisë punëtore
- Përmirësimi i përgjithshëm i ambientit ekonomik
- Integrimi në rritje me ekonominë botërore
- Privatizimi i suksesshëm i ndërmarrjeve shtetërore
- Baza solide makroekonomike

Sipas statistikave të PAIZ, në vitin 2000 kompanitë e huaja kanë investuar mbi 10 miliardë dollarë, që përbën afërsisht 40% të totalit të kapitalit të vendosur në Evropën Qendrore.

### Pengesat për IJD

Megjithë klimën e mirë investuese, mund të përmenden disa pengesa për IJD-në në Poloni. Këto janë:

- Tatimi i lartë në fitim i korporatave. Zvogëlimi i këtij tatimi në 22% në vitin 2004 nuk do të jetë i mjaftueshëm, sepse psh, në Rusi ky tatim është ndjeshëm më i ulët.
- Infrastruktura teknike dhe e transportit. Një infrastrukturë relativisht e varfër e rrugëve, cilësi e dobët e rrugëve dhe një numër i vogël i autostradave.
- Pengesat e rritura administrative, veçanërisht në nivelin lokal. Problemi i marrjes së lejeve të ndryshme për ndërtim, që janë të domosdoshme gjatë procesit të investimit. (në këtë

sferë ka dallime të mëdha mes vendeve të ndryshme. Disa autoritete lokale kanë krijuar kushte mjaft të mira për investime dhe veprimtari ekonomike). Pengesat administrative janë krijuar poashtu edhe nga autoritetet kombëtare, psh, në raport me Reformën për Sigurimin Social, Implementimin e ligjit të Ri Komercial, etj.

- Ndryshimet në kërkesën e brendshme. Sidoqoftë, efektet negative të recesionit dhe të zvogëlimit të kërkesës së brendshme mund të zvogëlohen duke eksportuar në rajon (shumë investues të huaj me sukses janë duke e zbatuar këtë strategji).

### **Mësimet që dalin nga përvoja e Polonisë**

Hulumtimet tregojnë se IJD ka një ndikim sinjifikant në efektet e matura siç janë rritja e GDP-së, por poashtu edhe në efektet e ndryshme kualitative: arsim, transfer të teknologjisë moderne, cilësi të prodhimeve dhe shërbimeve, cilësi të menaxhimit dhe të cilësisë së ambientit të punës. Efekti në arsim është i lidhur me përmirësimin e shkathtësive të punëtorëve. Nivelet e profesionalizmit, mësimi i gjuhëve të huaja, përgjegjësia dhe vetë-mbështetja janë rritur poashtu. Shumë firma me kapital të huaj posedojnë pajisje që mund të krahasohen me kompanitë më të mira botërore. Shumë shpesh ato janë sipas standardeve botërore në atë fushë të caktuar. Prodhuesit polakë prodhojnë duke u bazuar në shembujt e investuesve të huaj. Si rezultat, cilësia e prodhimeve dhe shërbimeve është përmirësuar. Në kompanitë me kapital të huaj, përqindja e ankesave nuk kalon 1.5%. Përmirësimi i cilësisë së menaxhimit është një prej efekteve më të rëndësishme të investimeve të huaja. Menaxhmenti financiar si kontrolli i shpenzimeve, planifikimi, menaxhimi i personelit, qartësia e strukturës organizative, zgjedhja e stafit dhe delegimi i detyrave është përmirësuar ndjeshëm. Duke ju falenderuar investuesve të huaj, ambienti i punës ishte përmirësuar ndjeshëm: objektet dhe teknologjia e përdorur prej punëtorëve, rehatia e kushteve të punës, dhe të gjitha kompenzimet të lidhura me punën janë në nivel më të lartë se më parë.

Në të gjitha aspektet e lartëpërmendura, një efekt i lartë i imitimit është shfaqur. Konkurruesit vendas shpejt u janë përshtatur standardeve të jashtme. Investimet e jashtme poashtu sollën ndryshime në strategjitë e tregut. Sipas nje hulumtimi të IPED, ndërmarrjet e jashtme kanë krijuar shtigje të cilat pastaj janë rrahur edhe nga konkurruesit vendorë në tregun e njejtë. Sipas mendimit të menaxherëve të firmave të huaja, kompanitë vendore ishin më të angazhuara në promovimin dhe reklamimin e prodhimeve dhe më shpesh marrin pjesë në ekspozita dhe panairë. Si rezultat i procesit të përshkruar, konsumatorët kanë pasur qasje më të mirë ndaj prodhimeve dhe shërbimeve vendore.

Sidoqoftë duhet të theksojmë se IJD në Poloni kanë:

- transferuar teknologji të re vetëm në disa fusha të caktuara
- kanë shkaktuar efektin e multiplikimit por vetëm në disa industri
- në shumicën e rasteve investuesit e huaj nuk investojnë në Hulumtim dhe Zhvillim, duke i zhvilluar kështu teknologjitë e reja jashtë Polonisë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura më lartë, mund të thuhet se efektet pozitive të IJD në ekonominë polake janë më të shumta.

## ANEKSI 5. AKTIVITETET PROMOVUESE

### a) USAID-KBS



Projekti Kosova Business Support ka zhvilluar në mënyrë aktive Praktikën e Tregtisë dhe Investimeve (T&I) që nga vera e vitit 2001. Kjo praktikë është bërë funksionale plotësisht me 1 Ddhjetor 2001 me rekrutimin e një specialisti ndërkombëtar.

- KBS ka krijuar Programin e Qasjes në Treg i cili përfshin aktivitetet e jashtme dhe të brendshme dhe ato në sektorin specifik të Biznisi për Biznisi (ose B2B), panaiet tregtare dhe misionet e promovimit të investimeve të cilat fillimisht janë fokusuar në:
  - Rindërtim/materiale për ndërtimtari
  - Ushqim/agrobiznes
  - Tekstil/veshmbathje
  - Dhe fusha tjera të prodhimit industrial
- Ne jemi të fokusuar në vendet e rajonit me të cilat ndërmarrjet nga Kosova do të krijojnë kontakte më së pari, veçanërisht Maqedonia, Shqipëria, Kroacia, Sllovenia, Bullgaria, Turqia dhe Mali i Zi.
- Ne jemi duke inkurajuar diasporën Kosovare dhe shqiptare në Europë dhe në SHBA për të qenë më të involvuar në zhvillimin e Kosovës duke i përkrahur si investimet e mbrendshme ashtu edhe ato të jashtmet të lidhura me shtetet e tyre përkatëse. Kjo po bëhet duke përkrahur programin KIKO.
- Ne kemi krijuar Asociacionin për Eksport të Kosovës që do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës përmes theksimit të zgjerimit të tregtisë dhe mundësive të eksportit
- KBS ka publikuar *Udhëzuesin për Tregti dhe Investime nw Kosovw*, i cili definitivisht është shëndërruar në një burim për investues potencialë në rajonet e ndërlidhura me aktivitetet e T&I.

KBS ka zhvilluar një dije të konsiderueshme institucionale dhe të mirëkuptimit për sektorin privat në Kosovë, në formën në të cilën ai është i strukturuar. Përveç kësaj, KBS është forca kryesore në zgjerimin e tregjeve përtej kufijve të Kosovës për sektorin privat. Për më tepër, me kredibilitetin e arritur në treg të KBS, duke ju falenderuar së pari kontratave të mbyllura të vlefshme me miliona euro, ne jemi duke filluar procesin e të qenit më aktivë në promovimin e investimeve në Kosovë. Kjo është e qartë nga videoja të cilin e kemi prodhuar kohëve të fundit, *Investimi në Ardhmëri* dhe me takimet që KBS ka pasur me diasporën Kosovare dhe Shqiptare në Nju-Jork.

Që nga kjo kohë, T & I ka drejtuar kontrata me një vlerë prej më shumë se 10 milionë euro. Këto marrëveshje përfshijnë eksportin, investimet (duke ju ndihmuar kompanive të gjejnë burime të reja kreditimi), qasje në burime të reja dhe më të lira të lëndës së parë, teknologji dhe makineri të re dhe pajisje. Ato poashtu përfshijnë marrëveshje me kompanitë multinacionale lidhur me zingjirët e furnizimit. KBS ende ka punë për të bërë për të sjellë Investime të Huaja Direkte në Kosovë: sidoqoftë ne jemi duke punuar me disa grupe të tilla të interesuara për investime të tilla.

Më poshtë po japim disa nga fushat kryesore dhe aktivitetet në të cilat jemi të involvuar për të përkrahur tregtinë dhe aktivitetet investuese në Kosovë.

## **b) Përfshirja e Swisscontactit në promovimin e investimeve në Kosovë**



Swisscontacti është një Fondacion i Industrisë Zvicerane dhe është aktiv në Kosovë që nga viti 2000. Momentalisht Swisscontacti është duke realizuar dy projekte: Trajnimin Modular të Orientuar drejt Punësimit (JOMT) dhe Shërbimet e Këshillimit të Biznesit (BAS). Swisscontacti ka propozuar krijimin e një fondi Kosovaro-Zviceran për investime praën qeverisë së Zvicrës.

Roli i tri projekteve në promovimin e Investimeve të Huaja Direkte (IID)

### 1). JOMT

JOMT është duke përmirësuar sistemin e edukimit profesional në Kosovë përmes intervenimeve të ndryshme. Në këtë mënyrë, resurset njerëzore (një fuqi e kualifikuar punëtore) të Kosovës do të përmirësohen. Kjo i kontribuon ambientit për IID.

### 2). BAS

Në fazën pilot (deri në dhjetor 2001) projekti BAS ishte direkt i lidhur me të kthyerit nga diaspora, respektivisht nga Zvicra. Të kthyerit janë ndihmuar në përpjekjet e tyre për të filluar me biznes në Kosovë ndërsa diaspora është motivuar të investojë në ekonominë e Kosovës. Konferenca mbi privatizimin e NSH-ve është sponsorizuar nga ky project (Gjakovë, janar 2002)

Në fazën e implementimit (Janar 2002-dhjetor 2004) BAS dëshiron të kontribuojë në rritjen e sektorit privat përmes krijimit të një tregu për Shërbimet e Zhvillimit të Biznesit.

### 3.) Fondi Zvicerano-Kosovar për investime

Kursimet e diasporës në Zvicër do të tërhiqeshin nga një fond në Zvicër që do të emetonte bonds. Qeveria zvicerane do të garantonte ripagesën e bondeve. Banka Zvicerane, e cila do të administronte fondin, do të jipte financim afatgjatë për bankat partnere në Kosovë, me kusht që këto banka të japin kredi afatgjatë për NVM-të në Kosovë. Përmes këtij fondi të diasporës, kapitali do të drejtohej drejt sektorit të NVM-ve në Kosovë.



### c.) Euro Info Qendra



Euro Infor Qendra i përket një rrjeti prej mëse 300 qendrave informative evropiane të themeluara nga Komisioni Evropian që janë të vendosura nëpër krejt Europën dhe rajonin e Mesdheut.

EICC Kosova është krijuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe financohet nga Agjencioni European për rindërtim (EAR) si pjesë e përpjekjeve të saja për të ndihmuar NVM-të. Detyra e EICC-së është informimi, këshillimi dhe asistimi i ndërmarrjeve kosovare në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre në kontekst lokal dhe evropian, me qëllim të përmirësimit të familiaritetit të tyre me Europën.

EICC Kosova shërben si një shitore e parë dhe konsultant neutral për të gjitha çështjet evropiane të lidhura me kompanitë kosovare duke ofruar informacion mbi: tregjet evropiane, instrumentet financiare evropiane, programet e BE-së për Kosovën dhe Ballkanin, joint venturat Kosovë-BE, tenderet e BE-së, rregullativat dhe udhëzimet e BE-së, ngjarjet, kërkimin e partnerëve, etj.

Objektivat e EICC-së janë të informojë komunitetin e biznesit në Kosovë lidhur me kornizën ligjore në Europë, të informojë kompanitë evropiane lidhur me kornizën ligjore në Kosovë, të ofrojë qasje në burimet e informacionit të Bashkimit European dhe të vendosë një bashkëpunim ekonomik mes NVM-ve kosovare dhe atyre evropiane.

EICC është duke vendosur rrjetin e saj nëpër gjithë Kosovën dhe po ofron shërbime për NVM-të në gjetjen e tregjeve botërore. NVM-të kosovare janë shumë të interesuara lidhur me shkëmbimin e informacionit me Europën dhe botën.

Përparësia e EICC në promovimin e Investimeve të Huaja Direkte është për shkak se EICC është një institucion që posedon informacion të rëndësishëm dhe mundësinë për të vepruar si ndërmjetësues mes kompanive kosovare dhe Bashkimit European përmes rrjetit të qendrave informative evropiane. Ajo ofron mundësi tjera si intranet me EIC tjera, VANS, bazë të të dhënave online, CD ROM si burime informacioni, baza të të dhënave evropiane sic janë ECHO, Eurobases, KOMPASS CD ROM me profilet e mëse 400 mijë kompanive evropiane.

Një tjetër mjet i promovimit të EICC është site i saj [www.kosova-eicc.org](http://www.kosova-eicc.org) e cila ofron informacion relevant dhe të ndryshëm për Kosovën dhe mundësite e hapjes së biznesit, apo investimit në Kosovë e cila vazhdimisht vizitohet nga shumë kompani ndërkombëtare që kërkojnë shërbime online.

EICC ka kontakte ditore me klientë, lokalë dhe ndërkombëtarë. Ajo publikon gazetën dymujore brenda gazetës Koha Ditore, gazetë kjo që i dedikohet komunitetit të biznesit. Kjo gazetë shpërndahet edhe në vendet tjera të Europës.

EICC tashmë ka filluar punën drejt promovimit të investimeve. Në konferencën vjetore të EIC muajin e kaluar, shumë kompani kishin mundësi të informohen lidhur me Kosovën përmes një shpërndarje të një prezantimi në CD që përmbante këshilla për investuesit e huaj që vijnë në

Kosovë (CD kjo e publikuar në bashkëpunim me Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit), materiale të ndryshme promovuese dhe pyetje-përgjigje.

Në të ardhmen ne planifikojmë të zgjerojmë gamën e veprimit tonë lidhur me promovimin e investimeve përmes publikimit të materialeve të ndryshme dhe punëtorive. EICC deri më tani ka organizuar disa punëtori me kompani lokale dhe ndërkombëtare, do të ftojë kompanitë e huaja që të vijnë në Kosovë për tu informuar lidhur me ambientin ekonomik, kornizën ligjore për veprimtari ekonomike, si dhe do të dërgojë biznesmen kosovarë në Europë.

Nga aktiviteti dhe shërbimet e EICC-së komuniteti i biznesit në Kosovë do të përfitojë ndërsa kompanitë ndërkombëtare do të ofrojnë investime financiare.

## REFERENCES,

1. Annual Report 2001, MIGA.
2. Balkan Regional Cooperation & European Integration, The London School of Economics and Political Science.
3. Raporti i Paralajmërimet të Hershëm, Riinvest, 2002.
4. Economic Reform Today, CIPE, Washington D.C., no. 4, 1997.
5. IJD in South-Eastern Europe in the early 2000s, The Vienna Institute for International Economic Studies (WIIW), 2002.
6. Finance and Development, June 2001, IMF.
7. Financial Statistics, BPK, 2002.
8. Foreign Direct Investment: A Lead Driver for Sustainable Development, Toward Earth Summit 2002, Economic Briefing Series No.1.
9. Frank Sader, Attracting Foreign Direct Investment Into Infrastructure, World Bank & The International Finance Corporation, 2000.
10. Garret FitzGerald, Building Competitive Advantage in Nations – Increasing Transparency, Combating Corruption and Improving Corporate Governance, Budapest, 2002.).
11. Investment Guide for Southeast Europe.
12. Iraj Hashi, Ristrukturimi dhe Privatizimi i Ndërmarrjeve të Mëdha Shoqërore dhe Publike në Kosovë, Staffordshire University, Stoke on Trent, UK.
13. Jacques Morisset & Oliver Lumenga Neso, Administrative Barriers to Foreign Investment in Developing Countries.
14. Zhvillimi Ekonomik Lokal në Kosovë, Raport Hulumtues, Riinvest, 2002.
15. Obstacles to Trade, Growth, Investment and Competitiveness, Chesapeake Associates – Washington, 2001.
16. Private Capital Flows to Developing Countries - ECOSOC 2000).
17. Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Reforma e Shërbimeve Publike, Raport Hulumtues, Riinvest, 2002.
18. Rindërtimi i Kosovës pas Luftës: Strategjia dhe Politikat, Raport Hulumtues, Riinvest, 2000.
19. Prospects for Development in Southeast Europe: Business Opportunities, The Vienna Institute for International Economic Studies (WIIW).
20. Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë, Raport nga Anketues, Riinvest, 2001.
21. The Road to Stability and Prosperity in SEE – Regional Strategy Paper, World Bank, 2002.
22. Trade Agreement Between “FRY” and FYROM and its Impact on Kosova’s Trade Position in Cooperation to FYROM, Report, Riinvest, 2002.